

# Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

**Ministria e Ekonomisë**  
Republika e Maqedonisë

**Tetor 2018**



## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| Shkurtesa.....  | 4  |
| Rezume ekzekutive .....   | 5  |
| 1. Hyrje .....  | 8  |
| 1.1 Politika e reviduar industriale .....                               | 8  |
| 1.2 Politika industriale si qasje gjithëpërshirëse .....                | 8  |
| 1.3 Leksione nga Politika Industriale e R. të Maqedonisë 2009-2020..... | 9  |
| 1.4 Nevoja për Strategji Industriale.....                               | 10 |
| 2. Politika industriale, stragjitë dhe institucionet.....               | 11 |
| 2.1 Politika Industriale: zhvillimet e fundit.....                      | 12 |
| 2.1.1 Bashkimi Evropian (BE) dhe Politika Industriale .....             | 12 |
| 2.1.2 Rëndësia e prodhimit .....  | 19 |
| 2.2 Politika Industriale në Republikën e Maqedonisë.....                | 20 |
| 2.2.1 Strategjia e konkurrencës.....                                    | 21 |
| 2.2.2 Strategjia e inovacionit.....                                     | 21 |
| 2.2.3 Strategjia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).....        | 22 |
| 2.2.4 Strategjia e zhvillimit të sipërmarrësisë së grave .....          | 22 |
| 2.2.5 Strategjia e mësimi të sipërmarrësisë .....                       | 22 |
| 2.2.6 Strategjia e avancimit të efikasitetit energjetik.....            | 23 |
| 2.2.7 Strategjia gjithëpërshirëse e arsimit 2018-2020 .....             | 23 |
| 2.2.8 Programi i reformave ekonomike .....                              | 23 |
| 2.3 Plani për rritje ekonomike (PRRE) .....                             | 24 |
| 2.4 Institucionet kryesore relevante .....                              | 25 |
| 2.5 Fokusi mbi Strategjinë Industriale .....                            | 27 |
| 3. Industria përpunuese: tendencat dhe çështjet .....                   | 27 |
| 3.1 Industria përpunuese është e rëndësishme .....                      | 28 |
| 3.2 Çështjet globale të cilat ndikojnë mbi industrinë përpunuese.....   | 29 |
| 3.3 Industria përpunuese në Ballkanin Perëndimor .....                  | 30 |
| 3.4 Inudstria përpunuese në R. e Maqedonisë.....                        | 31 |
| 3.4.1 BPV sipas sektorëve industrial .....                              | 31 |
| 3.4.2 Pjesëmarrja e nën-sektorit në vlerën e shtuar të sektorit.....    | 32 |
| 3.4.3 Indekset zinxhirë të prodhimit industrial.....                    | 33 |
| 3.4.4 Indeksi i produktivitetit në industri .....                       | 34 |
| 3.4.5 Eksporti i mallrave .....   | 36 |

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

|   |    |
|---|----|
| 3.4.6 Prurje të IDH në industri .....   | 39 |
| 3.4.7 Industria përpunuese: Maqedonia në krahasim me botën.....                                     | 42 |
| 3.5 Ndërmarrjet dhe industria përpunuese .....  | 44 |
| 3.6 Analiza SWOT: industria përpunuese .....  | 46 |
| 4. Strategjia industriale .....   | 48 |
| 4.1 Vizioni .....   | 48 |
| .....   | 48 |
| 4.2 Qëllimet strategjike .....  | 48 |
| 4.3 Targete .....   | 48 |
| Qëllimi strategjik 1 –Fuqizimi i themeleve të industrisë përpunuese.....                            | 51 |
| Qëllimi strategjik 2 – Rritja e produktivitetit, inovacioneve dhe transferimit të teknologjive..... | 55 |
| Qëllimi strategjik 3 – Katalizimi i industrisë së gjelbër dhe prodhimit të gjelbër .....            | 59 |
| Qëllimi strategjik 4 –Stimulimi i eksportit tëprodhimit.....  | 64 |
| Qëllimi strategjik 5 –Ndërtimi i industrisë përpunuese në të cilën mësohet.....                     | 67 |
| Qëllimi ndër-sektorial – Implementimi dhe koordinimi .....  | 70 |
| 5. Implementimi dhe koordinimi.....   | 73 |
| 5.1 Politika/Strategjia industriale dhe Strategjia e industrisë përpunuese/Plani i veprimit.....    | 73 |
| 5.2 Roli i Ministrisë së Ekonomisë .....  | 73 |
| 5.3 Roli i Qeverisë / Ministrive .....  | 74 |
| 5.4 Roli i palëve të interesuara .....  | 74 |
| 5.5 Koordinimi ndërministror .....  | 74 |
| 5.6 Dialogu publik - privat.....  | 75 |
| 5.7 Financimi .....   | 75 |
| 5.8 Koordinimi i donatorëve .....   | 76 |
| 5.9 Monitorimi dhe raportimi .....  | 76 |
| 5.10 Evaluimi.....  | 77 |
| Aneksi A: Analizë mbi industrinë përpunuese.....  | 78 |
| Aneksi B: Plani i Veprimi për industrinë përpunuese.....  | 96 |

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

### Shkurtesa

|                  |   |
|------------------|---|
| BPV              | Bruto prodhimi vendor   |
| CEFTA            | Marrëveshja për tregti të lirë e vendeve të Evropës Qendrore  |
| CIP              | Indeksi i performansave konkurrenente industriale   |
| KOSME            | Programi për konkurrencë i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme   |
| KZKQRM           | Kabineti i Zëvendëskryetarit të Qeverisë i ngarkuar për çështje ekonomike   |
| BERZH            | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim  |
| KE               | Komisioni Evropian  |
| EEN              | <i>Enterprise Europe Network</i> – Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve   |
| EMAS             | <i>Eco-Management and Audit Scheme</i> – Skema e eko-menaxhmentit dhe revizioni   |
| Erazmus+         | Programi i BE për arsim, trajnim, rini dhe sport  |
| BE               | Bashkimi Evropian   |
| Eureka           | Organizatë Ndërqeveritare për Hulumtim dhe Zhvillim   |
| EUROSTAT         | Enti i Statistikës së BE  |
| IHD              | Investime të huaja direkte  |
| FP7              | <i>Framework Programme 7</i> – Programi kornizë 7   |
| Horizont 2020    | Programi për hulumtim dhe inovacione i BE   |
| TIK              | Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit  |
| INF              | Institucione ndërkombëtare financiare   |
| IOT              | <i>Internet of Things</i> – Interneti i çështjeve   |
| PI               | Politika industriale  |
| IPA              | Instrument për ndihmë para-aderuese   |
| KET              | <i>Key Enabling Technologies</i> – Teknologjitë kryesore  |
| IKS              | Indikator kryesor i suksesit  |
| VSHP             | Vlera e shtuar e prodhimit  |
| KMN              | Kompani multinacionale  |
| OECD             | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik  |
| PPP              | Partneriteti publik-privat  |
| H&ZH             | Hulumtim dhe zhvillim   |
| KRB              | Këshilli Rajonal për Bashkëpunim  |
| RIS <sup>3</sup> | <i>Research and Innovation Strategies for Smart Specialisation</i><br>Strategjitë e hulumtimit dhe zhvillimit për specializim të zgjuar |
| ABV              | Akti për biznese të vegjël  |
| EJL              | Evropa Juglindore   |
| NVM              | Ndërmarrje të vogla dhe të mesme  |
| NSH              | Ndërmarrje shtetërore Industrial  |
| SWOT             | Përparësi, mangësi, mundësi dhe kërcënime   |
| UNCTAD           | <i>United Nations Conference on Trade and Development</i><br>Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim                  |
| UNIDO            | United Nations Industrial Development Organization<br>Organizata e Zhvillimit Industrial të Kombeve të Bashkuara                        |
| SHBP             | Shtetet e Ballkanit Perëndimor  |
| FEB              | Forumi Ekonomik Botëror   |

### Rezyme ekzekutive

Sektori industrial është themel i rëndësishëm i ekonomisë dhe është ngushtë i lidhur me temat më të rëndësishme ekonomike, siç janë: rritja ekonomike, investimet, eksporti, punësimi, hulumtimi dhe zhvillimi, produktiviteti, vlera e shtuar, inovacionet dhe ngjashëm. Rëndësia e sektorit industrial është arsyeja që Republika e Maqedonisë e miratoi Politikën e saj të parë industriale në vitin 2009, ndërsa rëndësia e vazhdueshme e saj është arsyeja për strategjinë aktuale.

Pas hartimit dhe miratimit të Strategjisë së parë, rëndësia e sektorit industrial u rrit. Nga viti 2009 e këndej, disa zhvillime, në masë të konsiderueshme, e ndryshuan kontekstin ekonomik të një numri të madh të ekonomive. Kriza ekonomike dhe financiare nga dekada e fundit e riformatuan peizazhin ekonomik. Nga ana tjetër, arritjet e rëndësishme teknologjike siç është robotika, prodhimi aditiv, inteligjenca artificiale dhe ngjashëm, e nënkuptojnë dukurinë e mundësive të reja të cilat në mënyrë të përsheptuar ndikojnë mbi natyrën e zinxhirëve të vlerave globale industriale, rajonale dhe nacionale. Së këtejmi, në nivel të Bashkimit Evropian (BE), si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, janë vendosur iniciativa të reja politike dhe rrjedha financiare, me fokus shumë më të madh mbi politikën industriale, teknologjitë kryesore (KET), specializimin e zgjuar etj. Të gjitha këto, në masë të madhe, ndikojnë mbi ekonominë maqedonase.

Këto ngjarje, në kombinim me Qeverinë e re në vitin 2017 me spektrin e saj unik të politikave, institucioneve dhe iniciativave për financim, nënkuptojnë se ekziston nevoja jo vetëm të ripërtërihet politika industriale e vendit, por e njëjta të ri-fokuset në sektorë të cilët ofrojnë potencial më të madh për ndikim mbi produktivitetin dhe rritjen, përfshirë këtu edhe tërheqjen e investimeve, stimulimin e eksportit, rritjen e cilësisë dhe vende të punës më mirë të paguara, njëkohësisht duke kontribuar në rritjen e qëndrueshmësisë i përket ekonomisë cirkulare dhe industrisë së gjelbër.

Në Republikën e Maqedonisë, industria përpunuese merr pjesë me 12,2% në BPV (në vitin 2016). Progresi, në këtë fushë, ka rëndësi të jashtëzakonshme për vet politikën, por gjithashtu edhe sa i përket kontekstit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), jo vetëm për shkak të faktit që Politika industriale ishte përcaktuesi i fundit i negociatave për anëtarësim për vendet candidate aktuale (për Shqipëri, Serbia dhe Mali i Zi), si dhe për ish-vendet candidate (për Shqipëri, Bullgaria dhe Kroacia). Pritshmëritë shkojnë në drejtimin që kjo të jetë e rëndësishme gjatë negociatave të ardhshme për anëtarësim. Prandaj, me rëndësi thelbësore është që vendi të zhvillojë një kornizë të qartë për mbështetjen e sektorit të industrisë përpunuese.

Politika industriale gjithnjë e më shumë është në agjendën qeveritare të BE, dhe veçanërisht në atë të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Politika industriale synon të jetë gjithëpërfshirëse, megjithatë, gjithnjë e më shumë vjen në shprehje roli i rëndësishëm i industrisë përpunuese. Në Republikën e Maqedonisë çështjet kyç janë evidente e që e fuqizon nevojën e Strategjisë industriale të fokusohet mbi industrinë përpunuese:

- Ekziston nevoja e rishikimit dhe azhurnimit të politikës / strategjisë paraprake industriale;
- Politika paraprake industriale ishte gjithëpërfshirëse dhe gjenerike. Vlerësimi i ndikimit të saj manifestoi ndikim të pjesshëm, por nga ana tjetër edhe dobësi, siç është nevoja e sigurimit të financimit të rritur në masë të konsiderueshme nga ana e shtetit, të plotësohet financimi nga ana e shtetit me financa / INF nga donatorë, si dhe

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

të sigurohet liderizëm efikas, koordinim, dialog publik privat, raportim, monitorim dhe evaluim të Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit;

- Ekzistojnë edhe strategji të tjera nacionale që kanë të bëjnë me konkurrencën, inovacionet dhe ngjashëm, kështu që ka vend të kufizuar për strategji tjetër horizontale;
- Ekzistojnë shumë institucione në fushën e konkurrencës, inovacioneve, IHD, etj., dhe së këtejmi është e rëndësishme që strategjia e re të targetohet, që të evitohet mbivendosja, edhe pse disa janë të pashmangshme, si dhe mund ta shtojnë vlerën, nëse koordinohen në mënyrë efikase;
- Ekziston nevoja të pranohet korniza e programeve të Planit të ri për rritje ekonomike (PRRE) në të cilin në mënyrë të veçantë theksohet prodhimtaria.

Së këtejmi, ekziston justifikim i fuqishëm që kjo Strategji të fokusohet mbi industrinë përpunuese, meqë kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për rritjen, produktivitetin, vendet e punës me cilësi të lartë, inovacionet, eksportin, Ekonominë cirkulare etj. Fokusi i këtillë është në përputhje me angazhimet e mëdha gjatë dekadës së fundit për tërheqjen e suksesshme të investimeve të huaja direkte (IHD) në zonat zhvillimore teknologjike industriale (ZZHTI), i cili ia arriti ta rris profilin dhe imazhin e vendit, njëkohësisht duke iu kundërvënë tendencës evidente të deindustrializimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Strategjia industriale është rezultat i punës së kryer vëllimore gjatë vitit 2017-2018, me mbështetjen e BE-së. Analiza mbështetet mbi perspektivat globale, evropiane, të Ballkanit Perëndimor dhe mbi perspektivat e Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe katër takimet konsultative me institucionet relevante qeveritare, si dhe sektorin privat dhe përfaqësuesit e tij.

Në thelbin e saj, politika industriale me fokus mbi industrinë përpunuese e ka këtë **Vizion**:

“Avancimi i **industrializimit** përmes stimulimit të rritjes dhe zhvillimit të **industrisë përpunuese**, me qëllim të rritjes së **produktivitetit**, krijimit të **vendeve të mira të punës**, rritjes së të ardhurave dhe fuqizimin e **kapitalit njerëzor**, njëkohësisht duke i zgjidhur sfidat e **Ekonomisë cirkulare**.”

Vizioni do të arrihet përmes fokusimit mbi pesë **Qëllimet strategjike**, duke e përfshirë edhe elementin ndër-sektorial, për aspektet horizontale të implementimit dhe koordinimit:

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese



Pjesa tjetër e dokumentit i përcakton analizat e politikave, si dhe analizat institucionale, statistikore, analizat SWOT, si dhe analizat e tjera të cilat çojnë drejt qëllimeve strategjike, ndërkaq secili prej tyre identifikon një sërë masash (gjithsej 38) që duhet të implementohen prej tani e deri në fund të vitit 2027.

Strategjia e përfshin fokusin e koordinimit dhe implementimit, duke përfshirë çështje siç është roli i Ministrisë së Ekonomisë, në ç'mënyrë do të koordinohet, financohet, monitorohet dhe vlerësohet Strategjia. Përveç Strategjisë, është hartuar edhe Plani i Veprimit për periudhën kohore 2018-2020.

### 1. Hyrje

#### 1.1 Politika e rishikuar industriale

Sektori industrial është themel i ekonomisë i cili është ngushtë i lidhur me temat kryesore ekonomike, siç janë: rritja ekonomike, investimet, eksporti, punësimi, hulumtimi e zhvillimi, produktiviteti, vlera e shtuar etj. Rëndësia e sektorit industrial është arsyeja që Republika e Maqedonisë e miratoi Politikën e saj të parë industriale në vitin 2009 dhe është arsyeja për strategjinë aktuale.

Nga viti 2009 e këndej, disa zhvillime të rëndësishme në mënyrë dramatike e ndryshuan kontekstin ekonomik të një numri të madh të ekonomive. Kriza ekonomike dhe financiare nga dekada e fundit e riformatuan mjedisin ekonomik. Përveç kësaj, arritjet e rëndësishme teknologjike siç është robotika, prodhimi aditiv, inteligjenca artificiale dhe ngjashëm, e nënkuptojnë dukurinë e mundësive të reja të cilat në mënyrë të përshpejtuar ndikojnë mbi natyrën e zinxhirëve të vlerave globale industriale, rajonale dhe nacionale. Së këtejmi, në nivel të Bashkimit Evropian janë vendosur iniciativa të reja politike dhe rrjedha financiare (për shembull, fokus shumë më i madh mbi politikën industriale, teknologjitë kryesore (KET), specializimin e zgjuar etj.), si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të cilat në masë të madhe ndikojnë mbi ekonominë maqedonase.

Këto zhvillime, në kombinim me ardhjen e Qeverisë së re në vitin 2017 me spektrin e saj unik të politikave, institucioneve dhe iniciativave për financim, konsistojnë atë se ekziston nevoja jo vetëm të ripërtërihet politika industriale e vendit, por e njëjta të ri-fokuset në sektorët të cilët ofrojnë potencial më të madh për ndikim mbi produktivitetin dhe rritjen, përfshirë këtu edhe tërheqjen e investimeve, stimulimin e eksportit, rritjen e cilësisë dhe vende të punës më mirë të paguara, njëkohësisht duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme lidhur me Ekonominë cirkulare dhe industrinë e gjelbër.

#### 1.2 Politika industriale si qasje gjithëpërfshirëse

Politika industriale (PI) nënkupton çështje të ndryshme për vende të ndryshme. Ekzistojnë përkufizime të ndryshme, por përkufizimi më i pranuar është ai se PI përfshin *çdo lloj mase qeveritare ose spektër të masave për promovimin ose prezantimin e ndryshimeve strukturore*. (Curzon Price, 1981).

Ky është një përkufizim i gjerë, por në të vërtetë qëllimi i PI korrespondon me përshpejtimin e ndryshimeve strukturore drejt aktiviteteve më dinamike ose më produktive. Në një mënyrë ose në mënyrë tjetër PI duhet të fokusohet mbi përmirësimin e çështjeve kryesore, siç është produktiviteti, konkurrenca dhe rritja ekonomike. Politika industriale, veç tjerash, mund të përkufizohet edhe si angazhim strategjik nga ana e shtetit për stimulimin e zhvillimit dhe rritjes së një sektori të caktuar të ekonomisë.

Qasja e përdorur në këtë dokument për politikën është një miks i qasjeve funksionale / horizontale dhe selektive / vertikale, të përshtatura me specifikat e vendit përmes shfrytëzimit të përkufizimit të OECD për PI (2013, *Beyond Industrial Policy*, p.16):

*“Politika industriale nënkupton çdo formë të intervenimit ose të politikës shtetërore të fokusuar drejt avancimit të mjedisit afarist, përkatësisht ndryshimit të strukturës së aktivitetit ekonomik drejt sektorëve, teknologjive ose detyrave prej të cilave pritet kontribut më i madh për rritjen ekonomike ose për mirëqenien shoqërore, ndërsa një gjë e këtillë nuk do të ndodhte nëse do të mungonte ky intervenim.”*



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Ky dokument ka të bëjë me “politikën” dhe “strategjinë industriale”. Nocioni “strategji” ka të bëjë me planin e hartuar unik me qëllim që të arrihet pozitë konkurrense, si dhe të përmbushen objektivat e politikës. Kjo është korniza e cila shpie në drejtim të realizimit të objektivave të politikës. Nocioni “politikë” ka të bëjë me një përmbledhje të rregullave të përgjithshme për miratim racional të vendimeve. Dallimi kryesor, midis politikës dhe strategjisë, konsiston me atë se politika është udhëzuese për të menduar dhe vepruar vendimmarrësit, ndërsa strategjia ka të bëjë me drejtimin në të cilin burimet njerëzore, financiare dhe fizike do të shpërndahen në mënyrë që të maksimalizohen shanset për arritjen e qëllimit të zgjedhur në lidhje me sfidat konkurruese të politikës.

### 1.3 Leksione nga Politika industriale e R. të Maqedonisë 2009-2020

Republika e Maqedonisë e miratoi politikën e parë industriale 2009-2020 si qasje gjithëpërfshirëse për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese. Në këtë dokument janë identifikuar pesë fusha të veprimit:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe stimulimi i Investimeve të huaja direkte (IHD)
- Hulumtime të aplikuara, zhvillim dhe inovacione (H&ZH)
- Produkte dhe shërbime ekologjike për zhvillim të qëndrueshëm
- Zhvillimi i NVM dhe sipërmarrësisë
- Bashkëpunimi në klasterë dhe rrjete.

Dokumenti origjinal për politikën industriale u plotësua me dy plan veprime. Revizioni i PI origjinale mbështetj mbi vlerësimin e implementimit të saj e cila i dëshmoi arritjet pozitive dhe dobësitë gjatë implementimit (Shih: Kornizën në vijim).

#### **Korniza 1: Vlerësimi i Politikës paraprake industriale: konstatime kryesore**

Konstatimet kryesore dhe leksionet nga PI paraprak të Republikës së Maqedonisë janë si vijon:

- PI e re nuk duhet të jetë politikë, por strategji industriale dhe plan veprim;
- Strategjia e re industriale (SI) duhet të përmbaj elemente të praktikave të mira, përfshirë edhe analizën, SWOT, vizionin, objektivat, qëllimet strategjike dhe udhëzimet për masat të cilat duhet të zhvillohen në planin e veprimit;
- Plan veprimi i ri industrial duhet të përmbaj elemente të politikave të mira, duke përfshirë masa, përgjegjësi, bashkë-përgjegjësi, afate kohore, indikatorë kryesorë të suksesit etj.
- Korniza kohore duhet ta pasqyroj, aq sa është e mundur, kornizën kohore 7 – vjeçare të BE-së, meqë kjo do të vazhdoj të jetë burimi kryesor i financimit në të ardhmen dhe meqë prioritetet politike të rrjedhave financiare ndryshojnë në çdo 7 vjet;
- Buxheti i vazhdueshëm i Ministrisë së Ekonomisë prej 25.000 euro për mbështetjen e PI nuk është autentik dhe nuk e justifikon PI-në e re. Ministria e Ekonomisë doemos duhet të bëjë një shpërndarje dukshëm më të madhe financiare për zhvillimin industrial, me fokus mbi industrinë përpunuese. Impenjimët e këtilla duhet të jenë afatmesme dhe të garantuara, në mënyrë që të sigurojnë vazhdimësi dhe planifikim efektiv;
- Ministria e Ekonomisë duhet të fokusohet mbi krijimin e politikave, në vend të implementimit të programit. Në Ministri ka disa të punësuar aktivë dhe të njëjtit janë të mbingarkuar. Si rezultat i kësaj, krijimi i politikave shënon zhvillim të pamjaftueshëm, ndërsa implementimi është i dobët. Implementimi i programeve nuk është roli kryesor i ME-së, edhe atë jo vetëm për shkak të sfidave sistematike me kuadrin. Ekzistojnë agjenci mirë të strukturuar për implementim, në mesin e të cilave edhe AMSRM, të cilat janë të etshme për mjete financiare. Ndarja e krijimit të politikave dhe implementimi i plan veprimit/programit është po aq i rëndësishëm sa edhe sigurimi i mjeteve përkatëse për implementim;
- Madje edhe me mjete më të mëdha financiare nga shteti, me rëndësi esenciale është të plotësohen resurset për PI përmes donatorëve/INF. Prandaj, Ministria e Ekonomisë duhet të bëjë angazhime të konsiderueshme të ndërmerr koordinim të rregullt (për shembull, tremujor) të donatorëve, me qëllim që në të ardhmen të pozicionohet për sigurimin e financave në nivel të konsiderueshëm më të mëdha nga fondet joqeveritare;
- Ministria e Ekonomisë duhet të vendos dy mekanizma për koordinim për strategjinë industriale dhe planin e veprimit

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

(edhe pse mund të mbuloj edhe tema siç është NVM dhe eksporti):

- Koordinimi ndërqeveritar: të sigurohet progres, të evitohen vonesat dhe pengesat.
- Koordinimi publik-privat: të sigurohet se palët e interesuara nga sektori afarist janë përfshirë në procesin e PI.
- Ministria e Ekonomisë doemos duhet të vendos sistem autentik për M&E dhe raportim për strategjitë dhe planet e veprimit për industrinë/NVM:
  - Raportimi: raportimi aktual vjetor filloi mirë, por ishte i paqëndrueshëm dhe nuk mundëson raportim efektiv për shfrytëzimin e mjeteve publike. Kjo në të ardhmen duhet të përforcohet.
  - Monitorimi: monitorimi rrjedhës është i dobët, jo konsistent dhe nuk mundëson monitorim të shfrytëzimit të mjeteve publike. Kjo, në të ardhmen, duhet të përforcohet.
  - Evaluimi: çështja e evaluimit është përmendur në strategjitë e ME, por nuk ekziston. Përgjithësisht është ky vlerësim dhe vlerësimi i klasterëve, prej të cilëve që të dy janë drejtpërdrejt të ndërlidhur me këtë detyrë. Kjo është një dobësi e madhe në krijimin e politikave të Ministrisë së Ekonomisë (për shembull, financimi afatgjatë publik për klasterë të cilët në të vërtetë janë shoqata afariste) ndërkaj në të ardhmen duhet rregullisht të ndërmerren (përmes Seksionit për M&E).
- Strategjia e re industriale duhet të përbëhet nga elemente horizontale dhe të ketë theks më të fuqishëm sektorial në bazë të parimit të specializimit të zgjuar;
- Duhet të ekzistoj koordinim me strategji të tjera dhe jo vetëm me strategjinë për konkurrencë / inovacione. Nga ana tjetër, nevojitet të merret parasysh zhvillimi i politikave për NVM / mjedisi afarist, politika tregtare, politika e konkurrencës, politika investuese, politika zhvillimore në tregjet e punës dhe kapitalit, politika të mjedisit jetësor, zhvillimi teknologjik dhe transferimi i beneficioneve;
- Duhet të evitohet mbivendosja me strategji dhe plan veprime të tjera, mes tjerash edhe me strategjitë e ME: NVM, Sipërmarrësia e grave etj. dhe me strategjitë e ministrive të tjera (p.sh.: konkurrenca, inovacione, hulumtime dhe zhvillim etj.);
- Ekziston nevoja që Ministria e Ekonomisë të përcaktoj agjendë "industriale", e cila nuk mbivendoset me agjendat ekzistuese për politika;
- Ekziston nevoja që PI e re të ndërlidhet dhe të mundësoj të jetë komplementare me fokus mbi politikën industriale të KE, fokus më të madh të prodhimit dhe lidhjen e qasjes rajonale në EJK 2020;
- Nevojitet që plani i veprimit për PI të fokusohet mbi masat prioritare, me ç'rast do të rriten shanset për fitimin e mjeteve shtetërore / donatore. Duke i pasur parasysh kapacitetet reale dhe resurset e mundshme, nevojitet fokusimi mbi më pak masa, dhe jo mbi më shumë masa;
- Ekziston nevoja për ndërtimin e kapaciteteve për punësim në ME, me qëllim që të mundësohet fokusim më i mirë mbi politikën, koordinimin, M&E dhe angazhimet me BE/MBE/SRS/OECD etj, duke përfshirë edhe aplikime për financim nga INF / donatorë / KE.

Burimi: Pinto, R., 2017, Vlerësim mbi Politikën industriale të Maqedonisë, 2017

Analiza e pasqyruar në kornizën më lartë paraqet vlerësim të detajuar të asaj që nuk ka funksionuar më së miri dhe rekomandime për të ardhmen, të cilat u morën parasysh gjatë hartimit të këtij dokumenti. Megjithatë, "Ata të cilët nuk nxjerrin mësim nga gabimet e pararendësve të tyre, gabimet e njëjta do ti përsërisin" (George Santayana).

### 1.4 Nevoja për Strategji industriale

Mbarë bota, përfshi edhe vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanit Perëndimor (BP), sërish e zbulojnë rëndësinë e politikës industriale pas krizës së fundit ekonomike dhe financiare. Theksi i politikës industriale, me kalimin e kohës, shënon rritje dhe është veçanërisht i rëndësishëm për vendet candidate, siç është Republika e Maqedonisë, jo vetëm për shkak të faktit se politika industriale është pjesë e Kapitullit *Acquis Communautaire*- Programi nacional për miratimin e legjislacionit evropian (konkretisht Kapitulli 20 nga NPAA: Ndërmarrje dhe politika industriale), me ç'rast në fazën e negociatave për anëtarësim në BE do të nevojitet të zhvillohen negociata dhe të dakordësohet me Brukselin. Pastaj, ekziston një numër gjithnjë e më i madh i politikave dhe iniciativave për financim, përfshirë këtu edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, të cilat Republika e Maqedonisë mund t'i shfrytëzoj në përpjekjet për ta rritur konkurrencën, inovacionin dhe nivelin e produktivitetit.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Politikat industriale lëvizin prej atyre selektive deri në politikat funksionale. Politikat selektive përqipen të “zgjedhin fitues”, duke mbështetur firma konkrete, kampionë industrial, konglomeratë ose projekte investuese. Politikat funksionale e promovojnë “konkurrencën” e sektorëve (për shembull, industria përpunuese), madje edhe ofertën në ekonomi përmes masave të fokusuara mbi konkurrencën, inovacionet, mjedisin afarist dhe ngjashëm. Në nivel të sektorëve ose teknologjive, politika industriale përqipet “t’i kundërvihet” përparësisë statike komparative të vendit dhe ta zhvilloj përparësinë e vet komparative “latente”, për shembull, përmes mbështetjes së industrive të caktuara, reformave, investimeve, subvencioneve, etj. Edhe pse politika industriale nuk është kufizuar në industrinë përpunuese, ky është theksi i kësaj Strategjie. Transformimi strukturor i vendeve në tranzicion kërkon zhvillim të industrisë përpunuese e cila mund të ofroj nivele më të larta të produktivitetit, vlerës së shtuar, punësimit me cilësi të lartë etj., të cilat janë harmonizuar me ndarjen ndërkombëtare të punës.

Është evidente se Strategjia industriale është e veçantë dhe e ndryshme nga iniciativat e tjera të politikave me fokus mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), konkurrencën, inovacionet etj. Elementet, të cilët i japin vlerë të shtuar strategjisë së re industriale, kanë të bëjnë me atë se ajo do të fokusohet konkretisht mbi industrinë përpunuese (krahasuar me dokumentin paraprak, i cili për nga natyra ishte horizontal) dhe është instaluar në politikën e re ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, përkatësisht Plani për rritje ekonomike (PRRE), i cili është fokusuar mbi sektorin produktiv/industrinë përpunuese dhe i njëjti do të ketë përfitim nga mbështetja e konsiderueshme financiare. Nga ana tjetër, kjo strategji nxjerr mësim nga përvojat e deritanishme gjatë implementimit të politikës paraprake industriale, e inkorporon kornizën politike në iniciativat dhe financat e aksesshme në BE dhe Ballkanin Perëndimor, që është mjaft e rëndësishme dhe njëkohësisht është e rëndësishme edhe në kontekstin e përpjekjeve të vendit që të anëtarësohet në BE.

Prandaj, analiza u fokusua në dy çështjet si vijon:

- Politikat, strategjitë dhe institucionet që kanë të bëjnë me politikën industriale (Kapitulli 2);
- Natyra e industrisë përpunuese, që rezulton me analizën e përparësive, mangësive, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT) (Kapitulli 3).

Analizat e përfshira në Kapitullin 2 dhe 3 kontekstin e Strategjisë industriale e vendosin me fokus mbi industrinë përpunuese:

- Vizioni, objektivat, qëllimet strategjike dhe masat prioritare janë prezantuar në Kapitullin 4;
- Korniza e implementimit, duke e përfshirë koordinimin, konsultat, raportimin, monitorimin dhe evaluimin, janë prezantuar në Kapitullin 5.

Plan veprimi i parë për zbatimin e Strategjisë industriale, me fokus mbi industrinë përpunuese është prezantuar në Aneksin 2 dhe e mbulon periudhën kohore deri në vitin 2020. Në Aneksin 1 janë përfshirë të dhëna statistikore në lidhje me analizën e pjesës së prodhimit, të prezantuara në Kapitullin 3.

## 2. Politika industriale, strategjitë dhe institucionet

Ky Kapitull i pasqyron arsyet për fokusin gjithnjë e më të madh mbi politikën industriale në tërësi dhe, veçanërisht mbi industrinë përpunuese. Këtu është vendosur konteksti përmes analizës së perspektivës së BE / perspektiva ndërkombëtare, si dhe arsyet e strukturës organizative qendrore të prodhimit. Pastaj, analiza kryesisht fokusohet mbi kornizën

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

aktuale politike të Republikës së Maqedonisë, dhe jo vetëm mbi Planin e ardhshëm për rritje ekonomike (PRRE). Pastaj, i vendos institucionet kryesore aktuale dhe të ardhshme që kanë të bëjnë me politikën industriale. Së këtejmi formohet konteksti për fokusin eksplicit mbi industrinë përpunuese, duke i përfshirë edhe tendencat dhe sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet.

### 2.1 Politika industriale: zhvillimet e fundit

#### 2.1.1 Bashkimi Evropian (BE) dhe Politika industriale

##### *Korniza e Politikës industriale*

Politika industriale, në nivel të BE, në të vërtetë është sigurimi i kushteve kornizë për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe inovacioneve, në mënyrë që të bëhet rajon atraktiv për investime industriale dhe për hapjen e vendeve të reja të punës.

Komunikimet e Komisionit Evropian (KE), të prezantuara në kornizën në vijim, bashkë me politikën e re (2017, shih më poshtë), paraqesin përkushtim konsistent dhe në rritje të politikës nga ana e BE në drejtim të rëndësisë së veçantë të industrisë në krijimin e vendeve të punës dhe rritjes, si dhe përfshirjen e konkurrencës në lidhje me industrinë në fusha të ndryshme të politikës.

##### **Korniza 2: Kriteret e Politikës Industriale në KE (faza e 5-të)**

- Komunikimi i Komisionit "Politika industriale: fuqizimi i konkurrencës" (SOM (2011) 0642) bëri apel për reforma të thella strukturore për politika koherente dhe të koordinuara tek Vendet-anëtare, duke specifikuar disa fusha kryesore siç është legjislacioni i zgjuar, qasja deri te financat, tregu unik, etj.
- Komunikimi i Komisionit "Industri më e fuqishme evropiane për rritje dhe rimëkëmbje ekonomike" (SOM (2012) 582/3) u fokusua mbi katër shtylla për promovimin e konkurrencës industriale: investime në inovacione, kushte më të mira tregu, qasja deri te financat dhe kapitali, si dhe aftësitë e kapitalit njerëzor. Në lidhje me investimin në inovacione, fokusi është mbi gjashtë aksione prioritare: teknologji të avancuara përpunuese për prodhim të pastër; teknologji kryesore; produkte të bazuara -bio; politika e qëndrueshme industriale dhe e ndërtimitarisë dhe lëndët e para; automjete të pastra dhe objekte lundrimi; dhe rrjete të zgjuara.
- Komunikimi i Komisionit "Për rnesancë industriale evropiane" (SOM (2014) 0014) theksoi se Evropa në mënyrë urgjente duhet ta vendos bazën e rritjes dhe modernizimit pas krizës. Që të arrihet një gjë e këtillë, Vendet-anëtare u ftuan ta njohin rëndësinë qendrore të industrisë për krijimin e vendeve të punës dhe rritjes, si dhe shqetësimet që kanë të bëjnë me konkurrencën t'i orientoj në industri edhe atë në të gjitha fushat e politikës.

Burimi: Politika industriale e BE: Vlerësimi i zhvillimeve të fundit dhe rekomandime për politikën e ardhshme, 2016


Është evidente se ekziston theks i rritur nga ana e BE-së për politikën industriale, e cila gjithashtu, gjithnjë e më shumë, fokusohet mbi rolin kritik të industrisë përpunuese në kuptimin e stimulimit të inovacioneve, eksportit, produktivitetit, vlerës së shtuar, H&ZH, vendeve të mira të punës, pagave etj. Thuaja se çdo vend i katërt i punës, në sektorin privat në BE është në industri, shpeshherë me kualifikim të lartë, ndërsa nga ana tjetër çdo vend i ri i punës në industrinë përpunuese krijon 0,5-2 vende pune në sektorët e tjerë.

Vitin e kaluar, KE / BE e publikoi komunikimin e fundit për PI (Investim në industrinë e zgjuar, inovative dhe të qëndrueshme SOM (2017) 479). Komunikimi i fundit i thekson objektivat e politikës industriale të BE dhe synon ti stimuloj industrinë që të krijojë vende pune dhe rritje të cilat në këtë mënyrë do të vihen në mbrojtje të rajoneve të tyre dhe punëtorëve të cilët janë më së shumti të goditur nga ndryshimet industriale dhe njëkohësisht do ta fuqizoj dhe mbroj rolin lider të Evropës, konkurrenshëmërinë e saj dhe teknologjinë e lartë. Kjo qasje i përsëritë parimet e definuara paraprakisht (shih: në kornizën më lartë), si dhe e thekson tregun unik, avancimin e industrisë për epokën digjitale, ekonominë cirkulare dhe ekonominë me nivel të ulët të karbonit, inovacionet, investimet dhe internacionalizimin, siç është

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

pasqyruar në diagramin në vijim. Me sfidat e reja nuk ballafaqohen vetëm Vendet-anëtare të BE-së; ato gjithashtu kanë të bëjnë edhe me Republikën e Maqedonisë dhe duhet të merren në konsideratë që të mundet në mënyrë efikase pjesërisht t'i absorbojnë mjetet për zhvillim nga BE.

**Diagrami 1. Vizioni holistik i industrisë evropiane**



Burimi: Investimi në industrinë e zgjuar, inovative dhe të qëndrueshme (2017)

Rëndësinë që BE ia përkushton zhvillimit industrial pasqyrohet në objektivin të cilin e përcaktoi ai, me fjalë të tjera se industria në vendet e BE-së duhet të arrijë 20% nga BPV deri në vitin 2020. Megjithatë, me 15,1%, të kontributit të industrisë përpunuese në BPV të BE-së vazhdoi të shënojë rënie, ndërsa deri në vitin 2020 objektivi mbase sigurisht nuk do të realizohet.

Nga ana tjetër, KE zhvilloi edhe plan veprime për sektorë të caktuar, si dhe ligje të zgjuara të cilët i mbështesin sektorët kryesorë industrial, duke e përfshirë industrinë kimike; industrinë automobilistike; turizmin; tekstilin; industrinë e modës dhe kreativitetit; lëndët e para, metalet, mineralet dhe industritë pyjore; inxhinieringun mekanik; inxhinieri elektrike dhe elektronike; industrinë e ushqimit dhe pijeve; kujdesin shëndetësor; bioteknologjinë; aeronautikën dhe industrinë detare. Është e qartë se këto varen nga specifikat e vendeve dhe rajoneve të caktuara, duke e shfrytëzuar parimin e specializimit të zgjuar, diçka që po ashtu promovohet edhe në Ballkanin Perëndimor dhe në Republikën e Maqedonisë.

### *Specializimi i zgjuar*

“Specializimi i zgjuar” (shih: Kornizën në vijim) bëhet instrument gjithnjë e më i rëndësishëm i BE-së, i cili u mundëson shteteve dhe rajoneve t'i fokusojnë investimet në përparësitë e tyre të konkurrueshmërisë dhe ta stimulojnë krijimin e zinxhirëve ndër-evropian të vlerave.

### **Korniza 3: Specializimi i zgjuar**



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Nocioni specializim i zgjuar e vendos lidhjen midis politikës rajonale dhe Unionit të Inovacioneve në agjendën e BE 2020. Kjo është një qasje strategjike në drejtim të zhvillimit ekonomik përmes mbështetjes së fokusuar për hulumtim dhe inovacione dhe i njëjti u publikua në Iniciativënkryesore të Unionit të Inovacioneve në Strategjinë: Evropa 2020 si aksion kyç i politikës kohezive në fushën e inovacioneve. Baza juridike për specializimin e zgjuar është Rregullorja (BE) 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga data 17 dhjetor të vitit 2013, e cila e përcakton këtë definicion:

*“Strategjia për specializim të zgjuar nënkupton strategji nacionale ose rajonale për inovacione e cila i vendos prioritetet në mënyrë që të ndërtoj përparësi të konkurrenshme përmes zhvillimit dhe lidhjes së fuqive të veta për hulumtim dhe inovacione me nevojat e biznesit, me qëllim të krijimit të mundësive të reja dhe zhvillimit të tregut në mënyrë koherente duke i evituar mbivendosjet dhe fragmentimin e angazhimeve të palëve të interesuara. Strategjia për specializim të zgjuar mund të ketë formë, ose të përfshihet në kornizën nacionale ose rajonale për politikë strategjike për hulumtime dhe inovacione (H&I). Strategjitë për specializim të zgjuar do të zhvillohen përmes përfshirjes së organeve udhëheqëse nacionale ose rajonale dhe përmes palëve të interesuara, siç janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, industria dhe partnerët social në procesin e zbulimeve të sipërmarrësisë.”*

Zhvillimi i “strategjive për hulumtim dhe inovacione për specializimin e zgjuar” u propozua si parakusht për vendet dhe rajonet, në mënyrë që të maksimizohet ndikimi i investimeve të BE. Ideja është të fokusohet mbi atë që rajonet tanimë e bëjnë më së miri dhe të njëjtën ta bëjnë akoma më mirë përmes kombinimit të inovacioneve ekzistuese nga përparësitë dhe mjetet themelore rajonale (për shembull, përparësitë ekzistuese të konkurrenshme). Këtu, jo domosdoshmërisht bëhet fjalë për specializim, por për dhënien ndihmë gjatë krijimit të inovacioneve të cilat në fund mund të ndërlihen me strukturën ekzistuese industriale dhe të cilat fokusohen mbi disa prioritetet, me ç’rast krijohet masë e mjaftueshme kritike që të bëhet dallimi. Më shumë se 40 miliardë euro do të orientohen kah “Specializimi i zgjuar” nga fondet e komunitetit, duke shfrytëzuar mjete nga sektori publik dhe privat.

Burimi: Politika Industriale e BE: Vlerësimi i zhvillimeve të fundit dhe rekomandimeve për politikën e ardhshme, 2016

Specializimi i zgjuar është instrument për koncentrimin e investimeve ekonomike në fushat në të cilat vendi/rajoni ka masë kritike të njohurive, kapaciteteve dhe kompetencave ku ka edhe potencial novator për vendosjen e vendit/rajonit në tregjet globale dhe me këtë edhe rritjen e reputacionit. Parimet për specializim të zgjuar janë ilustruar në tabelën si vijon.

**Tabela 1. Parimet e specializimit të zgjuar**

|                              |  |
|------------------------------|--|
| <b>Rritje e zgjuar</b>       | Arsimi (inkurajimi i njerëzve të mësojnë, studiojnë dhe t'i azhurnojnë aftësitë e tyre);<br>Hulumtimi/inovacione (produktet/shërbimet e reja gjenerojnë rritje, vende pune dhe i zgjidhin sfidat shoqërore)<br>Shoqëria digjitale (shfrytëzimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit).   |
| <b>Rritje qëndrueshme</b>    | Ndërtimi i ekonomisë konkurrense me përdorimin e ulët të karbonit e që mundëson shfrytëzim të qëndrueshëm dhe efikas të resurseve;<br>Mbrojtja e mjedisit jetësor, reduktimi i emisioneve dhe parandalimi i çrregullimit të biodiversitetit;<br>Zhvillimi i teknologjive të reja të gjelbra dhe metodave të prodhimit;<br>Inkorporim të rrjeteve të zgjuara efikase elektrike;<br>Shfrytëzimi i rrjetit në nivel të BE, në mënyrë që t'u ofrohet firmave përparësi të konkurrenshme (për shembull, industria përpunuese);<br>Përmirësimi i mjedisit afarist, veçanërisht për NVM;<br>Ndihmë konsumatorëve që të bëjnë përzgjedhje mirë të informuar. |
| <b>Rritje inkluzive</b>      | Rritja e shkallës së punësimit në Evropë (më shumë vende pune dhe vende më të mira pune);<br>Ndihmë njerëzve të të gjitha moshave që të ballafaqohen me ndryshimet përmes investimit në aftësi dhe trajnim;<br>Modernizimi i tregjeve të punës dhe sistemeve sociale;<br>Sigurimi i përfitimeve nga rritja në të gjitha pjesët e BE.   |
| <b>Administrimi ekonomik</b> | Agjendë e përforcuar ekonomike me mbikëqyrje më të madhe të BE;<br>Aksion për mbrojtjen e stabilitetit të euro-zonës;<br>Aksion për përtëritjen e sektorit financiar.  |

Burimi: KE (2011) “Evropa 2020”

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

KE, gjithashtu, zhvilloi Platformë për specializim të zgjuar ([www.s3platform.irc.ec.europa.eu](http://www.s3platform.irc.ec.europa.eu)) me tema siç është industria e avancuar përpunuese, ekonomia cirkulare, teknologjitë kryesore (KET – shihni më poshtë), transformimi digjital/industria digjitale 4.0 (shih më poshtë) etj. S3 në të vërtetë është qasje strategjike drejt zhvillimit ekonomik, përmes mbështetjes së fokusuar mbi hulumtimin dhe inovacionet.

Së këtejmi, fokusi i specializimit të zgjuar ka tendencë të jetë në strategjitë nacionale dhe rajonale për promovimin e inovacioneve dhe jo të politikës industriale ose industrisë përpunuese *per se*, edhe pse një gjë e këtillë është e nevojshme të merret parasysh në këtë strategji dhe në planin e veprimit.

### *Platformazhvillimoreose Teknologjitë kryesore (KET)*

Tendencat e lartpërmendura janë të rëndësishme. Ato duhet të ndërlidhen me lëvizjet e reja shkencore dhe të inxhinierisë, të cilat burojnë nga baza e hulumtimeve dhe inovacioneve, të cilat në të ardhmen pritet të fitojnë relevancë në sistemet industriale/përpunuese (shih: Kornizën në vijim). Platforma zhvillimore/teknologjitë sigurisht se do të kenë rol të rëndësishëm në mundësimin e zgjidhjeve dhe koncepteve në lidhje me prodhimtarinë.

#### **Korniza 4: Platforma zhvillimore ose Teknologjitë kryesore (KET)**

- Fotonika: përfshin skenim, sensorë dhe fotografi; informacione, komunikim dhe rrjete; ekrane dhe displej; ndriçim të avancuar; sisteme fotonike energjetike; dhe sisteme të laserit.
- Bio-teknologjia: përfshin biofarm; inxhiniering dhe ind/mjekësi regjenerative; biologji sintetike; dhe prodhim bio të inspiruar përmes shfrytëzimit të vetëformimit.
- Nanoteknologjia: përfshin nanotuba karboni; materiale strukturore nanokompozite; nanoelektronikë; lubrifikantë të bazuar në nanoteknologji; nanogrimca; dhe nanotags.
- Mikroteknologjia: përfshin prodhimtari me mikro instrumente dhe mikro sisteme në veglat dhe prodhimet e makinerisë.
- Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në sistemet prodhuese: përfshin sisteme mekatronike inteligjente për automatizim dhe robotikë (për shembull, komponentëvet-adaptiv) dhe avancim të kompjuterëve në rrjete për prodhim.
- Materiale të avancuara: përfshin kompozita të avancuara dhe “metamateriale”.

Burimi: UNIDO

Rastet e prezantuara në tabelën më sipër nuk janë gjithëpërfshirës, megjithatë i identifikojnë tendencat e reja ndërkombëtare, me theks mbi “teknologjitë e platformave” të cilat pritet t'i përmirësojnë mundësitë e ardhshme në industrinë përpunuese, në një spektër të gjerë të industrive përpunuese, duke i dhënë mundësi valës së ardhshme të produkteve dhe teknologjive prodhuese me vlerë të lartë. Ndikimi i tyre do të përhapet dhe do të krijoj bazë për zhvillimin e industrive dhe biznes modeleve të reja në të ardhmen, të gjitha me potencial për stimulimin e ndryshimeve strukturore (Grupi i nivelit të lartë për teknologjitë kryesore, 2011). Ato, gjithashtu, janë relevante edhe për teknologji të reja ose të përmirësuara ekologjike dhe energjetike.

BE identifikoi gjashtë Teknologji kryesore (KET) si veçanërisht të rëndësishme. Këto KET kanë aplikime potenciale në një numër të madh të industrive dhe mund të ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave të mëdha shoqërore. Këto janë fusha në të cilat BE ka fuqi shkencore dhe teknologjike që të bëhet lider global, por kërcënohet të shënojë ngecje në komercializimin e mallrave të cilat burojnë nga KET. KET është pjesë fundamentale e Strategjisë së KE për rimëkëmbjen e sërishme të industrisë përpunuese. Për këto ka mjete të dedikuara financiare (për shembull, Horizont2020) dhe janë specifikuar në debatet për Industri 4.0 në vendet-

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

anëtare. Edhe pse ndoshta KET ndryshojnë në Republikën e Maqedonisë, megjithatë duhet të iniciohet debat për çështje siç është KET dhe fabrikat e zgjuara.

### *Digjitalizimi, Industria 4.0 dhe Fabrika 4.0*

“Industria 4.0”, “Fabrika 4.0”, “fabrika e ardhmërisë” dhe “fabrika e zgjuar” janë nocione të cilat shfrytëzohen kur bëhet fjalë për model të ri të fabrikës, i cili është trashëgimtar i tre fazave të mëdha të para të evoluimit të njohura si revolucione, përkatësisht mekanizimi, industrializimi dhe automatizimi. Parimi i Revolucionit të 4-të industrial (ose Industria 4.0) konsiston me atë se përmes lidhjes së makinave, veglave të punës dhe sistemeve, ndërmarrjet krijojnë rrjete inteligjente në mbarë zinxhirin e vlerave të cilat në mënyrë autonome mund të kontrollohen midis tyre, siç është prezantuar në Grafikon në vijim.

Revolucioni i katërt industrial e krijon bazën për “fabrikë të zgjuar”. Ai përpiqet t’i shfrytëzoj dallimet midis sferës fizike, digjitale dhe biologjike, përmes integritit të sistemeve kibernetike – fizike dhe “Interneti të gjërave” (*Internet of Things (IOT)*), të dhënat e mëdha dhe përpunimi në re (*cloud computing*), robotika, sistemet që mbështeten në inteligjencë artificiale dhe prodhimi aditiv. Në krahasim me revolucionet paraprake industriale, ky revolucion u zhvillua me ritëm eksponencial dhe jo me ritëm linear. Ky ka potencial t’i rris (ose reduktoj) nivelet globale të të ardhurave dhe kualitetin e jetës për të gjithë, me implikimin e grupeve të ndryshëm:


- Biznesi: në mënyrë drastike i ndryshon pritshmëritë e klientëve, përmirësimin e produkteve, inovacionet kooperative dhe format e organizimit. Teknologjitë e reja i bëjnë resurset më të qëndrueshme dhe më rezistente, ndërsa të dhënat dhe analizat ndryshojnë mënyrën e qëndrueshmërisë së tyre;
- Qeveria: teknologjitë e reja, gjithnjë e më shumë, iu mundësojnë qytetarëve të lidhen me qeveritë, kreatorët e politikave mund të fitojnë mekanizma për rritjen e kontrollit të tyre mbi popullsinë. Ligjvënësit duhet të bashkëpunoj ngushtë me shoqërinë civile në mënyrë që të mund të ballafaqohen me sfidat të cilat do të paraqiten;
- Njerëz: njëra nga sfidat më të mëdha ka të bëjë me privatësinë, idenë për pronësi, modelet e konsumatorëve dhe si iu përkushtohemi resurseve që t’i zhvillojmë aftësitë ekzistuese dhe aftësitë e reja.

### **Diagrami 2. Katër Revolucione industriale dhe industria**





**FROM INDUSTRY 4.0 TO FOURTH INDUSTRIAL REVOLUTION**



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

BE e njih rëndësinë e Industrisë 4.0 dhe mbështet platforma digjitale industriale për integrimin e teknologjive të ndryshme kryesore digjitale në aplikime, procese, prodhime dhe shërbime reale. Për shembull, Iniciativa për digjitalizimin e industrisë evropiane mbështet partneritete publike-private (PPP) të cilat i zhvillojnë blloqet e ardhshëm të teknologjisë digjitale siç është robotika, sensorët e zgjuar, të dhënat e mëdha dhe komunikimi mobil.

Gjatë viteve 2018-2020, do të ketë investime në vlerë prej 300 milionë euro për mbështetjen e ndërtimit të Platformës strategjike të gjeneratës së ardhshme, si dhe pilot projekte të mëdha të fokusuara në fushat si vijon:

- Platforma digjitale për prodhimin për fabrika të zgjuara të ndërlidhura;
- Platforma digjitale bujqësore të integruara/shërbyese për ekonomitë rurale;
- Spital i zgjuar dhe jetë e mençur/e shëndetshme në shtëpi;
- Shtëpi të zgjuara interoperabile dhe zgjidhje të mëdha për energji;
- Ndërtimi i zgjuar.

### *Ekonomia cirkulare, Industria e gjelbër/prodhimi i gjelbër dhe Prokurime të gjelbra publike*

BE theksin e vuri mbi zhvillimin e “Ekonomisë cirkulare”, pikërisht mbi atë e cila e balancon zhvillimin ekonomik me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe resurseve. Theksi vihet mbi përdorimin më efikas dhe riciklimin e resurseve të saj dhe mbi mbrojtjen e mjedisit jetësor. Ekonomia cirkulare karakterizohet me konsum të ulët të energjisë, me emetimin e ulët të materieve ndotëse dhe me efikasitet të lartë gjatë përdorimit të resurseve gjatë aktivitetit ekonomik. Ajo e përfshin aplikimin e prodhimit më të pastër në kompanitë, zhvillimin e parkut eko-industrial dhe strukturë të integruar për planifikim të bazuar mbi resurset për zhvillimin e industrisë, bujqësisë dhe fushave urbane.

“Industria e gjelbër” është prodhimi dhe zhvillimi industrial që nuk bie në kurriz të shëndetit të sistemeve natyrore, madje nuk ka as pasoja negative mbi shëndetin e njeriut. Industria e gjelbër është fokusuar drejt integritet të aspekteve ekologjike, klimatike dhe sociale në punën e ndërmarrjeve. Ajo siguron platformë për zgjidhjen e sfidave globale të ndërlidhura midis tyre, përmes një spektri të qasjeve dhe strategjive praktike të cilat i shfrytëzojnë fuqitë e reja industriale dhe të tregut. Marrë në përgjithësi, “Prodhimi i gjelbër” nënkupton ridizajnim të produkteve, sistemeve prodhuese dhe modeleve të biznesit, si dhe përgjegjësi të zgjeruar prodhuese në formë të prokurimeve kthyesë ose të kundërta, shfrytëzimit efikas të resurseve dhe prodhimit të pastër, përpunim dhe riciklim në nivel shumë më të rëndësishëm nga niveli i deritanishëm.

Ekzistojnë përfitime të shëndetshme për ndërmarrjet që të përfshihen në Industrinë e gjelbër / prodhimin e gjelbër. Një numër i madh i industrive, rritjen e efikasitetit të resurseve në procesin e prodhimit nuk e bëjnë për shkak të problemeve ekologjike ose të qëndrueshme si të këtyra, por kjo u bë faktori kyç që e determinon konkurrencën ekonomike, rritjen dhe profitabilitetin. Meqë inputi i resurseve është shpenzim i rëndësishëm i prodhimit industrial, përmirësimi sa i përket efikasitetit mund të jetë i rëndësishëm në fitimin e përparësisë së konkurrencës. Reduktimi i shpenzimeve në procesin e prodhimit, gjithashtu mund të rezultojë me çmime më të ulëta për konsumatorët, njëkohësisht duke e stimuluar lojalitetin e blerësve (shih, gjithashtu, Pjesa 3.2 në vijim).

Prodhimi i gjelbër, në këtë mënyrë, është komponentë jashtëzakonisht e rëndësishme për Ekonomisë cirkulare (përkatesisht, menaxhimi me ciklin jetësor të resurseve natyrore, nga ekstraktimi përmes dizajnit dhe prodhimit të produkteve, deri në atë që konsiderohet si mbetje, ka rëndësi esenciale për rritjen e gjelbër dhe është pjesë e zhvillimit të ekonomisë efikase cirkulare të resurseve, me ç’rast asgjë nuk hidhet) dhe mund të rezultojë me reduktimin e shpenzimeve për lëndët e para, me rritjen e produktivitetit, reduktimin e shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe krahut të punës, me fare pak apo aspak

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

mbetje ose ndotje, si dhe me imazh më të fuqishëm korporativ. Një instrument i ndërlidhur për tranzicion drejt Industrisë së gjelbër në industrinë përpunuese janë prokurimet e gjelbra publike, që gjithashtu promovohet nga BE.

### 2.1.2 Rëndësia e prodhimit

Një fakt tjetër i rëndësishëm, para se të diskutohet për kontekstin institucional në Republikën e Maqedonisë, është të vërehet se ekziston njohje gjithnjë e më e madhe, pjesërisht e lidhur me çështjen e specializimit të zgjuar, sa i përket rëndësisë së theksuar të industrisë përpunuese në përgjithësi edhe në vendet e CEFTA (*Hunya, 2017, CEFTA Investment Report, pp.61-63*), siç është Republika e Maqedonisë.

Rëndësia e industrisë përpunuese për zhvillimin ekonomik është botërisht e pranuar. Konsiderohet se ajo ka rëndësi thelbësore: i rrit nivelet e konkurrencës, e rrit produktivitetin në krahasim me sektorët e tjerë, kontribuon në drejtim të mallrave me të cilët mund të tregtohet, siguron punësim cilësor mirë të paguar dhe siguron lidhje të ngushta me segmentet e tjerë të ekonomisë (*Stöllinger, et al. 2013*). Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e sektorit konsiston me atë që proceset e përpunimit shpeshherë mbështeten mbi inputet e sektorit shërbyes që nënkupton se i ndihmon sektorit të dytë që të përparoj, njëkohësisht duke e pasur edhe funksionin e bartësit të shërbimeve të cilat nuk mund të shiten ose të eksportohen pa u inkuorporuar në vet produktet. Raporti i fundit për investimet i CEFTA (2017) për Evropën Juglindore (EJL) ofron argument bindës: *“Industria përpunuese në rritje në ekonomitë e CEFTA do ta rris produktivitetin, do ta rris madhësinë e sektorit i cili mund të tregtoj, do të krijoj më shumë vende pune dhe më mirë të paguara dhe do të ketë efekte pozitive të rrjedhjes tek sektorët e tjerë të ekonomisë.”* (faqe.61)

Justifikimi për financimin e industrisë përpunuese është jashtëzakonisht i rëndësishëm në rajonin e CEFTA:

- Industria përpunuese është zhvilluar në nivel të pamjaftueshëm, e që mund të shihet sipas prodhimit të ulët dhe eksportit;
- Industri e dobët përpunuese nënkupton deficite të larta tregtare, rrjedha tregtare modeste në CEFTA dhe kërkesë e kufizuar të shërbimeve dhe H&ZH;
- Procesi i deindustrializimit vazhdon, edhe pse tendencat e fundit janë pozitive;
- Industria përpunuese është burimi kryesor i progresit teknologjik, meqë probabiliteti është më i madh që firmat të investojnë në H&ZH;
- Industria përpunuese është burimi kryesor i inovacioneve dhe progresit teknologjik;
- Në lidhje me çështjen e inovacionit, niveli i rritjes së produktivitetit (për shembull, produktiviteti i përgjithshëm i faktorëve) në industrinë përpunuese është më i lartë në krahasim me ekonomitë e tjera;
- Industritë përpunuese prodhojnë produkte të cilat shiten në masë të madhe, e që në kombinim me intensitetin e rritur të shërbimeve të prodhuesve nënkupton se sektori merr një funksion të rëndësishëm të “bartësit” të shërbimeve, ndërkaq si rezultat i kësaj ekonomia ka përfitime.

Hulumtimet fuqishëm sugjerojnë se industria përpunuese mbetet promotori kryesor i rritjes së vendeve në zhvillim, veçanërisht për vendet me nivel më të lartë të kapitalit njerëzorë. Nga ana tjetër, BE thekson se industria përpunuese: *“... ka efekt të fuqishëm të rrjedhjes në sektorët e tjerë – kërkesa shtesë përfundimtare në procesin e prodhimit krijon rreth gjysmën e kërkesës shtesë përfundimtare në një vend tjetër të ekonomisë.”*(Raporti evropian i konkurrencës 2013).

### 2.2 Politika industriale në Republikën e Maqedonisë

Politika industriale e Republikës së Maqedonisë 2009-2020, e hartuar nga Ministria e Ekonomisë (ME) dhe e miratuar nga Qeveria në korrik të vitit 2009 ishte dokument strategjik nacional për rritjen e konkurrueshmërisë të industrisë dhe ekonomisë në përgjithësi. Politika u fokusua në pesë fusha të veprimit, si shtylla kryesore për rritjen e konkurrencës të industrisë endogjene, si vijon:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe stimulimi i Investimeve të huaja direkte (IHD): masat kryesore e përfshijnë stimulimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të pjesëmarrësve kryesorë në zhvillimin ekonomik, përforcimin e rrjetit profesional për bashkëpunim midis partnerëve afaristë, shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, mësimin dhe zhvillimin e menaxhmentit, marketingun dhe aftësi të tjera afariste midis ndërmarrjeve, tërheqjen e kuadrove të kualifikuara për krijimin dhe promovimin e bizneseve inovative dhe tërheqjen e investimeve të huaja.
- Hulumtime të aplikuara, zhvillimi dhe inovacionet (H&ZH): masat kryesore përfshijnë investime më të mëdha gjatë hulumtimeve dhe zhvillim nga ana e sektorit publik dhe privat, stimulim dhe bashkëpunim midis industrisë, institucioneve shkencore hulumtuese dhe qeveritare, zhvillim të infrastrukturës teknologjike dhe të zonave zhvillimore teknologjike-industriale, krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, rritjen e zbatimit të teknologjive të reja, punësimin e hulumtuesve me arsim të lartë dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale.
- Zhvillimi i prodhimeve dhe shërbimeve ekologjike për zhvillim të qëndrueshëm: masat kryesore përfshijnë aktivitete për vetëdijen publike, "prokurimin e gjelbër publik", trajnime, hulumtim dhe zhvillim i përbashkët i produkteve dhe shërbimeve të reja ekologjike, infrastrukturë e qëndrueshme e resurseve industriale dhe mbështetje për eko-certifikim.
- Zhvillimi i NVM dhe sipërmarrësisë: masat kryesore përfshijnë mbështetje për hapjen e bizneseve të reja përmes krijimit të biznes klimës së përshtatshme, stimulim të programeve për mësim gjatë gjithë jetës për sipërmarrësi, inkorporim të instrumenteve të reja financiare për NVM inovative me rritje të shpejtë, të cilat i respektojnë rregullat e ndihmës shtetërore.
- Bashkëpunimi në klasterë dhe rrjete: masat kryesore përfshijnë rritje të vetëdijes dhe trajnim, analiza për mbështetje të klasterëve/rrjetëzimit dhe aktivitete për zhvillimin e strategjive për stimulimin e partneriteteve në zinxhirët e prokurimeve dhe inicim të rrjetëzimit me institucionet për hulumtim dhe zhvillim, qendrat teknologjike dhe industrinë.

Krahas Politikës industriale 2009-2020, të cilën e zëvendëson ky dokument, ekzistojnë politika të ndryshme, strategji dhe plan veprime që janë aktive në Republikën e Maqedonisë, duke i përfshirë edhe:

- Strategjinë e konkurrencës
- Strategjinë e inovacionit
- Strategjinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Strategjinë e mësimin të sipërmarrësisë
- Strategjinë e sipërmarrësisë së grave
- Strategjinë e arsimit
- Strategjinë e efikasitetit energjetik
- Programin nacional për reforma ekonomike.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Në vijim janë pasqyruar strategjitë dhe planet kryesore. Për industrinë strategjike është me rëndësi ti detektoj politikat aktuale dhe ta evitoj mbivendosjen e aktiviteteve të cilat tanimë implementohen ose planifikohen në dokumente të tjera strategjike. Përveç kësaj, është me rëndësi që kjo strategji ta identifikoj pozitën e saj specifike në politikë, e cila duhet t'i zgjidh nevojat prioritare të industrisë përpunuese në kontekst të Planit për rritje ekonomike, i cili është një kornizë e re e përgjithshme për Politikën industriale dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt mbi këtë Strategji. Së këtejmi, në vijim është përpunuar në detaj sipas prezantimit të iniciativave kryesore të politikave.

### 2.2.1 Strategjia e konkurrencës

Qëllimi i Strategjisë së konkurrencës 2016-2020 konsiston me atëqë të krijoj kornizë për shfrytëzimin efektiv të mjeteve të BE nga instrumenti për ndihmë para-aderuese (IPA II). Kjo ishte një iniciativë të cilës i paraprinte Kabineti i Nënkryetarit të Qeverisë i ngarkuar për çështje ekonomike (KNQÇE) e cila i përfshiu të gjitha tematkyç që kanë të bëjnë me konkurrencën, duke përfshirë si vijon:

- Mjedis afarist më i thjeshtë dhe më i qëndrueshëm;
- Sektor më produktiv dhe më sipërmarrës të NVM;
- Sektor më dinamik për eksport;
- Mjedis më atraktiv për investitorët e huaj;
- Fuqi pune më e shkathët dhe më sipërmarrëse;
- Politikë industriale e rilindur;
- Më shumë financa për sektorin e sipërmarrësisë.

Strategjia e konkurrencës 2016-20 u dizajnuar si "strategji ombrellë" dhe pritshmëritë ishin që të fitoj mjete të konsiderueshme. Megjithatë, në implementimin e saj ndikoi fakti se vetëm një pjesë e vogël e mjeteve të pritshme janë të aksesshme. Për këtë arsye, dhe meqë vetëm disa nga masat e saj u implementuan, disa masa me theks mbi prodhimtarinë, për shembull, lidhur me internacionalizimin/eksportin dhe politikën industriale, janë përfshirë në këtë Strategji.

### 2.2.2 Strategjia e inovacioneve

Inovacionet janë promotori kryesor i rritjes së ekonomisë, ndërsa zhvillimi i politikës së inovacioneve konsiderohet si njëri nga gurët themeltar të zhvillimit të ekonomisë. Dokumenti, në mënyrë të qartë, e shpreh vizionin se Strategjia do ta vë në lëvizje konkurrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik, të mbështetura mbi njohuri dhe inovacione, duke krijuar vende pune me vlerë të lartë dhe prosperitet për qytetarët përmes katër qëllimeve strategjike:

- Rritja e prirjes së sektorit të biznesit për përfshirjen e inovacioneve;
- Fuqizimi i resurseve njerëzore për inovacione;
- Krijimi i mjedisit rregullator i cili do t'i mbështes inovacionet;
- Rritja e rrjedhave të njohurive midis protagonistëve të inovacioneve.

Me huan nga Baka Botërore u ndërmorën hapa për ofrimin e ndihmës gjatë implementimit të kësaj Strategjie, duke e përfshirë edhe financimin dhe mbështetjen e implementimit të Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, si dhe të Zyrës së (re) Nacionale për Transferimin e Teknologjive (shih: Institucionet në vijim). Një zhvillim tjetër i rëndësishëm institucional është Parku Shkencor-teknologjik, park ky i cili është parashikuar në kuadër të shtyllës së tretë të PRRE. Plani i veprimtimit që ka të bëjë me Strategjinë është në proces rishikimi.



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

### 2.2.3 Strategjia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)

Strategjia Nacionale e NVM (2018-2022) është në procedurë miratimi nga Qeveria. Vizioni i saj është se “NVM janë promotorët e rritjes ekonomike inkluzive në Maqedoni dhe të krijimit të vendeve të punës produktive dhe të qëndrueshme” ndërkaq i përmban qëllimet strategjike si vijon:

- Mjedisi i përshtatshëm afarist: Të krijohet një mjedis i përshtatshëm afarist në të cilin stimulohet sipërmarrësia dhe inovacionet.
- Rritja dhe përmirësimi i mundësisë për zhvillimin e NVM: Të ndihmohen NVM të kenë produktivitet të lartë dhe të bëhen pjesëmarrës konkurrentë në tregun evropian dhe në tregjet e tjerë ndërkombëtarë.
- Ekosistemi dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacioneve: Të stimulohet konkurrueshmëria ekonomike e Maqedonisë, përmes rritjes së kapaciteteve të sipërmarrësisë dhe inovacionit të NVM.

Strategjia e NVM është hartuar në përputhje me aktin për ndërmarrje të vogla (ANV) të Bashkimit Evropian dhe në çdo qëllim strategjik janë identifikuar 12 programe për mbështetje.

### 2.2.4 Strategjia e zhvillimit të sipërmarrësisë së grave

Strategjia e zhvillimit të sipërmarrësisë së grave është në proces miratimi. Vizioni afatgjatë i Strategjisë është: “Realizimi i qëllimit të përfshirjes së grave në aktivitetin e sipërmarrësisë në varësi nga faktorët e ndryshëm, në mënyrë që të bëhen fuqi e cila kontribuon në zhvillimin e mjedisit sipërmarrës dhe zhvillimin e ekonomisë.” Strategjia e zhvillimit të sipërmarrësisë së grave në R. e Maqedonisë ka për qëllim fuqizimin ekonomik të grave, përmes krijimit të biznes-klimës së përshtatshme dhe përmes sigurimit të mbështetjes për zhvillimin e potencialit të tyre sipërmarrës, me çka do të kontribuohet në drejtim të zhvillimit të ndërmarrjeve ekzistuese dhe hapjes së ndërmarrjeve të reja, krijimit të vendeve të reja të punës dhe me këtë edhe në drejtim të fuqizimit të ekonomisë së përgjithshme. Prioritete strategjike janë:

- Krijimi i ambientit të përshtatshëm afarist (biznes-klimë) për zhvillimin e sipërmarrësisë së grave.
- Sigurimi i mbështetjes sistematike për zhvillimin e sipërmarrësisë së grave.
- Krijimi i infrastrukturës për mbështetje dhe zhvillim të sipërmarrësisë së grave.
- Promovimi, rrjetëzimi dhe përfaqësimi.

### 2.2.5 Strategjia e mësimin të sipërmarrësisë

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) e hartoi Strategjinë e parë për mësimin e sipërmarrësisë me ndihmën e Fondacionit Evropian të Trajnimeve. Strategjia synon:

- T'i përmirësoj aftësitë për punësimin e të rinjve në vend, e që do të rezultojë me mundësi të rritura për punësimin e të rinjve;
- Të krijoj mundësi për të gjithë qytetarët e vendit të aftësohen me kompetencat e nevojshme të sipërmarrësisë;
- Të krijoj sistem për mësim gjatë gjithë jetës të sipërmarrësisë;
- Ta përforcoj frymën sipërmarrëse përmes parimeve të mësimin gjatë gjithë jetës që zbatohen në të gjitha segmentet e sistemit arsimor.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Qëllimi i Strategjisë është të kontribuoj në drejtim të zmadhimit të numrit të NVM (duke i përfshirë sipërmarrësit e rinj dhe gratë sipërmarrëse) me arsim të lartë për të konkurruar në tregun më të gjerë në BE; rritja e numrit të kompanive të reja novatore; dhe rrjedhimisht reduktimi i shkallës së papunësisë në më pak se 25%.Përgjegjësinë për Strategjinë dhe Planin e veprimit e ka Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndërkaq e udhëheq grupi Ndër-sektorial për mësimin e sipërmarrësisë, i përbërë nga përfaqësuesit e ministrive relevante dhe nga përfaqësuesit e palëve të tjera të interesuara.

### 2.2.6 Strategjia e avancimit të efikasitetit energjetik

Ministria e Ekonomisëmes tjerash e hartoi Strategjinë për avancimin e efikasitetit energjetik 2010-2020, qëllimet strategjike të së cilës janë:

- Furnizimi i sigurt me energji;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- Konkurrueshmëria e ekonomisë.

Fokusi kryesor i Strategjisë, që ka të bëjë me industrinë përpunuese, është modernizimi i infrastrukturës energjetike dhe ndërtimi i rrejtës të gazit natyror; përmirësimi i shfrytëzimit të energjisë nga burimet e rinovueshme; investimi nëH&ZH dhe promovimi i teknologjive për efikasitet energjetik.

Krahas Strategjisë dhe konform Marrëveshjes për themelimin e komunitetit energjetik, shteti ka obligim të përpiloj Plan veprim nacional për efikasitet energjetik (PVNEE),ndërsa i fundit vlen deri në vitin 2018. PVNEE i vendos objektivat indikative nacionale për kursimin e energjisë finale në vend, ndërsa një pjesë e kësaj është edhe industria përpunuese.

### 2.2.7 Strategjia gjithëpërfshirëse e arsimit 2018-2020

Strategjia e arsimit e MASH u miratua në janar të vitit 2018. Ajo e përfshin: arsimin parashkollor, fillor, të mesëm, profesional dhe të lartë, hulumtimin dhe zhvillimin, arsimin e të rriturve, mësimin gjatë gjithë jetës dhe arsimin joformal. Çdo kapitull trajton tema, siç janë: arritjet, dobësitë, prioritetet dhe rezultatet e pritshme nga implementimi. Masat prioritare janë përfshirë në Plan veprimin përkatës, ndërsa në të gjithë kapitujt është inkorporuar bashkëpunimi me sektorin privat, në mënyrë që të sigurohet lidhje më efikase midis sistemit arsimor dhe tregut të punës. Dy tema janë veçanërisht të rëndësishme:

- Arsimi i të rriturve dhe mësimi gjatë gjithë jetës: Strategjia e detekton mangësinë e lidhjes midis ofruesve të arsimit për të rritur dhe nevojave reale të tregut të punës, si dhe nevojave për më shumë informacione dhe analiza, prej të cilave mund të përfitojnë të gjithë sektorët, duke e përfshirë edhe industrinë përpunuese;
- Arsimi profesional: zhvillimi i qasjes modulare në programet mësimore për arsimin profesional do të mundësojë fleksibilitet dhe përshtatje më të mirë ndaj pritshmërive të nxënësve / të rriturve dhe lidhje me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, parashikohet të krijohet një sistem më efikas dhe më efektiv për arsimin profesional në 98 shkolla. Qendrat rajonale për arsim profesional dhe trajnim do të krijohen dhe pajisen me teknologji/pajisje të re dhe do të hapen për nxënësit e shkollave profesionale / studentët e universiteteve, për personat e papunësuar dhe për komunitetin e biznesit, në mënyrë që të investojnë për të punësuarit e tyre.

Pritet që Strategjia e arsimit të ndikoj në mënyrë pozitive mbi të gjithë sektorët, duke e përfshirë edhe industrinë / industrinë përpunuese.

### 2.2.8Programi për reforma ekonomike

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Programi për reforma ekonomike e mbulon periudhën kohore 2018-2020 dhe azhurnohet çdo tre vjet. Programi e pasqyron kornizën afatmesme makroekonomike dhe fiskale, si dhe reformat strukturore sektoriale për promovimin e konkurrencës dhe rritjen. Në këtë program i është përkushtuar vëmendje politikës industriale dhe bëhet vlerësimi i ndikimit të praktikave paraprake të fokusuara në tërheqjen e IHD, krijimin e konkurrencës dhe ofrimin e mbështetjes për degë të caktuara të industrisë, ndërkaq mes tjerash nënvizon se PI është në proces revizioni. Programi për reforma ekonomike fokusohet mbi masat prioritare në vijim deri në vitin 2020, si pjesë të Planit për rritje ekonomike:

- Masa 9: Aktivitete për mbështetjen e tërheqjes së IHD dhe investimeve të kompanive vendore
- Masa 10: Mbështetja e investimeve
- Masa 11: Përmirësimi i konkurrencës së kompanive për tregje të reja

Sipas Aneksit të Programit (Tabela 10. Matrica e mjeteve të nevojshme) priten investime në masat e lartpërmendura në lartësi prej rreth 150 milionë euro deri në vitin 2022.

Një iniciativë tjetër që mund të shtohet është Plani për rritje ekonomike (PRRE), megjithatë, bëhet fjalë për një iniciativë mjaft të rëndësishme, të cilën në mënyrë të veçantë do ta arsyetojmë në vijim.

Të konkludojmë, analiza në pjesën paraprake e përforcon perceptimin se politika industriale është shumë e gjerë dhe përfshinë shumë tema dhe çështje. Fakti që një spektër i politikave, strategjive, udhëzimeve, programeve dhe ngjashëm, ekzistojnë në fushën e përgjithshme të politikës industriale, e përforcon nevojën që kjo strategji të ketë një vëmendje të veçantë (përkatesisht industria përpunuese), në mënyrë që të evitohen mbivendosjet e mundshme potenciale të politikave dhe konflikteve institucionale.

### 2.3 Plani për rritje ekonomike (PRRE)

Plani për rritje ekonomike (PRRE) është një dokument i cili ofron stimulime të reja për rritjen e sektorit industrial, duke u fokusuar në mbështetjen e investimeve nga ana e kompanive. Parimet, përjashtimet dhe shtyllat kryesore të PRRE janë prezantuar në Kornizën në vijim.

#### Korniza 5: Plani për rritje ekonomike: korniza e re për mbështetjen e politikës industriale

Parimet kryesore të PRRE janë:

- Ndërmarrjet që do të aplikojnë për masat e politikës industriale për stimulimin e investimeve dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë maqedonase duhet doemos t'i plotësojnë **kriteret** themelore si vijon:
  - Ndërmarrja të shënoj rritje të të ardhurave në vitin e fundit sa i përket mesatares së tre viteve të fundit;
  - Ndërmarrja ta ruaj ose ta rris numrin e të punësuarve në vitin e fundit sa i përket mesatares së tre viteve të fundit.
- Për masat e theksuara mund të konkurrojnë të gjitha ndërmarrjet e Republikës së Maqedonisë, **përveç** ndërmarrjeve të cilat punojnë si:
  - Ndërmarrje publike
  - Ndërmarrje me veprimtari të licencuar
  - Shtëpi të avokatëve, shtëpi të revizorëve, byro kontabiliteti
  - Ndërmarrje-shfrytëzues të subvencioneve bujqësore
  - Ndërmarrje-shfrytëzues të koncesioneve
  - Banka, kompani sigurimesh, fonde

Aktivitetet e PRRE sigurojnë mbështetje sipas tri shtyllave:

#### Shtylla 1: Të gjitha ndërmarrjet: investime

- Krijimi i vendeve të reja të punës;
- Vendosja dhe avancimi i bashkëpunimit me furnizues nga R. e Maqedonisë;



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

- Themelimi i seksioneve për zhvillim dhe hulumtim teknologjik;
- Mbështetja e projekteve investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë;
- Rritja e investimeve kapitale dhe të ardhurave;
- Blerja e aseteve nga ndërmarrjet në vështirësi.

### Shtylla 2: Të gjitha ndërmarrjet: internacionalizimi

- Kompani të cilat e kanë rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregje të reja;
- Përvetësimi i tregjeve të reja dhe rritja e shitjes.

### Shtylla 3: NVM

- NVM me tendencë për rritje të shpejtë ("gazela");
- Mbështetje financiare shtesë për mikro ndërmarrje;
- Përmirësimi i inovacionit të NVM;
- Përsosje profesionale dhe praktikë për personat e rinj të sapo punësuar;
- Krijimi i ambientit dhe hartimi i bazës ligjore për zhvillimin e kapitalit të rrezikshëm.

Plani për rritje ekonomike mbështetet me **Ligjin për mbështetje financiare të investimeve**(2018) për dy shtyllat e para, si dhe Programi i punës i FIZHT për Shtyllën e tretë.

PRRE është zhvillim kryesor i ri i politikave me fokus mbi prodhimtarinë. Ai është:

- Gjithëpërfshirës: mbështet investime, punësime, internacionalizimin dhe inovacionet;
- Mbështetet në trajtimin nacional: nuk bën dallim midis ndërmarrjeve të huaja dhe vendase;
- Me orientim drejt suksesit: objektiv janë ndërmarrjet të cilat kanë pasur sukses në punën e tyre të fundit;
- Nuk është orientuar drejt NVM: shumica e masave nuk varen nga madhësia e ndërmarrjes, edhe pse ekzistojnë masa konkrete për NVM dhe mikro (Shtylla 3);
- Nuk varet nga mbështetja e huaj: përmes tij akordohen mjete të konsiderueshme shtetërore për arritjen e objektivave të reja të politikës.

Ligji për mbështetje financiare të investimeve (2018) i rregullon llojet e mbështetjes financiare të investimeve, lartësinë e mbështetjes financiare, kushtet, mënyrën dhe procedurën e akordimit të mbështetjes financiare të subjekteve afariste të cilët do të investojnë në Republikën e Maqedonisë. Ai i përkufizon llojet e mbështetjes financiare të cilat subjektet afariste mund t'i pranojnë, si dhe lartësinë e mjeteve. Procedura për fitimin e mbështetjes financiare është bërë në atë mënyrë që të jetë transparente, e thjeshtë dhe e aksesshme për të gjitha subjektet afariste në Republikën e Maqedonisë. Nga ana tjetër, me Ligj përcaktohen organet kompetente, si dhe forma institucionale (përkatësisht Komisioni ndërministror i cili do t'i verifikoj kushtet e fitimit të mbështetjes financiare). Me Ligjin është përfshirë Shtylla e parë dhe e dytë e PRRE, ndërsa Shtylla e tretë e PRRE është përfshirë me aktivitetet e Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik.

Pritet që PRRE të financoj 30 milionë euro në nivel vjetor në pesë vitet e ardhshëm (150 milionë euro). Kjo nënkupton kornizë të re të madhe për politikën industriale, me fokus mbi industrinë/prodhimtarinë. PRRE, si i këtillë, paraqet kornizë politike gjithëpërfshirëse për këtë Strategji, e cila e përqendron fokusin mbi industrinë përpunuese, kështu që shumica e masave të prezantuara në Qëllimet strategjike (shih: Kapitullin 4 në vijim) rezultojnë drejtpërdrejtë nga PRRE.

## 2.4 Institucionet kryesore relevante

Duke e pasur parasysh natyrën horizontale të saj, institucione të ndryshme janë ngarkuar për implementimin në përgjithësi të politikës industriale, së këtijmi edhe implementimin e kësaj Strategjie. Institucionet kryesore janë si vijon:

- Kabineti i Nënkrjetarit të Qeverisë i ngarkuar për çështje ekonomike (KZKQÇE): ka përgjegjësi të plotë për koordinimin e fushave të ndryshme të cilat bëjnë pjesë në çështjet ekonomike duke e përfshirë edhe planin për rritje ekonomike;

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

- Ministria e Ekonomisë (ME): ka përgjegjësi për politikat e fushave të ndryshme që janë me rëndësi të drejtpërdrejtë për Strategjinë, siç është politika industriale, investimet, NVM, eksporti, tregtia, energjia, etj;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës(MASH): ka përgjegjësi për politikat nga fusha të ndryshme relevante, duke i përfshirë: hulumtimin dhe zhvillimin (H&ZH), inovacionet, arsimin e lartë, specializimin e zgjuar etj.;
- Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH): ka përgjegjësi për aspekte të ndryshme të qëndrueshmërisë, ndryshimet klimatike, ekonominë cirkulare/të gjelbër;
- Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë (AMSRM): ka përgjegjësi për implementimin e zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë;
- Agjencia për Investime dhe Promovimin e Eksportit (InvestMaqedonia): ka përgjegjësi për implementimin sa i përket investimeve të huaja direkte (përveç pjesëve që janë në përgjegjësi të Ministrave pa resor dhe Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale– shih në vijim) dhe promovim të eksportit. Ajo, po ashtu do të përfshihet në shtyllat 1 dhe 2 të PRRE;
- Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale (DZZHTI): është përgjegjëse për implementimin që ka të bëjë me ZZHTI, duke e përfshirë edhe ndihmën shtetërore dhe kujdesin. Aktualisht funksionojnë 8 ZZHTI ndërsa të tjerat janë në plan. Ajo, gjithashtu, do të përfshihet në shtyllat 1 dhe 2 të PRRE;
- Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit: është përgjegjëse për kreditimin e qëllimeve zhvillimore (për shembull, efikasiteti energjetik dhe burimet e rinovueshme të energjisë, NVM, etj.), sigurimin e kredive (për shembull, eksporti) dhe faktoring;
- Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT): është përgjegjës për financimin e inovacioneve, komercializimin e inovacioneve, transferimin e teknologjive, bizneset start-up, bizneset spin-of, biznes akceleratorët etj. Ai, përveç kësaj, është përgjegjës edhe për Shtyllën 3 të PRRE.

Së këtejmi, duhet të theksohen edhe institucione të tjera të cilat ndikojnë mbi politikën e përgjithshme industriale:

- Universitetet (shtetërore dhe private): ka 6 universitete shtetërore dhe 18 private;
- Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve (AMSHA): është institucion i theksuar akademik me programe aktive të ndryshme për hulumtim;
- Klasterë: rreth 30 (baza e të dhënave e ME), megjithatë shumica punojnë si shoqata afariste dhe punojnë me shkallë të ndryshme të efektivitetit (L. Vodeb, 2016, Raporti për evaluimin e klasterëve);
- Inkubatorë/akceleratorë: ekzistojnë biznes inkubatorë dhe akceleratorë nga sektori privat. Janë planifikuar edhe akceleratorë shtesë, siç është ai i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik.

Planifikohet të formohen disa institucione të reja, përfshirë këtu edhe:

- Zyra Nacionale për Transferimin e Teknologjive (ZNTT): pritet të bëhet partner kryesor për transferimin e teknologjive dhe përforcimin e potencialit teknologjik dhe inovator;
- Parku Shkencor-Teknologjik: formohet me fokus mbi transferimin e teknologjive;
- Zonat e Gjelbra Industriale (ZGJI): janë formuar tre zona industriale, ndërsa Zona e parë e gjelbër është në proces të formimit.

Me qëllim që të implementohet Strategjia dhe Plani i veprimit, institucionet kryesore në vijim do të kenë rol të rëndësishëm, në mënyrë që në detajet do të arsyetohet në Kapitullin 5: Implementimi dhe koordinimi:

- Sektori i industrisë pranë Ministrisë së Ekonomisë: koordinim i plotë (ndërministror, donatorë, faktorët), monitorimi, raportimi dhe evaluimi;
- Grupi sektorial i punës për konkurrencë dhe inovacione: koordinim ndërministror.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Përmbajtja e kësaj Strategjie dhe Plan veprimit të saj ishte temë diskutimi dhe u harmonizua me institucionet kryesore relevante të cilat u theksuan më lartë.

### 2.5 Fokusi mbi Strategjinë industriale

Politika industriale, marrë në përgjithësi, gjithnjë e më shpesh është në agjendën e BE-së, dhe veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Politika industriale ka tendencë të jetë gjithëpërfshirëse, megjithatë gjithnjë e më shumë njihet roli i rëndësishëm i industrisë përpunuese. Në Republikën e Maqedonisë çështjet kryesore janë evidente, që e përforcon nevojën që Strategjia industriale të fokusohet mbi industrinë përpunuese:

- Ekziston nevoja për rishikimin dhe azhurnimin e politikës/strategjisë paraprake industriale;
- Politika paraprake industriale ishte gjithëpërfshirëse dhe gjenerike. Vlerësimi i ndikimit të saj tregoi ndikim të pjesshëm, por edhe dobësi, siç është nevoja e lidhjes së saj me PRRE, të evitohen mbivendosjet, siguri të financimit konsiderueshëm të rritur nga ana e shtetit, të plotësohet financimi nga ana e shtetit me financa/INF nga donatorë, si dhe të sigurohet liderizëm efikas, koordinim, dialog publik privat, raportim, monitorim dhe evaluim të Strategjisë së re dhe Planit të veprimit;
- Ekzistojnë edhe strategji të tjera nacionale që kanë të bëjnë me konkurrencën, inovacionet dhe ngjashëm kështu që tanimë nuk ka vend për strategji tjetër horizontale;
- Ekzistojnë shumë institucione në fushën e konkurrencës, inovacioneve IHD, etj. dhe së këtejmi është me rëndësi që Strategjia e re të fokusohet mbi evitimin e mbivendosjeve, edhe pse disa janë të paevitueshme dhe mund ta shtojnë vlerën, nëse koordinohen në mënyrë efikase;
- Korniza e Planit të ri për rritje ekonomike PRRE, në mënyrë të veçantë e thekson prodhimtarinë.

Së këtejmi, ekziston bazë e fuqishme që kjo strategji të fokusohet mbi industrinë përpunuese, meqë kjo ka rëndësi thelbësore për rritjen, produktivitetin, vendet e punës me cilësi të lartë, inovacionet, eksportin, ekonominë cirkulare etj. Fokusi i këtyllë është në përputhje me angazhimet e mëdha të realizuara në dekadën e fundit për tërheqjen e suksesshme të investimeve të huaja direkte (IHD) në zonat teknologjike industriale (ZZHTI), dhe pati sukses ta rris profilin dhe imazhin e vendit, njëkohësisht duke iu kundërvënë tendencës së deindustrializimit evident në rajonin e Ballkani Perëndimor.

Kapitulli i radhës ka të bëjë me tendencat dhe problemet e industrisë përpunuese në nivel global, në BE, në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në Republikën e Maqedonisë, si masë shtesë për përcaktimin e përmbajtjes së Strategjisë së re dhe Planit të veprimit.

## 3. Industria përpunuese: tendencat dhe çështjet

Ky kapitull e analizon në detaje industrinë përpunuese, meqë ky është synimi i kësaj Strategjie. Në pjesën e parë janë prezantuar tendencat e përgjithshme të cilat ndikojnë mbi industrinë përpunuese në nivel global, përfshirë edhe ato në Evropë. Në pjesën e dytë bëhet fjalë për procesin e deinstitutionalizimit dhe për ndryshimet pozitive të kohë më parshme në prodhimtarinë e Ballkanit Perëndimor. Në pjesën e tretë analizohen të dhënat për industrinë përpunuese dhe nën-sektorët në Republikën e Maqedonisë dhe krahasohen me një sërë

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

konkurrentësh. Përmbajtjet dhe konkluzionet e këtij kapitulli, si dhe të kapitullit paraprak çojnë drejt pasqyrës së përparësive, mangësive, mundësive dhe kërcënimeve (Analiza SWOT), që e hap rrugën e strategjisë industriale me fokus mbi prodhimtarinë, prezantuar në Kapitullin në vijim.


### 3.1 Industria përpunuese është e rëndësishme

Është fakt se industria përpunuese është e rëndësishme edhe atë në mënyrë të cilën duhet ta pranojnë kreatorët e politikave, meqë drejtpërdrejt pasqyrohet mbi mundësitë aktuale dhe të ardhme ekonomike të vendit, së këtejmi rezulton arsyeja e fokusit mbi këtë strategji, e cila do të funksionoj në kombinim me iniciativa të tjera simotra strategjike të cilat tanimë janë në rrjedhë e sipër.

Distribuimi i produkteve që eksportohen nga vendet në zhvillim u ndryshua në masë të konsiderueshme gjatë 20 viteve të fundit. Nga njëra anë, në të kaluarën mallrat kryesorë merrnim pjesë me 75% të eksportit global, ndërkaq nga ana tjetër sot rreth 70% e eksportit të vendeve në zhvillim janë mallra të përpunuar. Elektronika, makinat, automobilat, kimikatet, rrobat, mobilitet, etj. e përbëjnë pjesën më të madhe të tregtisë botërore me mallra të përpunuar. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme të kësaj tregtie nuk e përfshin vet produktin përfundimtar, por pjesët e ndryshme përbërëse me të cilat tregtohet në zinxhirin e furnizimit të mallrave të prodhuar. Si e këtillë, kërkesa globale për mallra të përpunuar nuk e përfshinë vetëm kërkesën e produkteve finale, por edhe kërkesën e pjesëve përbërëse, prezantuar nga ana e industrive tjera, duke formuar zinxhirë global të furnizimit.

Prodhimtaria tradicionalisht konsiderohet si proces prodhues, me ç'rast lëndët e para transformohen në produkte fizike përmes inputeve, siç janë njerëzit dhe resurset e tjera. Megjithatë, provat dëshmojnë se prodhimi fizik është vetëm në fokusin e zinxhirit prodhues shumë më të gjerë të vlerave (Marsh, 2012, *The New Industrial Revolution: Consumers, Globalisation and the End of Mass Production*), siç është prezantuar në Diagramin në vijim.

#### Diagrami 3: Model më i thjeshtë i zinxhirit prodhues të vlerave



Prodhuesit, gjithnjë e më shumë, i përdorin zinxhirët global, rajonal dhe nacional të vlerave që të mos gjenerojnë të ardhura të reja dhe plotësuese, me ç'rast prodhimtaria e ka rolin qendror gjatë mundësimit të aktiviteteve tjera të cilat krijojnë vlera. Perceptimi i industrisë përpunuese nga ky këndvështrim nxiti interesim të përsëritur për potencialin e prodhimtarisë gjatë zgjidhjes së sfidave ekonomike, strategjike dhe shoqërore. Studimet e vënë në dukje rëndësinë qendrore të industrisë përpunuese për saldon tregtare, produktivitetin e përmirësuar, qëndrueshmërinë ekonomike, ekologjike dhe sociale dhe zhvillimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me prodhimtarinë. Roli i prodhimtarisë dhe teknologjive të reja në ballafaqimin me disa nga sfidat kryesore sot, siç janë ndryshimet klimatike, është botërisht i njohur, edhe pse ekzistojnë dallime në prezantimin e saj në vende dhe rajone të ndryshme, si pasqyrë e fuqive dhe interesave nacional të industrive dominuese brenda vet

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

ekonomisë. Në SHBA, theksi është vendosur mbi rolin e ardhshëm të zhvillimit të prodhimit teknologjik, mbi krijimin e industrive të reja dhe sigurinë nacionale, ndërsa nga ana tjetër në BE vëmendja kryesisht i përkushtohet rolit të industrisë përpunuese si promotor për rimëkëmbjen ekonomike dhe përballjen me vlerën ekonomike në formë të vendeve të punës që ndërlidhen me prodhimtarinë.

Edhe pse rëndësia e industrisë përpunuese është reduktuar në shumicën e vendeve të BE-së, megjithatë, njihen përfitimet të cilat i ofron një industri përpunuese stabile ose në rritje:

- Industria përpunuese është promotori kryesor i produktivitetit;
- Industria përpunuese është burimi kryesor i aktiviteteve të hulumtimit, zhvillimit dhe inovacioneve;
- Industria përpunuese është promotori kryesor i rritjes së përgjithshme ekonomike;
- Pa një industri të shëndetshme përpunuese, është vështirë të balancohet fatura tregtare;
- Industria përpunuese është promotori kryesor i rritjes së punësimit;
- Industria përpunuese është burimi kryesor i vendeve të punës me pagesë të lartë për nivele të ndryshme të aftësive;
- Industria përpunuese dhe shërbimet gjithnjë e më shumë bëhen të pandashme dhe komplementare.

Këto përfitime të rëndësishme potenciale në të ardhmen kërkojnë qasje sistematike për mbështetje të industrisë përpunuese.

### 3.2 Çështje globale të cilat ndikojnë mbi industrinë përpunuese

Në analizën paraprake u theksuan katër çështje. Së pari, se industria paraprake politike ishte tejte e gjerë dhe pa mjete të qëndrueshme politike dhe financiare për zbatimin e saj efektiv. Së dyti, edhe mjedisi politik edhe ai institucional, në masë të madhe, kanë pësuar ndryshime, kështu që është me rëndësi të jashtëzakonshme që strategjia industriale të fokusohet (për dallim nga strategjia e gjerë industriale), në mënyrë që të sigurohet zbatim efektiv dhe shfrytëzim të mjeteve të kufizuara. Së treti, se Qeveria e re e zgjedhur, kah mesi i vitit 2017, theks shumë më të madh vuri mbi industrinë përpunuese sesa Qeveria paraprake, e që mund të shihet sipas Planit të miratuar për rritje ekonomike dhe ligjit. Së katërti, sa i përket zhvillimit ekonomik, industria përpunuese gjithnjë e më shumë perceptohet si njëri nga sektorët më të rëndësishëm mbi të cilët duhet të fokusohemi.

Industria përpunuese është në gjendje të ndryshimit permanent. Para se të shqyrtohet situata në vend, është me rëndësi që shkurtimisht të përcaktohen tendencat dhe çështjet kryesore të cilat ndikojnë mbi industrinë përpunuese në nivel global, meqë të gjitha vendet, përfshirë këtu edhe Maqedoninë, nuk mund e të mos goditen prej tyre. Në Kornizën në vijim janë prezantuar të dhënat nga UNIDO (*Emerging trends in global manufacturing industries*) të cilat paraqesin pasqyrën e tendencave të larta dhe josektoriale dhe promotorë të cilët ndikojnë mbi sistemet globale industriale, efektet e të cilave paraqiten dhe të njëjtët do të rezultojnë me ndryshime të mëtutjeshme në aktivitetin e prodhimtarisë globale në vitet në vijim.

#### Korniza 6. Platforma zhvillimore ose Teknologji kryesore (KET)

##### Tendencat:

##### Globalizimi:

-Ofshoring (bartja e prodhimtarisë jashtë vendit) dhe outsourcing (angazhimi i burimeve të jashtme ose furnizuesve në punë).

-Rajonet në zhvillim, siç është Kina, India e Brazili, Turqia, Indonezia, Rusia etj.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

### *Qëndrueshmëria:*

- Mjedisi jetësor/ndotja.
- Presione shoqërore (p.sh. inteligjenca artificiale, robotika etj.).
- Presione ekonomike (konsumi i resurseve të kufizuara, për shembull, energjia dhe uji).

### *Demografia:*

- Popullatë e cila plakët.
- Ndryshimet e modeleve të kërkesës ndërkombëtare (për shembull, dukuria e klasës së mesme dhe të lartë në vendet në zhvillim).

### *Urbanizimi:*

- Dyndja e njerëzve nga mjediset rurale dhe nga qytetet më të vegjël në qytetet më të mëdhenj.
- Ngadalësimi i rritjes së popullsisë rurale.

### *Kërcënime ndaj stabilitetit global:*

- Reduktimi i rrezikut dhe rezistenca e rritur e rritjes.

### *Përsheptim i ciklit jetësor të produkteve:*

- Përsheptimi i shkallës dhe prezencës gjithnjë e më të lartë të inovacioneve teknologjike.
- Arritje të reja shkencore dhe teknike (për shembull, Teknologjitë kryesore).

### *Ndryshimi i shprehive të konsumatorëve:*

- Rritja e prosperitetit do të rezultojë me konsumin e produkteve për konsum të gjerë / produkte të individualizuara dhe shërbime.

### *Tendenca të jashtme të politikës industriale:*

- Investime afatgjata shtetërore për mbështetjen e prodhimit (për shembull, H&ZH, KET, etj.).

### **Mundësitë e konkurrencës në prodhimtari:**

#### *Prodhimtaria distributive:*

- Bashkëpunim dinamik në zinxhirët kompleks të furnizimit.
- Zinxhirë agjil të furnizimit.
- Sigurimi transparent i informacioneve për produkte dhe procese.

#### *Prodhimtaria e cila përgjigjet në mënyrë të shpejtë:*

- Prodhimtaria e përshtatshme, kompetente dhe gjigante.
- Sisteme fleksibël për prodhimin dhe qarkullimin e zinxhirëve furnizues.
- Realizimi i shpejtë i produktit.

#### *Prodhimtaria komplekse:*

- Instrumente të aksesshëm për prodhim me performansa të larta.
- Interaksioni i teknologjive të cilat kërkojnë bashkëpunim interdisiplinar.
- Përmirësimi i përdorimit të të teknologjisë së avancuar (për shembull, digjitalizimi).

#### *Prodhimtaria e përshtatur:*

- Qasje në produksione të përshtatura (për shembull, prodhim aditiv / printim 3D).
- Përshtatje me konkurrencën lokale dhe globale.
- Përdorimi i produktit për grupe me aftësi të kufizuar.
- Prodhimtaria për popullatën botërore.

#### *Prodhimtaria e fokusuar kah njerëzit:*

- Fokusi i njeriut (roli i vetëm si novatorë dhe vendimmarrës).
- Fokusi mbi përdoruesin.
- Fabrika të balancuara demografikisht (për shembull, struktura e grupmoshës, gjinia, migrimi, etj.).

#### *Prodhimtaria e qëndrueshme:*

- Qëndrueshmëria e ndërmarrjeve bazuar mbi vlera.
- Prodhimtaria efikase dhe efektive.

#### *Prodhimtaria inovative-aplikuese:*

- Prodhimtaria e hapur e inovacioneve.
- Lehtësimi i inovacioneve të orientuara drejt përdoruesit.
- Përgatitje për inovacione sociale.

Burimi: UNIDO

### 3.3 Industria përpunuese në Ballkanin Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) përjetuan transformim të madh ekonomik dhe politik në 15-20 vitet e kaluara. Në vitet '90-ta, pati konflikte nga të cilat rezultoi kolaps serioz ekonomik në fazën e parë të tranzicionit, që u pasqyrua me një rënie të madhe të prodhimit industrial që u shkaktua nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe nga konfliktet e armatosura në vitin 1990.



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Pasojë e kësaj ishte deindustrializimi. Që atëherë janë bërë reforma të rëndësishme dhe rimëkëmbje të ekonomive, meqë ato u hapën në drejtim të tregtisë botërore dhe IHD në mënyrë që të tërheqin kapital dhe njohuri nga jashtë. Ata u orientuan drejt eksportit, e zgjeruan rolin e sektorit privat, privatizuan shumë ish-ndërmarrje shtetërore dhe i shfuqizuan aktet normative të cilat e asfiksonin zhvillimin e ndërmarrjeve, njëkohësisht duke ndërtuar institucione, siç janë bankat komerciale dhe agjencitë për konkurrencë, në mënyrë që ta fuqizojnë sistemin e tregut. Vendet e Ballkanit Perëndimor u shpërblyen me një rritje të fuqishme ekonomike, me rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe standardit jetësor dhe një stabilitet makro-ekonomik shumë më të madh (Banka Botërore, viti 2015, Ballkani Perëndimor: 15 vjet tranzicion ekonomik).

Njëkohësisht, varfëria shënoi rënie të shpejtë edhe në numra absolut por edhe në thellësi. Edhe pse në aspektin absolut të gjithë ishin më mirë, rritja e shpejtë rezultoi me përfitime të pabarabarta dhe rritje të pabarazisë. Mangësia më e madhe e modelit ekonomik në vendet e BP ishte shfrytëzimi i pamjaftueshëm kronik i resurseve njerëzore. Në vitin 2008, në fund të valës së rritjes, shkalla e papunësisë në vendet e BP mesatarisht ishte më shumë se 20%, ndërsa shkalla mesatare e punësimit prej 40-45% nga viti 2000, ishte për 10% më e ulët në krahasim me vendet e reja anëtare dhe veçanërisht e ulët tek gratë dhe të rinjtë. Viteve të fundit, ekonomitë e vendeve të BP vazhduan me rritje. Gjasat afatmesme ekonomike për vendet e BP janë mjaft pozitive, përfshirë këtu edhe Maqedoninë.

### 3.4 Industria përpunuese në R. e Maqedonisë

Pas shqyrtimit të tendencave dhe çështjeve globale në lidhje me industrinë përpunuese dhe me gjendjen e përgjithshme, duke i përfshirë edhe performansat e fundit ekonomike, IDH dhe industrinë përpunuese në vendet e Ballkanit Perëndimor, analiza konkretisht u fokusua mbi kontekstin nacional të industrisë përpunuese në Republikën e Maqedonisë, duke i shfrytëzuar të dhënat ndërkombëtare dhe nacionale të aksesshme për dimensione të ndryshme, duke përfshirë:

- Komponentët e BPV sipas sektorëve industrial;
- Pjesëmarrjen e nën-sektorit në vlerën e shtuar të sektorit;
- Indekset zinxhirë të prodhimit industrial;
- Indeksin e produktivitetit industrial;
- Eksportin e mallrave;
- Prurjet IHD në industri;
- Prodhimtarinë: Maqedonia në krahasim me botën.

Ekziston konsensus gjithnjë e më i madh ndërkombëtar se politika e industrisë duhet të ketë prioritet në zhvillimin e ekonomisë nacionale. Në kuadër të sektorit industrial, stimulimi i zhvillimit të industrisë përpunuese konsiderohet si njëri nga promotorët kryesorë të rritjes ekonomike, progresit teknik, produktivitetit, inovacioneve etj. Megjithatë, industria është një koncept i gjerë sipas klasifikimit standard ndërkombëtar të industrisë (ISIC) Revizioni 3, industria ka të bëjë me seksionet 10-45 (Seksioni statistikor i Kombeve të Bashkuara, 2013) dhe e përfshinë prodhimtarinë, ndërtimtarinë dhe energjinë elektrike. Në këtë pjesë, nocioni "industri" ka të bëjë me Klasifikimin nacional të veprimtarive (KNV Rev 2) në Republikën e Maqedonisë dhe do t'i përfshijë tre sektorët në vijim: A. Sektori mineral dhe nxjerrja e gurit, B. Prodhimtari dhe C. Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim. Në fokusin e kësaj analize janë sektorët dhe nën-sektorët e prodhimtarisë.

#### 3.4.1 BPV sipas sektorëve industrial

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

BPV sipas sektorëve industrial është një indikator i dobishëm ekonomik për matjen e bruto prodhimit të çdo sektori. Prokurimet e inputeve midis fazave nga industri të tjera dhe masat e vlerës së shtuar na informojnë për kontributin e një industrie ose sektori të BPV. Sa u përket industrive, siç është industria përpunuese, shumica e përgjithshme që prodhohet dhe shitet si inpute midis fazave në industri të tjera janë komponentë të rëndësishëm të produkteve finale që shiten në ekonomi. Pastaj, rritja e prodhimit të industrive, me kalimin e kohës, shënon efekte pozitive të transmetimit mbi tregtinë, transportin dhe komunikimet, e që nga ana tjetër bashkërisht kontribuojnë në rritjen ekonomike.


Prodhimtaria industriale në vend manifeston oscilime të konsiderueshme në nën-sektorët industrial gjatë periudhës së deritanishme, si rezultat i politikës ekonomike vendore dhe ndryshimeve lidhur me kërkesën e tregjeve të huaja (shih: Tabelën A1 në Aneks).

Ndryshime më dramatike ndodhën në kuadër të industrisë përpunuese prodhimi bruto i së cilës në disa nën-sektorë shënoi rënie dramatike, siç është prodhimi në nën-sektorin për koks dhe derivate të naftës, prodhimi i të cilave shënoi rënie nga 22.645 milionë denarë në vetëm 55 milionë denarë. Në kundërshtim me këtë, rritje të konsiderueshme u shënuan në nën-sektorin për prodhimin e makinave dhe pajisjes, prodhimi bruto i të cilit rrit për 66 herë nga 896 milionë denarë në vitin 2005 në 58.746 milionë denarë në vitin 2014. Nën-sektorët e tjerë, me një tendencë relativisht stabile të rritjes së bruto prodhimit janë ato të prodhimit të pajisjeve elektrike, mobilieve, produkteve prej gome dhe plastike dhe produkteve ushqimore.

### 3.4.2 Pjesëmarrja e nën-sektorit në vlerën e shtuar të sektorit

Vlera e shtuar bruto është elementi kryesor i BPV dhe paraqet balancë midis bruto prodhimit dhe konsumit midis fazave dhe vlerës së shtuar të nën-sektorëve të caktuar, në këtë mënyrë duke e vënë në dukje kontributin e tij në BPV. Pjesëmarrja e një dege të caktuar në vlerën e shtuar siguron informacione të mirëseardhura jo vetëm për gjendjen e industrisë në periudhën raportuese, por edhe për intensitetin e zhvillimit të secilës nga degët, e që e vë në dukje fokusin e strukturës së saj të ardhshme.

Situata, sa i përket vlerës së shtuar të industrisë përpunuese – VSHP (në bazë të statistikës së UNIDO) është ilustruar në Diagramin si vijon. Vërehet tendenca se nga vitet 1990, VSHP shënon rënie, përveç një rritjeje në vitin 2006 dhe rimëkëmbja graduale nga viti 2008 e këndeje, e që ndoshta mund të ndërlidhet me prurjet e IDH që atëherë si dhe për kohën e periudhës së kaluar.




Burimi: UNIDO <https://stat.unido.org/SDG>



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese


Tabela A2 e Aneksit tregon se në industrinë përpunuese, pesë nën-sektorë kanë pasur kontribut më të madh në krijimin e vlerës së shtuar të sektorit, siç është prezantuar në Diagramin si vijon:

**Diagrami 5: Kontributi i nën-sektorëve kryesorë të industrisë përpunuese në vlerën e shtuar (2005-2014 në %)**



### 3.4.3 Indekse zinxhirë të prodhimit industrial

Indeksi zinxhirë është indeksi në të cilin vlera e cilësdo qoftë periudhe të caktuar ndërlidhet me vlerën e periudhës së saj direkte paraprake, që rezulton me indeksin e periudhës së caktuar të pasqyruar sa i përket periudhës paraprake (= 100). Diagrami në vijim dhe Tabela A3 e Aneksit tregojnë se prodhimi industrial në dekadën e fundit ka pasur oscilime të konsiderueshme në kuadër të sektorëve dhe nën-sektorëve të caktuar, megjithatë asnjë nën-sektor nuk ka përjetuar rritje të vazhdueshme në prodhimin industrial gjatë periudhës së shqyrtuar kohore.



Kontribut më të madh individual ka pasur industria përpunuese duke i pasur parasysh repartet vendore dhe të huaja të orientuara drejt eksportit. Rritja e prodhimit industrial në disa


## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

nën-sektorë është mbështetur me prurjet nga IHD në këtë sektor. Duke e pasur parasysh strukturën, mund të vërehet se indeksi i prodhimit industrial për prodhimin e mjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkio në vitin 2014 ka arritur 1.494% (fabrika për mjete dhe pjesë këmbimi për mjete në ZZHTI). Madje edhe në vitin 2016 rritja është 52,2%.

Ndryshimet e dobishme në industrinë përpunuese, po ashtu, e pasqyrojnë Prodhimin e rritur të makinave dhe pajisjes, mesatarja e të cilave është 24%; në vitin 2016, prodhimi në këtë sektor shënoi rritje për 22%. Disa nën-sektorë me rritje të lartë mesatare në periudhën njëmbëdhjetë vjeçare, siç është prodhimi i mobilieve shënuan rritje prej 14,4%, ndërsa prodhimi i pajisjeve tjera transportuese rritje prej 11%. Njëkohësisht, ato kanë përjetuar reduktim të prodhimit nga 3,6% dhe 1,3% në vitin 2016. Vërehet rënie e rritjes mesatare në sektor të ndryshëm, ndërsa rënia më e madhe ka qenë në prodhimin e koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës, ku prodhimi shënon rënie nga viti 2010.

### 3.4.4 Indeksi i produktivitetit në industri

Rritja e prodhimit nuk është e njëjta gjë me rritjen e produktivitetit. Produktiviteti i punës është masa më e shpeshtë e Faktorit parcial të produktivitetit (FPP) dhe zakonisht matet si vëllim i prodhimit sipas një orë pune. Diagrami në vijim e vë në dukje rritjen e tendencës së produktivitetit të punës në industrinë përpunuese, në krahasim me sektorët e tjerë të industrisë.



Produktiviteti i punës është prezantuar si proporcion i indeksit të vëllimit të përgjithshëm të prodhimit industrial dhe indeksit të të punësuarve, siç është prezantuar në Tabelën A4 të Aneksit. Në krahasim me vitin 2005, rritje më të madhe të produktivitetit të punës në vitin 2012 është shënuar në prodhimin e pajisjes tjetër për transport, dhe pas kësaj pason riparimi dhe instalimi i makinave dhe pajisjes dhe prodhimi i makinave dhe pajisjes. Tendencat e njëjtë, sa i përket produktivitetit të punës, ka vazhduar edhe në vitet në vijim në Prodhimin e pajisjes tjetër për transport, Prodhimin e makinave dhe pajisjes, por gjithashtu indekset e produktivitetit kanë qenë të konsiderueshme në vitin 2015 në krahasim me vitin 2010 në nën-sektorët siç është prodhimi i mjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkio (209) dhe prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës (203). Statistika tregon tendencë të rënies së produktivitetit të punës në vitin 2015 në nën-sektorët Prodhim i koksit dhe produkteve të rafinuara nga nafta, Miniera të thëngjillit dhe linjtit dhe prodhimi i produkteve të fabrikuar metalore, përveç makinave dhe pajisjes.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Reduktimi i produktivitetit zakonisht shoqërohet me reduktimin e bruto pagave reale. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se disa sektorë të ekonomisë tradicionalisht kanë rritje të ulët të produktivitetit, por megjithatë kanë rëndësi vitale për mbarë ekonominë, si për shembull, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të ngjashme. Shkaku për këtë ndoshta qëndron në atë se në këto nën-sektorë në industrinë e tekstitit puna është e vështirë. Në vendet e zhvilluara, në të cilat prodhimtaria është automatizuar, faktori i produktivitetit të punës është më i madh. Përveç për disa masa të produktivitetit, ekziston edhe produktiviteti multifaktorial, që ka të bëjë me produktivitetin për shkak të angazhimit të të gjithë faktorëve të prodhimtarisë (kapitali, fuqia e punës, energjia, materialet, etj.). Kjo metrikë është më adekuatja për matjen e produktivitetit, megjithatë kufizimi i saj është në mungesën e të dhënave të nevojshme për përlogaritje.

Fakti se produktiviteti ndonëse ka shënuar rritje në një periudhë të caktuar, kryesisht ka të bëjë me zvogëlimin e të punësuarve në këto nën-sektorë. Përveç kësaj, siç theksohet në Raportin për konkurrencën globale (2015), faktorët e tjerë të cilët ndikojnë mbi produktivitetin e punës përfshijnë fuqi pune me arsim joadekuat dhe me etikë të keqe të punës. Megjithatë, nga ana tjetër, rritja e produktivitetit mund të rezultojë edhe nga investimet në teknologjitë reja dhe nga rrjedhjet e tjera pozitive, siç është transferi i njohurive i cili rezulton nga IHD. Kjo nënkupton se ndikimi i rritjes së produktivitetit mbi rritjen e eksportit vjen përmes kanalit të produktivitetit i cili është nën ndikimin e IHD (për shembull, aplikimi i teknologjive të reja, transferimi i know-how, inkorporimi i aftësive të reja menaxheriale dhe ekspertiza etj.). Është e qartë se politika e produktivitetit është një faktor i rëndësishëm për ardhmërinë.

Nevojiten nivele më të larta të inovacioneve në mënyrë që të përshpejtohet rritja e produktivitetit në Maqedoni. Firmat punojnë sipas indikatorëve rajonal të inovacioneve, duke e përfshirë edhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, inkorporimin e proceseve të reja për prodhim ose shërbime dhe bashkëpunim me universitetet për aktivitete inovative. Për shembull, rreth një e treta e eksportit të mallrave nga Maqedonia përbëhet nga bujqësia, mineralet dhe metalet. Pastaj, pjesa më e madhe e eksportit të produkteve bujqësore janë mallra të papërpunuar, siç janë mollët, pjeshkat dhe kumbullat. Edhe pse produktet e prodhuara dominojnë në eksportin e mallrave, ata edhe më tutje janë në pragun e ulët në raport me intensitetin dhe kualitetin e teknologjisë. Firmat maqedonase janë në 2,8 nga gjithsej 7 (në vendin e 110-të nga 138 vende) në Raportin për konkurrencë globale për vitin 2017, sa i përket përparësisë së konkurrencës, që është nën mesataren prej 3,6 në mesin e bashkëmoshatarëve aspirantë. Sa i përket kapacitetit për inovacione, ajo rankohet në 4 nga 7 (e 82-ta nga 138 vende), nën mesataren prej 4,4 midis bashkëmoshatarëve aspirantë. Nga ana tjetër, ajo është rankuar më poshtë në krahasim me bashkëmoshatarët aspirantë sa i përket kualitetit të furnizuesve lokal, sofistikimit të proceseve prodhuese dhe përdorimit të marketingut, si dhe sa u përket indikatorëve që kanë të bëjnë me kualitetin e institucioneve shkencore-hulumtuese dhe bashkëpunimit midis universiteteve dhe industrisë për hulumtim dhe zhvillim (Banka Botërore, 2018).

Me sa duket proceset prodhuese dhe miratimi i teknologjive janë kufizuar midis firmave, e që e pengon produktivitetin e tyre dhe potencialin inovator. Koordinimi i kufizuar midis sektorit privat dhe institucioneve hulumtuese, si dhe financimi i kufizuar për hulumtim dhe zhvillim ndikojnë mbi potencialin e zhvillimit të produkteve inovative. Nga ana tjetër, analizat e identifikojnë nevojën e optimizimit të prodhimtarisë sipas "*lean*prodhimtarisë" (prodhimtari me humbje minimale) dhe sipas parimeve për përmirësim të vazhdueshëm. Vetëm 8,9% e firmave në Republikën e Maqedonisë kanë përdorur teknologji të licencuar nga kompani të huaja (2013), në krahasim me mesataren prej 20% midis bashkëmoshatarëve aspirantë. Në Raportin për konkurrueshmërinë globale nga viti 2017, Republika e Maqedonisë është rankuar më poshtë se bashkëmoshatarët aspirantë sa i përket aksesit të teknologjive më të fundit, shkallës deri te e cila IHD i sjellin teknologjitë e reja në vend dhe shkalla deri në të cilën firmat i miratojnë teknologjitë e fundit (Banka Botërore, viti 2018). Prandaj, ka nevojë

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

për një fokus shumë më të fuqishëm të transferit të teknologjive, ekstensionit dhe absorpsionit në të ardhmen, me fokus mbi prodhimtarinë.


Një faktor tjetër i cili ndikon mbi produktivitetin dhe inovacionin në përgjithësi është kapitali njerëzor. Duhet të theksohen tre çështje. Së pari, firmat maqedonase vuajnë nga investimet e vogla në trajnimet për aftësi menaxheriale dhe për aftësi teknike dhe të shitjes, të cilat janë mjaft të rëndësishme për lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me investitorë të huaj. Nga ana tjetër, menaxherëve shpeshherë iu mungojnë aftësi “të buta” (për shembull, rrjetëzimi, fjalimi publik, negociimi) dhe njohje të koncepteve afariste (për shembull, monetizimi dhe zhvillimi afarist) në mënyrë që të tërheqin mjete financiare dhe të menaxhojnë biznes. Së dyti, oferta e aftësive në ekonomi nuk përkon me vendet e ofruara të punës, edhe krahas arritjeve të larta arsimore. Gjysma e firmave nga industria përpunuese (hulumtim i STEPS 2017) paraqesin mungesë të aftësive tek të punësuarit e tyre aktual (76% e industrisë automobilistike, 58% nga prodhimtaria tjetër, 54% nga produktet ushqimore, 53% nga tekstili, 42% nga TIK, 41% nga logjistika etj.). Ky është një tregues i aftësive joadekuate në ekonomi për nevojat e ekonomisë moderne. Rezultatet e tjera nga ky hulumtim, gjithashtu, çojnë në këtë drejtim. Në mesin e firmave të cilat kanë paraqitur probleme që kanë të bëjnë me vështirësitë për të gjetur punëtorë, aftësitë janë identifikuar si pengesë më e madhe. Trajnimi jopërkates dhe mungesa e punëtorëve me përvojë janë probleme më të rëndësishme sesa pagat mesatare ose shpenzimet për sigurim social dhe aktet normative për punësim. Së treti, ekziston mosharmonizim ndërmjet aftësive që mësohen dhe nevojave të tregut. Sistemi për arsim profesional dhe trajnim karakterizohet me profile ngushtë të definuara profesionale, megjithatë, kërkesa e aftësive largohet nga aktivitetet rutinore, kognitive në drejtim të aftësive të reja ekonomike të cilat përfshijnë aftësi jo-rutinore, siç janë mes tjerash aftësia për të mësuar në mënyrë të pavarur punë të reja dhe aftësia e komunikimit. Kjo ka implikime mbi politikën e sistemit për arsim profesional dhe trajnim, si dhe për sistemin e arsimit të lartë, ku nevojitet bashkëpunim më i madh ndërmjet firmave, studentëve dhe akademikëve, në lidhje me nevojën e reduktimit të nivelit të migrimit dhe largimit të elitës intelektuale.

### 3.4.5 Eksporti i mallrave

Tabela A5 e Aneksit vë në dukje se vëllimi i eksportit ka shënuar rritje nga 1.918 milionë euro në vitin 2006 në 4.088 milionë euro në vitin 2015, me vlerë të përgjithshme prej 28.972 milionë euro gjatë gjithë dekadës. Përrjashtim nga kjo tendencë pozitive kishte veçanërisht gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2012, kur eksporti fillimisht është reduktuar për shkak të efekteve negative nga kriza ekonomike globale. Tendencë në rritje është ilustruar në Diagramin në vijim.

### Diagrami 8: Eksporti në Maqedoni (2008-2018)

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese



Reduktimi i aktivitetit ekonomik, në shumicën e vendeve fqinje, gjendja pas recesionit në Evropë, kriza në eurozonë, kriza debitorë, zvogëlimi i IHD dhe rritja e çmimeve të energjisë bashkërisht kishin influencë negative mbi ekonominë. Zhvillimi i ngadalshëm i ekonomisë në vendet e BE-së, pranuesit kryesorë të eksportit nga Ballkani Perëndimor, e dobësoi kërkesën dhe çoi në zvogëlimin e investimeve. Efektet e këtyre tendencave ishin evidente në vendin tonë.

Në strukturën eksportuese të ekonomisë dominojnë produktet e tekstit dhe produktet metalore. Rimëkëmbja graduale e kërkesës për eksport dhe fluktacionet favorizuese të çmimeve të metaleve në tregjet botërore kontribuuan për vazhdimin e tendencës të rimëkëmbjes ekonomike të vendit. Kjo do të thotë se performancat eksportuese të kompanive vendase, në masë të madhe, janë kushtëzuar nga zhvillimi i kërkesës së jashtme dhe objektivave globale, edhe pse rritja e eksportit të mallrave është po ashtu rezultat i potencialit të rritur eksportues të vendit.

Rritja e eksportit u shoqërua me ndryshimin e strukturës së eksportit në drejtim të produkteve me vlerë të shtuar më të lartë, në përputhje me prodhimtarinë dhe eksportin e kompanive me seli në ZZHTI. Për shkak të kapaciteteve të reja të ekonomisë, u përmirësua edhe struktura eksportuese, duke e rritur gradualisht pjesëmarrjen e produkteve me vlerë të shtuar më të lartë në eksport, edhe atë kryesisht produkte kimike, makina dhe pajisje transporti.

Nga të dhënat mund të shohim se shtatë produkte (shih: Diagramin në vijim) paraqesin më shumë se 66,5% nga eksporti i përgjithshëm i vendit, e që tregon se struktura eksportuese e vendit është mekoncentrim të lartë. Dy grupe të produkteve kanë vlerë të përbashkët më të madhe në eksport gjatë dekadës: Robot (pjesë e industrisë së tekstit) dhe Hekuri e çeliku. Njëkohësisht, këto dy grupe të produkteve industriale tradicionalisht eksportuese shënuan tendencë të rënies së eksportit nga viti 2011, me reduktim të vogël të Tekstit në krahasim me rënien më të shpejtë të Hekurit dhe çelikut, me vlerë eksportuese prej 465 milionë euro dhe 412 milionë euro në vitin 2016. Viteve të fundit, tendencat e eksportit të Hekurit dhe çelikut ishin nën ndikimin e tendencave të papërshtatshme të tregut ndërkombëtar të metaleve dhe rënies së çmimeve.


Edhe krahas vlerave përgjithësisht të larta eksportuese (të akumuluar në vitet paraprake) kishte tendencë akoma më të shprehur të rënies gjatë eksportit të lëndëve djegëse minerale dhe lubrikifanteve. Gjatë viteve të kaluara ato shënuan reduktim të vazhdueshëm të eksportit, e që kryesisht e pasqyron ndryshimin e orientimit afarist të rafinerisë së naftës, e cila është në pronësi të huaj. Rritja e eksportit kryesisht ka të bëjë me makina dhe pajisje transporti dhe produkte të industrisë kimike, që e pasqyron ndikimin e kapaciteteve të reja në

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

ZZHTI. Produktet kimike dhe produktet e ngjashme, me vlerë të përgjithshme prej 2.900 milionë euro shënuan tendencë të rritjes së eksportit nga viti 2011 dhe kanë pasur pjesëmarrje relativisht më të lartë (19%) në eksportin e vendit në vitin 2015, e që është akoma më i lartë në vitin 2016 (21% nga eksporti i përgjithshëm).

Makinaria e përgjithshme industriale dhe makinat elektrike, aparatet dhe instalimet ishin grupi tjetër i produkteve industriale me tendencë në rritje në vëllimin e eksportit nga viti 2013, duke arritur 12% dhe 11% nga eksporti i përgjithshëm në vitin 2016. Edhe pse industria e metalurgjisë u godit seriozisht nga kriza ekonomike botërore, megjithatë, ajo luajti një rol të rëndësishëm në eksport. Ky sektor eksporton xehe metalore dhe mbetje metalore në vlerë prej 1.340 milionë euro gjatë dhjetë viteve, e që është rreth 5% nga eksporti i përgjithshëm i vendit gjatë dekadës.

**Diagrami 9: Shtatë produktet më të pranishëm gjatë eksportit në Republikën e Maqedonisë (2006-2015, miliona euro)**



Shporta e eksportit relativisht e padiversifikuare bën ekonominë mjaft fragjile nga goditjet e jashtme. Kjo u dëshmuar gjatë krizës së fundit botërore, me ç'rast kanali kryesor për transferimin e krizës ishte përmes kërkesës së huaj. Literatura, që ka të bëjë me strukturën dhe performancat e eksportit, vë në dukje se eksporti i diversifikuar ka ndikim të konsiderueshëm pozitiv mbi eksportin.

Eksporti i vendit nuk është vetëm i padiversifikuar por është edhe njëri nga më pak të sofistikuarit në rajon. Indeksi i Sofistikimit eksportues (EXPY) e mat sofistikimin e eksportit dhe përlogaritjet si mesatare e ponderuar të nivelit të sofistikimit të produkteve të eksportuara. Vlerësimi i nivelit të sofistikimit teknologjik në portofolin eksportues të vendit vë në dukje zhvillimin ekonomik të atij vendi. Industria e metaleve ishte industria më e madhe eksportuese në vend (me pjesëmarrje prej 25% në eksportin e përgjithshëm të vendit në vitin 1995), por viteve të fundit u ballafaqua me shumë probleme, megjithatë, i ruan përparësitë komparative dhe karakterizohet si industri me diversifikim të mesëm (në vitin 2014, 55 produkte janë eksportuar me përparësi komparative). Analiza e kompleksitetit të industrisë vë në dukje se industria e metaleve ka kapacitet për diversifikimin e mëtutjeshëm të produkteve, përmes ndërtimit të mundësive të reja për prodhimin e produkteve më komplekse.

Analiza e të dhënave të Eurostat e vë në dukje faktin se mallrat e përpunuar janë lloji kryesor i mallrave me të cilat tregtohet në BE: në vitin 2016 ato kanë qenë në lartësi prej 83% nga eksporti i përgjithshëm i BE-së. Të rëndësishme janë tri kategori të mallrave të përpunuar: Kimikatet, Makinaria dhe mjetet si dhe Mallrat e tjerë të prodhuar me pjesëmarrje prej 18%,

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

42% dhe 23%. Sa i përket importit në BE, pjesëmarrja e mallrave të përpunuar është diçka më e ulët në krahasim me eksportin (69%). Pjesëmarrja e kategorive Makineri dhe mjete (32%) dhe Kimikate (11%) ka qenë më e ulët në krahasim me eksportin, ndërsa pjesëmarrja e produkteve tjera (26%) ka qenë pak më e lartë në krahasim me eksportin. Makineritë dhe mjetet janë grupet më të rëndësishme individuale të produkteve në tregtinë ndërkombëtare të BE-së, të cilët marrin pjesë me 43% nga eksporti i përgjithshëm i BE-së dhe 32% nga importi i përgjithshëm i BE-së në vitin 2016. Tri kategoritë kryesore të produkteve të importuara janë Makinat Elektrike (215 miliardë euro), Pajisje për telekomunikime (193 miliardë euro) dhe Mjete udhëtimi (151 miliardë euro).

Sipas të dhënave përfundimtare të Entit Shtetëror të Statistikave (Tregtia e jashtme sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2015), më shumë se 89% nga shkëmbimi i përgjithshëm i jashtëm tregtar në vitin 2015 janë realizuar nga ndërmarrje të përfshira në dy rrjedha tregtare. Suficiti i jashtëm tregtar kryesisht është gjeneruar nga ndërmarrjet industriale, ndërsa deficitin kryesisht është gjeneruar nga sektori i tregtisë. Mikro ndërmarrjet kanë dominuar në strukturën e tregtisë së jashtme sipas numrit të ndërmarrjeve (52,7%), e që është 40,5% nga vlera e tregtisë së jashtme në sektorin e Tregtisë. Ndërmarrjet e mëdha, krahas pjesëmarrjes së tyre të pakonsiderueshme në strukturën sipas numrit të ndërmarrjeve (3,0%), kanë realizuar 74,2% nga vlera e tregtisë së jashtme në sektorin e Industrisë. Përveç kësaj, rreth gjysma e vlerës së përgjithshme të eksportit dhe importit ka qenë e koncentruar në 100 ndërmarrjet e para, megjithatë, më shumë se 50,0% e vlerës së tregtisë së jashtme ka qenë e koncentruar në 10 ndërmarrjet e para. Vëllim më i madh i eksportit është regjistruar në rajonin e Shkupit, 53,1%, ndërsa ndërmarrjet e këtij rajoni kanë pasur pjesëmarrje më të madhe në importin me 68,6%. Këto informacione e fuqizojnë nevojën imanente të iniciativave për politika me qëllim të zgjerimit të bazës së eksportit.


Analiza e njëjtë vë në dukje se në strukturën e eksportit dominojnë (71,3%) e ndërmarrjeve të cilat mallrat e tyre i eksportojnë në tregun e BE dhe se sektori industrial ka pjesëmarrje më të madhe nga numri i ndërmarrjeve (44,4%) dhe gjenerojnë vlerë (90,1%). Nga ana tjetër, BE apostrofohet si treg më atraktiv për import. Në strukturën e vlerës, ndërmarrjet e sektorit të industrisë, të cilat importojnë nga tregu i BE, kanë pasur pjesëmarrje më të madhe prej 54,6%. Këto të dhëna tregojnë se theksi i politikës duhet të vihet mbi tregun e BE-së, si dhe mbi vendet fqinje.

### 3.4.6 Prurje të IHD në industri


Ekonomia maqedonase ka përfitime nga Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe u bë destinacion mjaft i pranuar për industrinë përpunuese, veçanërisht për prodhimin e pjesëve të këmbimit për automobila dhe rroba. Ajo, përveç kësaj, ka performansa të fuqishme eksporti. Kjo krijon bazë të shëndetshme për avancimin e prodhimtarisë. Një gjë e këtillë, është e domosdoshme, jo vetëm për shkak të faktit se industria përpunuese merr pjesë vetëm me 5% të ndërmarrjeve në vend (BB, 2016, Fuqizimi i konkurrencës, investimeve të huaja dhe eksportit në Maqedoni). Diagrami në vazhdim tregon se nivelet e përgjithshme të IHD nga viti 2009 janë rimëkëmbur nga efektet e krizës ekonomike dhe shënojnë tendencë në rritje. Elementi prodhues i IHD është rreth një e treta e IHD të përgjithshme dhe po ashtu ka tendencë të rritjes.



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese



Në kuadër të industrisë së përgjithshme përpunuese, përdërisa shumica e nën-sektorëve kanë pasur rritje modeste, sektori i mjeteve dhe transporti tjetër kanë pasur rritje rapide thuaja se një dekadë.



Ndryshimet në strukturën e eksportit, me kalimin e kohës, mund të korrespondojnë me nivelin e IHD. Kjo lidhshmëri mund të shihet në Tabelën A5, veçanërisht në Sektorin e Metaleve, ndërkaq pastaj vijnë në radhë Sektori i tekstilit dhe Sektoriminerar. Gjatë viteve 2009-2015, kapitali i huaj kryesisht investohej në industrinë ushqimore dhe mjetet motorike,



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

rimorkio dhe gjysmë-rimorkio, ku mund të pritët kontribut në drejtim të diversifikimit më të madh të eksportit, megjithatë, deri në vitin 2015 prodhimet e këtyre nën-sektorëve nuk ishin më të përfaqësuar në eksport. Të dhënat nga periudha kohore 2009-2015 me siguri nuk mund ta konfirmojnë lidhshmërinë e IHD me kapacitetet eksportuese të ekonomisë.

Duke i shqyrtuar prurjet nga IHD, gjatë periudhës kohore 2006-2008, mund të konkludojmë se vetëm dy nën-sektorë të industrisë tregojnë lidhshmëri të fuqishme me performancat eksportuese, në të vërtetë Sektori i metaleve dhe Sektori mineral. Investimet e huaja në prodhimet e rafinuara të naftës u akumuluan në vitet para vitit 2008 dhe në masë të konsiderueshme kontribuuan në eksport deri në vitin 2012, e që rezultoi me vlerë të lartë mesatare në periudhën dhjetëvjeçare.

Përcaktuesi më i rëndësishëm i eksportit është kërkesa e huaj, në kombinim me mundësitë e vendit që ta kënaq me prodhime të cilat i përmbushin standardet e kërkuara ndërkombëtare. Kërkesa e huaj është një input relevant i cili duhet të shqyrtohet në lidhje me specializimin e sektorit, duke i pasur parasysh resurset ekzistuese dhe kapacitetet e vendit për ta përmbushur kërkesën e këtillë. Në këtë kuptim, një komponentë shtesë që duhet të analizohet është kërkesa nga tregjet më të rëndësishëm të huaj, ndërsa në rastin e Maqedonisë është tregu i BE.

Përgjithësisht është e pranuar se IHD stimulojnë rritje ekonomike dhe eksport më të madh përmes rritjes së punësimit, produktivitetit dhe progresit teknologjik, veçanërisht në vendet në zhvillim, megjithatë, raporti midis IHD, eksportit dhe rritjes ekonomike nuk është i qartë. Studimet, sa u përket marrëdhënieve afatgjata midis këtyre variablave japin rezultate kontraktore, por në përgjithësi nuk vërehet një raport i konsiderueshëm me tendencën nga eksporti deri te IHD dhe nga IHD deri te BPV.

Pastaj, IHD në Republikën e Maqedonisë janë mbështetur mbi stimulimin për investim dhe krijimin e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale (ZZHTI), si dhe mbi brendimin/promovimin por edhe mbi angazhimet për përmirësimin e mjedisit afarist. Qeveria u akordoi 225 miliona euro stimulime investuese 25 investitorëve të huajt të cilët punësojnë gjithsej 20.000 punëtorë (2016). Krahas asaj që përfitimet nga IHD janë të rëndësishme sa i përket hapjes së vendeve të reja të punës, integrimi në zinxhirët e vlerave rajonale dhe globale dhe sofistikimi i rritur i eksportit, megjithatë provat e vënë në dukje atë se IHD në Republikën e Maqedonisë kanë krijuar vetëm lidhje të avancuara e të kufizuara me firmat vendase dhe kanë krijuar "enklava" me firma të integruara dhe me produktivitet të lartë në kuadër të ZZHTI. Për shembull, furnizimet nga ana e investitorëve të huaj nga firmat vendase janë 48 milionë euro (fondi i vitit 2016) ose vetëm 1% nga eksporti në nivel vjetor. Shumë investitorë të huaj kanë vendosur vlera relativisht të ulëta, aktivitete pune intensive, ndërsa disa aktivitete kanë bazë të ngushtë të furnizimit dhe ofrojnë mundësi të kufizuara për më shumë lidhje me firmat vendase, siç është montazhi i pjesëve të këmbimit me komponentë të importuar (Banka Botërore, 2018, Shfrytëzim të potencialit për ardhmëri më të ndritshme: Koncepti sistematik për diagnostifikimin e vendit).

Kjo që u tha më lartë, e vë në dukje nevojën e fuqizimit të lidhjeve ndërmjet ZZHTI dhe ekonomisë vendase. Pastaj, Strategjia transparente për investime e fokusuar mbi barazimin e mjedisit për të gjitha firmat mund të jetë më efiçase në tërheqjen e IHD dhe në rritjen e investimeve vendase. Lehtësimet tatimore, marrë në përgjithësi, nuk janë faktori më i madh për investitorët gjatë vendimmarrjes për lokacionin; në vend të kësaj investitorët shpesh e zgjedhin Maqedoninë për shkak të çmimeve të ulëta dhe për shkak të afërsisë me tregjet e BE-së. Stimulimet janë vetëm një faktor nga shumica e faktorëve, duke i përfshirë edhe shpenzimet për fuqinë e punës, shpenzimet operative, shpenzimet për tregti dhe transport dhe kualiteti aktual i sundimit të së drejtës. Përveç trajtimit të shtetit i cili nuk bën dallime

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

midis investitorëve vendas dhe të huaj, ekziston provë se ndihma shtetërore për firmat duhet të jetë më transparente (Banka Botërore, viti 2018).

### 3.4.7 Industria përpunuese: Maqedonia në krahasim me botën

Organizata për Zhvillim Industrial pranë Kombeve të Bashkuara (UNIDO) e publikoi Indeks të konkurrencës industriale (CIP) për matjen e zhvillimit industrial të vendeve, siç është prezantuar në Kornizën në vijim. Në Tabelën A6 është pasqyruar Maqedonia në krahasim me Botën.

#### Box 7: Korniza 7: Indeksi i performansave të industrisë (CIP) të UNIDO

Indeksi (CIP) përbëhet nga gjashtë variabla të cilat paraqesin tre dimensione të ndryshme.

Dimensioni i parë e përshkruan *kapacitetin e vendit për prodhim dhe eksport* dhe ka dy variabla:

- Vlera e shtuar e prodhimit për kokë banori (VSHP për kokë banori), e cila e pasqyron vlerën e shtuar;
- Eksporti prodhues për kokë banori (EP për kokë banori), i cili jep informacione për eksportin e mallrave të prodhuara.

Dimensioni i dytë ka të bëjë me *teknologjinë* dhe ka dy variabla:

- Pjesëmarrja e vlerës së shtuar të prodhimit në BPV, e cila ofron informacione për kapacitetin e një vendi që të transformoj mallra;
- Pjesëmarrja e vlerës së shtuar të teknologjisë së lartë në vlerën e shtuar të përgjithshme të prodhimit, e cila ofron informacione për progresin teknologjik të prodhimit në vend.

Dimensioni i tretë e shqyrton *ndikimin e vendeve mbi prodhimin e përgjithshëm botëror* dhe ka dy variabla:

- Pjesëmarrja e eksportit të industrisë përpunuese në shumën e përgjithshme të mallrave, e cila ofron informacione për pjesëmarrjen e produkteve të prodhuara në eksportin e përgjithshëm;
- Pjesëmarrja e eksportit të mesëm dhe teknologjisë së lartë në eksportin e përgjithshëm të mallrave, e cila ofron informacione për kompleksitetin e produkteve të eksportuara.

Vlera e shtuar e prodhimit (VSHP) për kokë banori e vë në dukje potencialin industrial të ekonomisë, meqë industria përpunuese jo vetëm që prodhon artikuj themelorë për konsum vendor dhe eksport, por siguron edhe teknologji të reja për sektorët e tjerë të ekonomisë. Në bazë të Raportit për zhvillim të UNIDO (2016), në vitin 2013, industritë përpunuese dominante në nivel global kanë qenë industria e Ushqimit dhe pijeve (12,0%), Kimikateve dhe produkteve kimike (11,7%), të Makinerisë dhe pajisjes (8,5%). Ndërmjet viteve 2000 dhe 2013, tetë sektorë përpunues kanë shënuar rritje të pjesëmarrjes së tyre në VSHP në nivel botërorë, nga 39,7% në 46,6% të kombinuara. Rritje të konsiderueshme janë shënuar në Prodhimin e pajisjeve për radio, televizion dhe komunikim; Metaleve bazë, Kimikateve dhe produkteve kimike dhe të Mjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove. Reduktime janë vërejtur në 14 sektorë të industrisë përpunuese nga 60,3% të kombinuara në vitin 2000 në 53,4% në vitin 2013, duke i përfshirë edhe industritë tradicionale, siç është industria e Tekstililit, Rrobave, Peliçeve dhe e Produkteve nga druri dhe letra, si dhe printimi. Prodhimi i produkteve të konstruara nga metali dhe prodhimi i makinerisë dhe pajisjes, po ashtu, kanë pasur reduktim të pjesëmarrjes në strukturën përpunuese. Kjo mund të ketë implikime potenciale afatgjata mbi politikën.

Eksporti i industrisë përpunuese për kokë banori e përfshin aftësinë e një vendi që në mënyrë konkurrense të prodhojë mallra dhe ta mbajë hapin me ndryshimet teknologjike. Të dhënat për eksportin e prodhuar e vënë në dukje efikasitetin ndërkombëtar, nëse nuk ka çështje të papritshme, si dhe i zbulon tendencat strukturore. Megjithatë, të dhënat për ekonominë e mëdha janë arbitrare për shkak të kërkesës së madhe të brendshme dhe stimulimit të tregjeve vendase. VSHP për kokë banorishënoi rritje graduale gjatë viteve 2005-2014; në fund të vitit 2014, vetëm Bosnja e Hercegovina dhe Moldavia kanë pasur VSHP më të ulët për kokë banori. Situata është më pozitive me eksportin e industrisë përpunuese për kokë banori, që në masë të konsiderueshme është përmirësuar me kalimin e kohës e që

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

nënkupton se pozita e vendit është në grupin e vendeve me të ardhura mesatare, ndërkaq me pozitë më të mirë sesa Serbia, Turqia dhe Rusia.

Pjesëmarrja e industrive të mesme dhe të teknologjisë së lartë në VSHP të vendit e pasqyron kompleksitetin teknologjik të industrisë përpunuese. Zhvillimi ekonomik përgjithësisht e nënkupton tranzicionin strukturor të aktiviteteve të mbështetura në resurse dhe në aktivitete të teknologjisë së ulët deri në aktivitete të mesme dhe të teknologjisë së lartë. Sa më komplekse të jenë strukturat prodhuese të një vendi aq më të mëdha janë mundësitë për mësim dhe inovacione teknologjike të sektorit dhe në nivel ndër-sektorial. Prodhuesit mesatar dhe të teknologjisë së lartë kanë vlerë të shtuar më të madhe nga prodhuesit me teknologji të ulët dhe në masë të konsiderueshme kontribuojnë në VSHP.

Ndryshimi i strukturës prodhuese më së shumti vjen në shprehje në ndryshimin e industrisë në drejtim të produkteve teknologjike më komplekse. Pjesëmarrja e industrive mesatare dhe të atyre me teknologji të lartë në VSHP jo vetëm që është e ulët, madje është edhe më e ulëta në krahasim me nivelin e vendeve të tjera me të ardhura mesatare, siç është Ukraina. Së këtejmi, niveli i këtij indikator gjatë periudhës dhjetëvjeçare tregon se kompleksiteti teknologjik i prodhimeve maqedonase nuk është përmirësuar në masë të konsiderueshme. Pjesëmarrja e industrisë së mesme dhe të teknologjisë së lartë në eksportin e përgjithshëm të industrisë përpunuese ka indikatorë shumë më të mirë të cilët e vënë në dukje faktin se struktura eksportuese përbëhet nga produkte më të sofistikuara në krahasim me vendet e tjera me të ardhura mesatare në Evropë, e që e pozicionon vendin në vendin e dytë me pjesëmarrje prej 55% në vitin 2014, pas Rumanisë (56%).

Në bazë të këtyre indikatorëve, ia vlen të shqyrtohen edhe dy indikatorë kompleks:

- **Kualiteti i eksportit të industrisë: mesatarja e dy nën-indikatorëve si vijojnë<sup>1</sup>:**
  - Pjesëmarrja e eksporteve të prodhuara të mesme dhe të teknologjisë së lartë në eksportin e përgjithshëm të prodhimtarisë (ETMLpj), e cila e vë në dukje rëndësinë e kompleksitetit teknologjik të eksportit;
  - Pjesëmarrja e eksportit të prodhuar në eksportin e përgjithshëm (EPpj), e cila e vë në dukje rëndësinë e prodhimtarisë në aktivitetin eksportues.
- **Intensiteti i industrializimit (INDint): mesatarja e dy nën-indikatorëve në vijim<sup>2</sup>:**
  - Pjesëmarrja e vlerës së shtuar mesatare dhe teknologjisë së lartë në vlerën e shtuar të përgjithshme të prodhimit, e cila e vë në dukje kompleksitetin teknologjik të prodhimtarisë;
  - Pjesëmarrja e VSHP në BPV (VSHPPj), e cila e vë në dukje rëndësinë e prodhimtarisë në ekonomi.

Në kundërshtim me indeksin paraprak, edhe përkrah përmirësimeve gjatë periudhës së monitoruar, indeksi i intensitetit të industrializimit të vendit (0,25 në vitin 2014) ka qenë ndër më të ulët në grupin e vendeve me të ardhura mesatare, ndërsa pak më i lartë prej atij të Moldavisë. Duke e pasur parasysh fokusin e tij mbi konkurrencën industriale dhe variablastruorore ekonomike, indeksi i performancave konkurrense industriale (CIP) i ranson vendet të cilat kanë tendencë të jenë relativisht stabile në periudha të shkurtra kohore. Shkaku për këtë, konsiston me atë se proceset e mësimit teknologjik janë kumulative dhe nevojitet kohë që të zhvillohen. Si rezultat i kësaj, vlera e CIP për Maqedoninë është përmirësuar vetëm

<sup>1</sup>Indikator i kualitetit të eksportit synon ta pasqyroj atë që e raportojnë vendet, por jo edhe atë se në ç'mënyrë dhe deri në cilën shkallë kontribuojnë ato në prodhimin e mallit të eksportuar. Mungesa e klasifikimit teknologjik të përcaktuar në mënyrë adekuate sa i përket mallrave të caktuara e përkeqëson këtë problem.

<sup>2</sup>Krijimi i këtij indikator kompleks korrespondon me nevojën që të pasqyrohet kontributi i industrisë përpunuese në prodhimin e përgjithshëm, si dhe kompleksiteti teknologjik të industrive prodhuese. Megjithatë, ky indikator kompleks nuk i përfshin çdoherë dallimet e rëndësishme teknologjike të çdo kategorie teknologjike.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

për 0,01 gjatë periudhës të deritanishme dhjetëvjeçare. Edhe krahas këtij përmirësimi të vogël, rankimi i përgjithshëm i CIP për Maqedoninë shënoi rënie për 9 pozita (nga 81 deri në 92) në periudhën e njëjtë.

Prodhimtaria akoma është përfituesi më i madh i progresit teknologjik në ekonomi. Në lidhje me këtë, në periudhën e njëjtë, pjesëmarrja e prodhimit mesatar dhe të teknologjisë së lartë në eksportin e përgjithshëm të prodhimitarisë së vendit shënoi rritje prej 20% në 55%.

Në krahasim me vendet e tjera evropiane, të cilat bëjnë pjesë në grupin e vendeve evropiane me të ardhura mesatare, Maqedonia ka CIP pozicion më të mirë vetëm prej dy vendeve, përkatësisht nga Moldavia dhe Bosnja e Hercegovina, por pozicion mjaft më të ulët nga vendet siç është Turqia. Për shkak të numrit të vogël të popullsisë, eksporti i industrisë përpunuese për kokë banori është në masë të konsiderueshme më i lartë sesa në shumë vende të tjera evropiane, megjithatë, kjo nuk ndodh edhe me vlerën e shtuar prodhuese për kokë banori. Vendi është i dyti (pas Rumanisë) në grupin e vendeve me të ardhura mesatare, me pjesëmarrje eksporteve të prodhuara të mesme dhe të teknologjisë së lartë në eksportin e përgjithshëm (55%). Si rezultat i kësaj, pjesëmarrja e aktiviteteve të mesme dhe të teknologjisë së lartë në eksportin e prodhimitarisë është 0,59. Nga ana tjetër, Maqedonia është vendi me pjesëmarrje më të madhe të eksportit të prodhimitarisë (92%), dhe merr pjesë në eksportin e prodhimit në indeksin e përgjithshëm të eksportit prej 0,94 në mesin e vendeve të selektuara.




Në krahasim me vendet e tjera të Tabelës A6, Maqedonia ka indeks më të lartë për kualitetin e eksportit industrial (0,77), por pjesëmarrje më të ulët në VSHP në indeksin e BPV (0,32). Të gjithë këta indikatorë e vënë në dukje faktin se ajo ka performansa shumë më të mira për eksportin e prodhimitarisë sesa performancat e vlerës së shtuar. Përveç kësaj, në rastet kur diagnostifikohet dallim i madh midis kapacitetit industrial të vendit dhe kapacitetit eksportues prodhues të saj në dobi të kësaj të dytës, mund të kërkohet hulumtim në lidhje me atë se si mund të fitohet vlerë e shtuar më e lartë në vend. Në rastet kur indikatorët e lartpërmendur tregojnë se kapaciteti eksportues, në masë të madhe, e tejkalon kapacitetin prodhues, kjo mund ta vë në dukje vlerën e shtuar të ulët në nivel lokal në aktivitetet prodhuese, për shembull, meqë industria e vendit kryesisht është angazhuar në veprimtaritë e montimit/formimit. Nga këndvështrimi politik, kjo mund të kërkojë intervenim nga politika industriale, e cila e stimulon industrializimin dhe prodhimin e produkteve të mesmedhe të teknologjisë së lartë, të cilat e rrisin pjesëmarrjen e prodhimeve të sofistikuara me vlerë të shtuar.

### 3.5 Ndërmarrjet dhe industria përpunuese

Është po ashtu e rëndësishme të shqyrtohet struktura e ndërmarrjeve prodhuese në vend.

Tabela A9 e Aneksit i prezanton tendencat e fundit lidhur me ndërmarrjet, të punësuarit dhe xhiron. Vërehet tendencë në rritje në industrinë përpunuese në të gjithë indikatorët e shqyrtuar, me përjashtim të numrit të ndërmarrjeve të cilat janë zvogëluar gjatë viteve 2013 dhe 2014. Marrë në përgjithësi, numri i ndërmarrjeve prodhuese, numri i të punësuarve dhe xhironja shënon rritje, siç është prezantuar në Diagramin në vijim.

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese



Megjithatë, diagrami i radhës e vë në dukje faktin se ndërmarrjet prodhuese janë zhvendosur për nga madhësia. Rreth 80% janë mikro-ndërmarrje, 13% janë të vogla, 4% të mesme dhe më pak se 1% të mëdha. Kjo e vë në dukje se theksi i politikës veçanërisht duhet të fokusohet mbi kategoritë e vogla dhe të mesme, në përputhje me qasjen ededikimit të mjeteve të kufizuara shtetërore dhe kapaciteteve.




Tabela A9 e Aneksit vë në dukje se prodhimi i produkteve ushqimore, bashkë me prodhimin e produkteve prej metali dhe prodhimin e rrobave, janë nën-sektorë me numër të konsiderueshëm të të punësuarve, me ndërmarrje dhe xhiro në vitin 2015. Industria

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

ushqimore ka numër më të madh të ndërmarrjeve dhe xhiro në vitin 2015, ndërsa prodhimi i rrobave është nën-sektor me numër më të madh të punësuarve.

Tabela A10 eAneksit e pasqyron gjendjen në raport me tregtinë e jashtme. Prodhimi i Pijeve dhe Duhanit ishin dy sektorët e vetëm në vitin 2014-2015me numër më të madh të ndërmarrjeve të angazhuara në eksport sesa në import. Megjithatë, Prodhimtaria e prodhimeve të tjera jometale minerale, prodhimtaria e mjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove dhe prodhimtaria e rrobave janë sektorë me eksport më të lartë në periudhën e njëjtë dhe eksport më të lartë se importi.

Tabela e fundit (A11 e Aneksit) fokusohet mbi vëllimin e importitdhe eksportit. Duhet të theksohet se rrobat, sektori i metaleve bazë, industria e makinerisë dhe pajisjeve dhe prodhimet kimike janë nën-sektorë të industrisë përpunuese me eksport të konsiderueshëm gjatë periudhës kohore të monitoruar. Përjashtim bën sektori i metaleve bazë, i cili më shumë importon sesa që eksporton.

### 3.6Analiza SWOT: industria përpunuese

Në bazë të analizës paraprake, në Tabelën në vijim është prezantuar pasqyrë e sintetizuar e përparësive, dobësive, mundësive dhe kanosjeve, të cilat për momentin janë të pranishme në Republikën e Maqedonisë sa i përket industrisë në përgjithësi dhe konkretisht prodhimitarisë.

Të konkludojmë, analiza e prezantuar në këtë kapitull u fokusua mbi industrinë përpunuese si orientimi kryesor i strategjisë së ardhshme industriale.Këtu u dha një pasqyrë e tendencave globale dhe problemeve në industrinë përpunuese, si dhe të rolit që duhet ta luaj KET. Ajo e prezantoi perspektivën rajonale të Ballkanit Perëndimor sa u përket çështjeve industriale, si dhe kërcënimit nga de-industrializimi i vazhdueshëm, njëkohësisht duke i identifikuar tendencat pozitive të cilat i përjetoj vendi për sa i përket IHD në industrinë përpunuese. Në këtë Kapitull u prezantua analiza e statistikave të aksesshme nacionale, siç është bruto prodhimi, eksporti, IHD, vlera e shtuar, produktiviteti etj. me një analizë nën-sektoriale të industrisë përpunuese duke përfunduar me pozitën e vendit sa i përket krahasimeve ndërkombëtare dhe strukturës prodhuese të ndërmarrjeve. Në fund është prezantuar analiza SWOT në bazë të analizës paraprake. Në këtë mënyrë hapet rruga për kapitullin kryesor, i cili fokusohet mbi vizionin, qëllimet strategjike dhe traqet, duke i përfshirë edhe masat që do të zbatohen në të ardhmen.

**Tabela 2: Industria përpunuese: Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kanosjet**

| Përparësitë   | Dobësitë   |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Tradita dhe njohuritë në fushën e prodhimitarisë</li><li>• Traditë e fuqishme në sektorin e ushqimit, sektorin e tekstilit, sektorin e kimikateve dhe metaleve</li><li>• Fleksibiliteti i prodhimitarisë, seri me masë dhe seri të vogla</li><li>• Cilësi e mirë e prodhimeve dhe shërbimeve në raport me çmimin</li><li>• Përmirësimi i mjedisit afarist (Duing biznes i BB)</li><li>• Regjimi tatimor i favorshëm për ndërmarrjet</li><li>• Marrëveshja e stabilizimasocim me BE dhe statusi i vendit kandidat për anëtarësim në BE</li></ul> | <ul style="list-style-type: none"><li>• Aktualisht çmimi është promotori kryesor i konkurrencës</li><li>• Varësia e eksportit nga lëndët e para dhe çmimet e ndryshueshme</li><li>• Varësia shumë e madhe prej 7 produkteve eksportuese (67%)</li><li>• Pjesëmarrje e lartë e prodhimeve bazike dhe me teknologji të ulët</li><li>• Teknologji të vjetruara në procesin e prodhimit</li><li>• Shpenzime relativisht të ulëta për hulumtime publike dhe private dhe zhvillim (H&amp;ZH)</li></ul> |

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

|   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Anëtare e Organizatës Tregtare Botërore</li> <li>• Marrëveshja për tregti të lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) dhe Marrëveshje të tjera për tregti të lirë</li> <li>• Pozitë e përshtatshme gjeografike/afërsia me BE</li> <li>• Lidhje e mirë e transportit rrugor(E75)</li> <li>• Dekada e marketingut intensiv për IHD</li> <li>• Tetë ZZHTI aktive dhe disa në plan</li> <li>• Standard i mirë i arsimit dhe edukatës teknike</li> <li>• Akses i mbështetjes financiare nga BE/donatorë të industrisë</li> <li>• Paketë atraktive dhe mirë e financuar për ndihmë shtetërore</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësi pamjaftueshëm të zhvilluara për H&amp;ZH dhe inovacione</li> <li>• Lidhje të pamjaftueshme ndërmjet industrisë / IHD dhe NVM / sektorëve të tjerë të ekonomisë</li> <li>• Lidhje të pamjaftueshme ndërmjet NVM / sektorëve industrial dhe institucioneve shkencore-hulumtuese</li> <li>• Një numër i madh i NVM me kapacitet të ulët absorbues për pranimin e inovacioneve dhe transferimin e teknologjisë</li> <li>• Fokusi i inovacioneve është mbi zgjerimin e produkteve dhe shërbimeve në vend të rritjes së cilësisë ose pjesëmarrjes në treg</li> <li>• Zhvillim i kufizuar i klasterëve dhe zinxhirit të vlerave</li> <li>• Nivel i ulët i angazhimit në prodhimin e gjelbër</li> <li>• Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore pamjaftueshëm e zhvilluar</li> <li>• Instrumente financiare shumë pak të specializuara / kapital i rrezikshëm</li> <li>• Sistem arsimor relativisht i dobët</li> </ul>  |
| <b>Mundësitë</b>  | <b>Kanosjet</b>  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i vendit dhe prurje relativisht të larta të IHD</li> <li>• Pozicionimi ndërkombëtar në sektorët e prodhimit</li> <li>• Rrjeti në rritje dhe mirë i vendosur i ZZHTI</li> <li>• Rrjeti i këshilltarëve ekonomikë në shumë vende</li> <li>• Integrimi në BE dhe shfrytëzimi i instrumenteve para-aderuese për zhvillim industrial (për shembull, Horizont 2020, IPA)</li> <li>• Programe dhe stimulime të reja të orientuara industriale</li> <li>• Zhvillimi i nën-sektorëve të mesëm dhe të teknologjisë së lartë / prodhime / shërbime me vlerë të shtuar të lartë</li> <li>• Mundësi për mbështetjen e eksportit / internacionalizimi</li> <li>• Mundësi për fokusimin e prodhimeve me vlerë të shtuar të lartë</li> <li>• Mundësi për zhvillimin e partneriteteve publike-private</li> <li>• Mundësi për shfrytëzim më të mirë të të drejtave nga pronësia intelektuale</li> <li>• Mundësi për përfshirjen e teknologjive të reja prodhuese</li> <li>• Mundësi për zhvillimin e mundësive financiare për qasje deri te kapitali për sektorët e mesëm dhe të teknologjisë së lartë</li> <li>• Mundësi për angazhimin në industrinë prodhuese / prodhimtari</li> <li>• Mundësi për zhvillimin e zinxhirit të vlerave / klasterëve / akceleratorëve</li> <li>• Kapaciteti i rritur institucional për mbështetjen e H&amp;ZH, inovacioneve dhe transferimit të teknologjive</li> <li>• Zbatim i rritur i normave dhe standardeve të BE</li> <li>• Diaspora e gjerë, shumica e tyre me lidhje me vendin</li> <li>• Përparesi të klimës dhe tokës</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjedis politik relativisht i jostabil</li> <li>• Proces i ngadalshëm i inkuadrimin në BE/NATO</li> <li>• Proces i ngadalshëm i reformës strukturore</li> <li>• Harmonizim i ngadalshëm i sistemit arsimor me tregun e punës</li> <li>• Kapaciteti i ulët administrativ për absorbimin e fondeve të BE</li> <li>• Nivel i ulët i investimeve publike dhe private në H&amp;ZH, në inovacione dhe prodhimtari</li> <li>• Mospasje lidhje midis sistemit arsimor / sistemit për arsim profesional dhe trajnim dhe nevojave të tregut</li> <li>• Migrim i vazhdueshëm i fuqisë punëtore të kualifikuar</li> <li>• Koordinim i ulët i politikave, strategjive, fondeve etj.</li> <li>• Ndryshime të shpeshta në legjisllacion dhe sistemin tatimor</li> <li>• Vendet fqinje me shpenzime më të ulëta për fuqinë e punës paraqesin kërcënim për sektorin e tekstit dhe për nën-sektorët e tjerë prodhues</li> <li>• Mungesë e mbështetjes të NVM / industrisë / eksportit plot një dekadë</li> </ul> |



### 4. Strategjia industriale

Analiza paraprake e pasqyroj gjendjen në lidhje me politikën industriale dhe shkaqet se pse fokusi i Strategjisë është vendosur në mbështetjen e industrisë përpunuese. Ekzistojnë shkaqe të fuqishme për këtë politikë, ndërsa kapitulli paraprak përfundoi me analizën SWOT të industrisë përpunuese. Ky Kapitull e shpie Strategjinë në një nivel më të lartë. Aty përcaktohet vizioni i përgjithshëm, traqetet që duhet të arrihen në lidhje me vizionin, pesë qëllimet kryesore të Strategjisë, si dhe qëllimi strategjik ndër-sektorial. Fokusi është vënë mbi përcaktimin e masave të cilat do të jenë objekt i fokusit gjatë implementimit, si dhe arsyetimi për vënien në fokus të atyre masave. Leksionet e politikës paraprake industriale e përfshijnë faktin se vendi ka mjete të kufizuara shtetërore për mbështetjen e Strategjisë, ka kapacitete të kufizuara institucionale dhe kapacitete të tjera dhe së këtijmi qëllimi duhet konsistojë me arrijten e numrit të përcaktuar të masave të realizueshme në kuadër të secilit prej qëllimeve strategjike. Marrë në përgjithësi, Strategjia identifikon targete, pesë qëllime strategjike dhe 38 masa, si dhe qëllimin strategjik ndër-sektorial me 6 masa shtesë. Të gjitha masat që duhet të implementohen brenda periudhës kohore 2008-2020 janë përcaktuar në Planin e veprimit relevant, i cili është prezantuar në Aneksin B dhe i përfshin afatet, përgjegjësitë, indikatorët kryesorë të suksesit dhe ngjashëm. Në kapitullin e fundit të Strategjisë janë prezantuar rregullimet sa i përket zbatimit, siç janë mekanizmat për koordinim, dialog, financim, monitorim, raportim dhe evaluim.

#### 4.1 Vizioni

“Avancimi i **industrializimit** përmes stimulimit të rritjes dhe zhvillimit të **industrisë përpunuese** me qëllim të rritjes së produktivitetit, krijimit të **vendeve të reja të punës, rritjes së të ardhurave** dhe përforcimit të **kapitalit njerëzor**, njëkohësisht duke i zgjidhur sfidat e **Ekonomisë cirkulare**.”

#### 4.2 Qëllime strategjike

---

Vizioni duhet të arrihet përmes vënies në fokus të pesë qëllimeve Strategjike, duke e përfshirë edhe qëllimin ndër-sektorial i cili mbulon çështje horizontale siç është: koordinimi, konsultimet, raportimi, monitorimi dhe evaluimi, e që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për implementimin efektiv.

#### 4.3 Targete

---

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese



Tragetet janë baza e monitorimit dhe evaluimit të ardhshëm (M&E) të ndikimit të Strategjisë. Në mënyrë që targetet të jenë të rëndësishëm, ato duhet të harmonizohen me vizionin dhe qëllimet strategjike. Ato, në mënyrë ideale, do të duhej të jenë “SMART” (përkatesisht konkret, të matshëm, aktivë, real dhe me përcaktim kohor). Aspekti konkret ka të bëjë me ndërlidhjen midis vizionit të vendosur në nivel të lartë dhe qëllimeve strategjike, ndërsa masat / aktivitetet janë ato që janë të nevojshme për arritjen e tyre. Masat e matshme dhe aktive kanë të bëjnë me parametrat konkret me qëllim rezultati i dëshiruar duhet të ketë përmbledhje të matjeve të përcaktuara. Matjet kanë për qëllim t'i vlerësojnë përmirësimet në industri dhe në industrinë përpunuese, si dhe mund të kuantifikohen sa i përket gjendjes themelore në fillim dhe në fund të Strategjisë. Nga ana tjetër, ato duhet të jenë reale; edhe pse zakonisht shtetet dëshirojnë të vendosin sfida, kjo gjë duhet të balancohet me atë që është e mundur për tu arritur, përndryshe implementuesit mund të heqin dorë. Dhe, në fund, çdo target e kërkon afatin e fundit kohor në mënyrë që fokusi të jetë mbi implementimin.

Arritja ose mosarritja e vizionit të Strategjisë duhet të vlerësohet në raport me targetet e përgjithshëm dhe targetet konkret të prezantuar në vijim.

### Tatgetet e përgjithshëm:

| Indikatori  | Baza                                 | Targeti për vit. 2027 |
|---|--------------------------------------|-----------------------|
| 1. Prodhim i rritur si % e BPV                        | 12,2% në 2016                        | 14%                   |
| 2. Konkurrencë e rritur industriale KRRI <sup>3</sup> | Rank 56; Shkalla 4,39; në 2015       | Rank 50               |
| 3. Indeksi global i konkurrencës <sup>4</sup>         | Rank 81/144 Rezultati 0,026; në 2016 | Rank 73               |
| 4. Vlera e rritur e prodhimit                         | 4.452 mil. euro në 2015              | 10,000 mil. euro      |
| 5. Eksport i rritur i mallrave të përpunuar           | 4mil. euro eksport në 2017           | 84.000 mil. euro      |
| 6. Rritja e vlerës së shtuar të prodhimit (VSHP)      | 1.067 mil. euro në 2015              | 2.000 mil. euro       |

<sup>3</sup>Rankimi sipas Indeksit global të konkurrencës 2016-2017

<sup>4</sup>[http://www3.weforum.org/docs/GCR2016-2017/05FullReport/TheGlobalCompetitivenessReport2016-2017\\_FINAL.pdf](http://www3.weforum.org/docs/GCR2016-2017/05FullReport/TheGlobalCompetitivenessReport2016-2017_FINAL.pdf)

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

### Targete të qëllimeve strategjike:

#### 1. Fuqizimi i themeleve të industrisë përpunuese:

| Indikatori  | Baza                     | Targeti për vit. 2027 |
|---|--------------------------|-----------------------|
| 1.1 Numër i rritur i ndërmarrjeve në industrinë përpunuese            | 7. 967 në 2016           | 9.000                 |
| 1.2 Numër i rritur i të punësuarve në industrinë përpunuese           | 137.615 në 2016          | 155.000               |
| 1.3 Xhiro e rritur në industrinë përpunuese                           | 4.738 mil. euro në2016   | 8.000 mil. euro       |
| 1.4 Përqindje % e rritur e industrisë përpunueseVSHP në totalin e BPV | 12.2% në 2016            | 14%                   |
| 1.5 IHD në industrinë përpunuese <sup>5</sup>                         | 1.685,6mil. euro në 2016 | 3.000 mil. euro       |

#### 2. Rritja e produktivitetit, inovacioneve dhe transferimit të teknologjive në industrinë përpunuese:

| Indikatori   | Baza                            | Targeti për vit. 2027 |
|--|---------------------------------|-----------------------|
| 2.1 Produktivitet i rritur në industrinë përpunuese për një të punësuar  | 8.620 euro në 2016              | 12.000 euro           |
| 2.2Indeksi global i inovacioneve <sup>6</sup>  | Vlera 35.4; Rank 61/127         | Rank55                |
| 2.3 Tabela evropiane e inovacioneve <sup>7</sup><br>Pasqyrë e shkurtër e indeksit të inovacioneve – MK në raport me BE | 44,2 në 2016                    | Rank60                |
| 2.4 Nivel i fuqishëm për absorbim teknologjikWEF <sup>8</sup>  | Vlera 4.2; rank 105/139 në 2016 | Rank95                |
| 2.5 Rritja e DVP së mesme dhe Teknologjisë së lartë në vlerën e shtuar të përgjithshme <sup>9</sup>                    | 0.15 në 2015                    | 0.25                  |

#### 3. Katalizimi i industrisë së gjelbër dhe prodhimit të gjelbër:

| Indikatori  | Baza  | Targeti për vit. 2027  |
|---|---|--|
| 3.1 Legjislacioni i gjelbër   | Nuk ka legjislacion të gjelbër të harmonizuar me atë të BE                                  | Legjislacioni i gjelbër plotësisht i harmonizuar me BE   |
| 3.2 Sistemi i monitorimit për ndotjen industriale                                       | Nuk ka sistem monitorimi për ndotje   | Sistem monitorimi i vendosur dhe funksional për ndotjen industriale  |
| 3.3 Regjistri i ndërmarrjeve me ISO sisteme të inkorporuara                             | Nuk ka evidencë për ISO sisteme të inkorporuara   | Regjistër i vendosur dhe funksional i ndërmarrjeve me eko-sisteme të inkorporuara si 50501, 14001, 14064, 14069, 14044 e të tjera.       |
| 3.4 Numri i ndërmarrjeve me leje për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes | Nuk ka ndërmarrje me leje për parandalim të integruar dhe kontroll mbi ndotjen              | Leje të lëshuara për parandalimin e integruar dhe kontrollin e ndotjes nga të gjitha ndërmarrjet prodhuese të mëdha dhe të mesme në vend |
| 3.5 Zona të gjelbra industriale (ZGJI)<br>Zona të lehta prodhuese (ZLP)                 | Nuk ka zona të gjelbra industriale në vitin 2018<br>3 Zona të lehta prodhuese në vitin 2018 | ZGJI – 5<br>ZLP - 10   |

<sup>5</sup> Investime direkte në R. të Maqedonisë – sipas veprimtarive, 31 dhjetor 2016 r. - BPRM

<sup>6</sup> <https://www.globalinnovationindex.org/gii-2017-report#>

<sup>7</sup> [https://www.rvo.nl/sites/default/files/2017/06/European\\_Innovation\\_Scoreboard\\_2017.pdf](https://www.rvo.nl/sites/default/files/2017/06/European_Innovation_Scoreboard_2017.pdf)

<sup>8</sup> [http://www3.weforum.org/docs/GITR2016/WEF\\_GITR\\_Full\\_Report.pdf](http://www3.weforum.org/docs/GITR2016/WEF_GITR_Full_Report.pdf) - page 131

<sup>9</sup> <http://stat.unido.org/database/CIP%202017>

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

### 4. Stimulimi i eksportit të prodhimit:

| Indikatori   | Baza  | Targeti për vit. 2027 |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
|--|---|-----------------------|--------|----------------------------|--------|---|----------------|-----|----------------------------|-----|
| 4.1 Vlera e rritur e eksportit të përgjithshëm të prodhimit  | 4.472 mil. euro në 2017   | 8.000 mil. euro       |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
| 4.2 Përqindje % e rritur e eksportit të prodhimit në eksportin e përgjithshëm                      | 89,3% në 2017   | 92%                   |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
| 4.3 Prodhimi mesatar dhe i Teknologjisë së lartë   | 0.59 në 2015  | 0.65                  |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
| 4.4 Strukturë e përmirësuar e eksportit sipas kategorive gjithëpërfshirëse ekonomike <sup>10</sup> | <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%;">Repromateriale</td> <td style="width: 50%;">58,50%</td> </tr> <tr> <td>Mallra për konsum të gjerë</td> <td>26,80%</td> </tr> </table> | Repromateriale        | 58,50% | Mallra për konsum të gjerë | 26,80% | <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%;">Repromateriale</td> <td style="width: 50%;">30%</td> </tr> <tr> <td>Mallra për konsum të gjerë</td> <td>50%</td> </tr> </table> | Repromateriale | 30% | Mallra për konsum të gjerë | 50% |
| Repromateriale   | 58,50%  |                       |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
| Mallra për konsum të gjerë   | 26,80%  |                       |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
| Repromateriale   | 30%   |                       |        |                            |        |   |                |     |                            |     |
| Mallra për konsum të gjerë   | 50%   |                       |        |                            |        |   |                |     |                            |     |

### 5. Ndërtimi i industrisë përpunuese në të cilën mësohet:

| Indikatori   | Baza                  | Targeti për vit. 2027 |
|--|-----------------------|-----------------------|
| 5.1 Bruto paga mesatare për një të punësuar në industrinë përpunuese       | 489 euro Dhjetor/2017 | 750 euro              |
| 5.2 Bruto shpenzimi vendor për H&ZH(GERD) <sup>11</sup> si përqindje e BPV | 0.4% në 2015          | 3%                    |
| 5.3 Shpenzim i ndërmarrjeve për H&ZH- Business Expenditure on R&D (BERD)   | 9.8 mil. euro në 2016 | 25 mil. euro          |

Siç u shqyrtua paraprakisht në Pjesën 2.2., ekzistojnë dokumente të ndryshme strategjike të cilët e mbulojnë politikën industriale në një ose në mënyrë tjetër (për shembull, për konkurrencë, inovacione, NVM etj.), por asnjëri nuk fokusohet mbi industrinë përpunuese, përveç këtij dokumenti. Së këtejmi, në mënyrë që kjo Strategji të arrij sukses më të madh në krahasim me strategjinë paraprake duhet të jetë reale sa i përket implementimit në kuadër të kapaciteteve ekzistuese institucionale dhe kapaciteteve të tjera, si dhe sa u përket mjeteve të arritshme. Si përfundim, kjo Strategji nuk filloi me një letër të bardhë bosh; masat e prezantuara në vijim janë udhëhequr nga faktorë të ndryshëm, duke e përfshirë edhe kornizën gjithëpërfshirëse të politikave të Qeverisë (veçanërisht Planin për rritje ekonomike), strategjitë rrjedhëse (për shembull, për konkurrencë, inovacione dhe ngjashëm), aktivitetet rrjedhëse dhe të planifikuara të Ministrisë së Ekonomisë (Programi për konkurrencë i cili e përfshinë industrinë, NVM dhe klasterët), programet për financim të BE etj. Së këtejmi, theksi nuk është vënë thjeshtë për vendosjen e politikave të reja dhe spektrit të masave për mbështetjen e industrisë përpunuese, por, gjithashtu, edhe për “stimulimin” e programeve rrjedhëse dhe të aktiviteteve të tjera që të janë në shërbim sa më të mirë të zhvillimit dhe rritjes të asaj që është identifikuar si sektor më i rëndësishëm në ekonomi sa i përket prosperitetit ekonomik të ardhshëm, përkatësisht industrisë përpunuese.

## Qëllimi strategjik 1 –Fuqizimi i themeleve të industrisë përpunuese

<sup>10</sup><http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFSG2016/13-NadvorTrg-ForeignTrade.pdf>

<sup>11</sup> <http://uis.unesco.org/en/country/mk?theme=science-technology-and-innovation>

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Tanimë ekziston bazë e mirë për mbështetjen e industrisë përpunuese në vend, ndërkaq është arritur sukses edhe në tërheqjen e IHD ngafusha e prodhimitarisë, si dhe në zhvillimin e zonave industriale. Megjithatë, ekziston nevoja e fuqizimit të bazës ekzistuese prodhuese, njëkohësisht duke zhvilluar drejtime të reja, siç është zhvillimi i zinxhirit të vlerave. Ekzistojnë tetë mënyra kryesore me të cilat industria përpunuese mund të zhvillohet dhe mbështetet në fazën e ardhshme të implementimit, me fjalë të tjera: përcaktimi i nën-sektorit prodhues me potencial më të madh targetimi (specializim i zgjuar), maksimizimi i ndikimit mbi Planin për rritje ekonomike përmes monitorimit dhe evaluimit, zhvillimit të fokusit më konsistent të industrisë përpunuese përmes promovimit të IHD, stimulimit të investimeve vendase dhe të huaja direkte, zhvillimit të mëtutjeshëm të rrjetit të Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale (ZZHTI), fuqizimit të klasterëve prodhues, vendosja e zinxhirëve të vlerave në industrinë përpunuese dhe krijimit të bazës për financimin e kapitalit të rrezikshëm / mezanin financim. Ekzistojnë mekanizma përkatës të cilët ndërliohen me ato, siç janë biznes inkubatorët, akceleratorët etj, të cilët zhvillohen përmes iniciativave të tjera, siç janë strategjitë për NVM dhe inovacione.

### **Masa 1.1: Identifikimi dhe targetimi i mbështetjes së nën-sektorëve prioritar në industrinë përpunuese, përmes specializimit të zgjuar.**

**Arsyetimi:** kjo Strategji është fokusuar mbi industrinë përpunuese. Megjithatë, me kalimin e kohës, është me rëndësi të zhvillohet targetim më i detajuar i aktiviteteve në mënyrë që fokusi të vendoset mbi sektorët dhe aktivitetet me vlerë të shtuar më të lartë, që t'i mundësohet vendit të avancohet me mundësitë e vetme dhe përparësitë komparative të cilat ekzistojnë në vend. Prezenca e këtyre sektorëve dhe aktiviteteve është ajo që mund të siguroj rritje të produktivitetit dhe të ndërtoj konkurrencë të jashtme, duke e pasur parasysh faktin se këto aktivitete edhe pse janë në industrinë përpunuese ato, megjithatë, mund të përmbajnë karakteristika të shërbimeve, siç është TIK. Shteti është në një proces të zhvillimit të strategjive nacionale për specializime të zgjuara. Në këtë kontekst, ekziston nevojë imanente për identifikimin e nën-sektorëve në industrinë përpunuese të cilët ofrojnë mundësi më të mëdha dhe potencial në rritje për gjenerimin e pozitave, përfitimeve nga produktiviteti, potencial eksportues etj. Kjo do t'u mundësoj fondeve dhe kapaciteteve në të ardhmen të fokusohen më mirë, në bazë të parimit të specializimit të zgjuar (shih: Pjesën 2.1.1 më lartë). Kjo masë përfshinë analiza kuantitative (anketa, statistika nacionale dhe ndërkombëtare) dhe kualitative (për shembull: fokus grupe me ndërmarrje relevante dhe shoqata afariste), si dhe konsulta me palët e interesuara nga sektori i biznesit në mënyrë që të identifikohen nën-sektorët në industrinë përpunuese të cilët duhet të promovohen, si dhe të orientohen aktivitetet e ardhshme të politikës, përfshirë këtu edhe shpërndarjen e mbështetjes dhe resurseve në nivel të nën-sektorëve.

### **Masa 1.2: Maksimizimi i kapacitetit të Planit për rritje ekonomike (PRRE) në mënyrë që të jetë efektiv.**

**Arsyetimi:** siç është sqaruar në detaje në Pjesën 2.3, Plani i ri për rritje ekonomike (PRRE) do të ketë buxhet vjetor prej 30 milionë euro (150 milionë euro për pesë vjet) dhe paraqet kornizë gjithëpërfshirëse për politikën e ardhshme të konkurrencës, me fokus mbi industrinë / përpunuese / prodhimin. Programi përbëhet nga dy tipa kryesorë të iniciativave. Së pari, programe për të gjitha ndërmarrjet:

- Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës (iniciativë për tregun e punës e përfshirë në Strategjinë për punësim)
- Vendosje të avancimit të bashkëpunimit me furnizuesit maqedonas (Masa 2.4);
- Themelimi i seksioneve për zhvillim teknologjik dhe hulumtim (Masa 5.2);
- Projekte investuese me interes të konsiderueshëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë (Masa 1.4);
- Rritja e investimeve kapitale dhe të ardhurave (Masa 1.4);
- Identifikimi i kompanive të cilat ballafaqohen me vështirësi (Masa 1.4);
- Kompani të cilat e rrisin konkurrencën e tyre në tregjet e reja (Masa 4.4);
- Përvetësimi i tregjeve të reja dhe rritja e shitjes (Masa 4.3);

Së dyti, programe për NVM, pavarësisht sektorit, por me orientim teknologjik, që në praktikë nënkupton se pjesa më e madhe e investimeve do të fokusohen mbi industrinë përpunuese:

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

- NVM me zhvillim të shpejtë (“Gazela”) (Masa 2.3);
- Mbështetje financiare shtesë për mikro-ndërmarrjet (Masa 5.7);
- Përmirësim i inovacioneve tek NVM (Masa 2.2);
- Avancim profesional dhe praktikë për personat e rinj të sapo punësuar (Masa 5.3);
- Përgatitja e bazave ligjore për zhvillimin e kapitalit të rrezikshëm (Masa 1.8).

Si pjesë e PRRE, u miratua Ligji për mbështetjen e investimeve. Iniciativat individuale që i përmban PRRE janë plotësisht të inkuorporuara dhe integruara në qëllimet e ndryshme strategjike të këtij dokumenti (shih më lartë për referencë deri në masën përkatëse). Duke e pasur parasysh rëndësinë e PRRE dhe shumën e mjeteve shtetërore dhe mjeteve të tjera financiare, me rëndësi të veçantë do të jetë monitorimi i rregullt dhe evaluimi i implementimit në mënyrë që të sigurohet efikasitet maksimal dhe ndikim.

### **Masa 1.3: Fokusi i politikës së Investimeve të huaja direkte (IHD) në industrinë përpunuese.**

**Arsyetimi:** gjatë dekadës së fundit, në mënyrë sistematike vendi u promovua përmes përpjekjeve të konsiderueshme të dedikuara për tërheqjen e IHD. Analiza paraprake vë në dukje se Republika e Maqedonisë është shpërblyer me nivel relativisht të lartë të prurjeve nga IHD, përfshirë këtu edhe në industrinë përpunuese, prej të cilave një pjesë e madhe u investuan në Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale (ZZHTI – shih Masën 1.5 në vijim), si dhe në lokacionet blaunfild, duke i përfshirë, mes tjerash, edhe nën-sektorët e industrisë automobilistike, tekstilit dhe rrobave. Dobësia kryesore e përpjekjeve për IHD konsiston me atë se kishte pjesëmarrës të ndryshëm në IHD, mangësi të koordinimit efikas dhe mangësi të fokusit eksplicit mbi industrinë përpunuese, edhe pse realisht një pjesë bukur e madhe e përpjekjeve u fokusuan mbi këtë sektor si tërësi. Kjo masë është dizajnuar në mënyrë që të siguroj se përpjekjet e ardhshme për IHD në mënyrë eksplicite do të fokusohen mbi industrinë përpunuese duke i përfshirë edhe nën-sektorët që duhet të identifikohen me Masën 1.1 më lartë (strategji nacionale për specializim të zgjuar), veçanërisht për grinfild lokacionet në ZZHTI, me qëllim që në mënyrë më precize t'i fokusoj dhe koordinoj aktivitetet për IHD, si dhe fokusi të vendoset mbi vizionin për rritjen e nivelit të kontributit në industrinë përpunuese me fokus mbi vlerën e shtuar të rritur, H&ZH dhe investimet e gjelbra që do të kontribuojnë për produktivitetin dhe rrjedhjet pozitive në ekonomi. Targetimi i rritur i industrisë përpunuese do të kombinohet me transparencë dhe efikasitet më të madh gjatë shpërndarjes dhe koordinimit të ndihmës shtetërore për IHD përmes krijimit të trupit të vetëm për administrim.

### **Masa 1.4: Stimulimi i investimeve (masa nga PRRE 1.4, 1.5 dhe 1.6).**

**Arsyetim:** Në të kaluarën vendi fuqimisht u fokusua mbi investimet e huaja direkte (IHD), nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër Korniza e re e politikave të Planit për rritje ekonomike përgjithësisht përpiket të stimuloj investime përmes tri masave:

- Mbështetja e projekteve investuese me interes të konsiderueshëm ekonomik: firmat të cilat investojnë në projekte me interes të konsiderueshëm ekonomik do të lirohen konform Ligjit për ndihmë shtetërore nga tatimi mbi të ardhurat në paga (10 vjet); tatimi mbi fitimin (10 vjet); grantet deri 10% nga investimet e planifikuara deri në 61.500.000 MKD (1.000.000 EUR) (3 vjet); grantet për një të punësuar me pagë prej më së paku 18.000 denarë për një vend të hapur pune (4 vjet);
- Mbështetje për rritjen e investimeve kapitale dhe të ardhurave: për firmat të cilat gjenerojnë investim fillestar ose plotësues do të kenë të drejtë për mbështetje financiare prej 10% nga investimi në makina të reja, pajisje ose hapësira/tokë e domosdoshme për veprimtarinë deri 61.500.000 MKD (1.000.000 EUR);
- Mbështetje për blerjen e aseteve nga kompanitë të cilat ballafaqohen me vështirësi: kjo masë i mbështet firmat të cilat investojnë në asetet e kompanisë tjetër, sipas procedurave për falimentim/likuidim pas ripërtëritjes së procesit të prodhimitarisë. Investitorët do të kenë kthim prej 10% të vlerës së investimit në makina



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

dhe obligime lidhur me procedurën e falimentimit ose likuidimit deri 61.500.000 denarë (1.000.000 euro).

Pritet që masat e lartpërmendura do të çojnë në trajtim nacional i cili nuk bën dallime midis investitorëve vendas dhe të huaj, në transparencë më të madhe gjatë akordimit dhe shpërndarjes së mbështetjes shtetërore dhe, përfundimisht, do të ketë më shumë investime në ekonomi.

### **Masa 1.5:** *Zhvillimi i Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale (ZZHTI) me fokus mbi industrinë përpunuese.*

**Arsyetimi:** Sukseset e lartpërmendura sa i përket tërheqjes së IHD në industrinë përpunuese (si dhe në sektorët e tjerë), në masë të madhe në mënyrë të drejtpërdrejt janë lidhur me vendosjen e rrjetit për ZZHTI dhe stimulimet e aksesshme për të njëjtat. Një pjesë konsistente e strategjisë së Qeverisë, më shumë se një dekadë, kishte të bëjë edhe me (krahas tërheqjes së IHD-shih më lartë) vendosjen e Zonave zhvillimore teknologjike industriale ZZHTI edhe atë në Shkup (dy zona me 19 qiramarrës) Shtip (3 qiramarrës) dhe Tetovë (1 qiramarrës). Rrjeti u zgjerua edhe në lokacione të tjera, si në Strumicë (1 qiramarrës), Prilep (3 qiramarrës), Strugë (1 qiramarrës), Kërçovë (1 qiramarrës), si dhe dy zona tjera industriale (njëra në Kosel – 1 – qiramarrës – dhe tjetra në përgatitje e sipër në Kratovë). Në plan janë edhe ZZHTI të tjera, siç është ajo në Radovish, Dellçevë, Vinicë, Berovë, Rankovc dhe Gjevgjeli edhe pse prioriteti ka të bëjë me fokusimin e shfrytëzimit të plotë të tetë ZZHTI të para (e treta është në përgatitje e sipër në Shkup). Investitorët në ZZHTI kanë favore nga lirimi tatimor deri në 10 vjet edhe sa i përket tatimit mbi fitim edhe tatimit personal mbi të ardhurat për të punësuarit. Ekzistojnë edhe stimulime të tjera, siç është lirimi nga TVSH dhe detyrimet doganore, bashkë me stimulime të tjera në lidhje me detyrimet komunale për shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe infrastrukturën e zhvilluar. Sipas ligjit për ZZHTI, zonat duhet të sigurojnë lehtësime për veprimtaritë ekonomike me fokus mbi industrinë përpunuese, hulumtimin dhe zhvillimin e TI (me përjashtim të disa veprimtarive, siç janë armët, rrobat që nuk janë të teknologjisë së lartë, bujqësi etj.). Kjo masë e mbështet zgjerimin në kontinuitet të ZZHTI dhe e përforcon joshjen e prodhuesve, duke i përfshirë edhe anët ekzistuese të fuqishme (për shembull, industria automobilistike), si dhe H&ZH dhe TI, në mënyrë që më shumë të fokusohen mbi kapitalin dhe jo mbi investimet me punë intensive, si dhe sa i përket zhvillimit të teknologjive bashkëkohore dhe zbatimit të teknologjive prodhuese të gjelbra (shih, gjithashtu, Qëllimi strategjik 3).

### **Masa 1.6:** *Zhvillimi i mëtutjeshëm i klasterëve industrial me fokus mbi inovacionet dhe konkurrencën.*

**Arsyetimi:** Zhvillimi i klasterëve ishte një qëllim konsekuent politik në pjesën më të madhe gjatë 20 viteve të fundit në vendin tonë, ndërsa Ministria e Ekonomisë posedon bazë të të dhënave për 30 klasterë të cilët i mbështet. Megjithatë, vlerësimet e fundit të iniciativave për klasterë (L. Vodeb, 2017, Raport për evaluimin e klasterëve) erdhën në përfundim se një numër relativisht i vogël i klasterëve janë në përputhje me definicionin ndërkombëtar ose me pritjet ndërkombëtare. Ato më së shpeshti veprojnë si shoqata afariste në vend që të fokusohen mbi inovacionet, konkurrencën, H&ZH dhe mbi aktivitetet të tjera të ngjashme të cilat zakonisht priten nga klasterët edhe pse disa janë aktivë në punë. Zhvillimi i klasterëve është proces afatgjatë dhe çdo klaster ka nevoja specifike të zhvillimit. Qasja e politikës për mbështetjen e klasterëve konsiston me atë që të zhvillohet program i integruar për lloje të ndryshëm të klasterëve (të pazhvilluar, të zhvilluar, në tranzicion dhe ngjashëm), të cilët fokusohen mbi nevojat e tyre specifike zhvillimore. Rrjedhimisht, kjo masë do ta ridizajnojë programin ekzistues për klasterë dhe do të zhvillojë klasterë demonstrues industrial/prodhues si praktikë më e mirë e inovacioneve të klasterit përmes “Pilot programit të integruar për klasterë të pazhvilluar”, i cili e përfshinë bashkimin e ndërtimit të kapaciteteve, ngritjen e vetëdijes, shërbime konsulente dhe grante për financim, me qëllim të përforcimit të inovacioneve dhe konkurrencës. Përveç kësaj, do të mbështeten edhe ndërmarrje të cilat

punojnë në sektorët e përfshirë në Strategjinë për specializim të zgjuar (shih më lartë Masa 1.1), në mënyrë që të zhvillojnë dhe zbatojnë biznes modele të reja për përmirësimin e integritimit të NVM në vlerat globale të zinxhirëve.

**Masa 1.7: Mbështetje për vendosjen e zinxhirëve të vlerave me fokus mbi industrinë përpunuese dhe lidhjen e firmave me zinxhirët global të vlerave.**

**Arsyetimi:** Prodhimi fizik është në qendër të zinxhirit shumë më të gjerë të vlerave në industrinë përpunuese, siç është prezantuar më lartë në Diagramin 3. Së këtejmi, prodhuesit shfrytëzojnë zinxhirë global, rajonal dhe nacional të vlerave në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura të reja dhe plotësuese, me ç'rast prodhuesit e ka rolin kryesor gjatë dhënies së lejeve që të paraqiten aktivitete tjera për krijimin e vlerave. Megjithatë, përveç disa shembujve, si në përpunimin e ushqimit, politika për mbështetje sa i përket analizës dhe zhvillimit të zinxhirëve të vlerave është evidente se mungon, me ç'rast të gjitha përpjekjet koncentrohen në zhvillimin e klasterëve (shih më lartë 1.6). Kjo masë do ta identifikoj dhe mbështes zhvillimin e zinxhirëve të vlerave në industrinë përpunuese, me një lidhje të ngushtë me ZZHTI-të ekzistues, meqë kjo ofron mundësi për lidhjen e firmave vendase me zinxhirët nacional, rajonal (Ballkani Perëndimor dhe BE) dhe me zinxhirët më të gjerë global të vlerave. Kjo masë do të plotësohet me masa të tjera, siç është Masa 2.4: Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet firmave ZZHTI dhe prodhuesve vendorë.

**Masa 1.8: Krijimi i kushteve dhe përgatitja e bazave ligjore për zhvillimin e kapitalit me risk për ndërmarrjet e industrisë përpunuese (PRRE Masa 3.5).**

**Arsyetimi:** Një pjesë e procesit të fuqizimit të themeleve të industrisë përpunuese ka të bëjë me çështjen e kapitalit të riskut për lubrifikimin (vajosjen) e rrotave për investim në projekte teknologjike. Kapitali me risk për momentin është i njohur, edhe atë fillimisht për shkak të mungesës së tij. Kjo masë e përfshin Fondin për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT), i cili duhet të marr vendim për themelimin e Fondit për investime ekviti dhe mezanin, si dhe Qeverinë, e cila duhet të marr vendim për financimin e këtij investimi. Duhet të krijohet bazë juridike (akt nënligjor), për Fondin për investime ekviti dhe mezanin. Pas themelimit, Fondi për investime ekviti dhe mezanin do t'i mbështes aktivitetet investuese në lidhje me përgatitjen dhe realizimin e projekteve për zhvillim teknologjik, duke e pasur parasysh shkallën deri në të cilën ato aplikime do të kontribuojnë për zhvillimin e produktit të ri ose produktit të përmirësuar në masë të konsiderueshme, shërbimit dhe/ose proceseve të punës. Kjo masë do të financoj deri 25% nga vlera e mjeteve personale të aplikuesit deri 30.000.000 MKD (487.800 euro) për një aplikim.

## Qëllimi strategjik 2 – Rritja e produktivitetit, inovacioneve dhe transferimit të teknologjive

Qëllimi paraprak strategjik është fokusuar drejt riorientimit të politikës dhe mbështetjes së industrisë përpunuese në përgjithësi, si edhe drejt nën-sektorëve të caktuar të tjerë. Qëllimi i dytë strategjik fokusohet mbi tre çështjet kryesore të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për vendin që ta realizoj vizionin e tij, përkatësisht rritjen e produktivitetit, inovacionit dhe transferimit/absorbimit të teknologjive në industrinë përpunuese. Pesë mënyrat kryesore, me të cilat do të mbështetet industria përpunuese, kanë të bëjnë me vendosjen e institucioneve të ndryshme të cilat fokusohen mbi transferimin e teknologjive, siç është Zyra Nacionale për Transferimin e Teknologjive (ZNTT) dhe Parku Shkencor-teknologjik (PSHT), duke i rritur nivelet e inovacionit midis NVM prodhuesve, mbështetjes për ndërmarrje me rritje të shpejtë ("gazela"), të cilat fokusohen mbi hendekun politik i cili është i pranishëm tanimë një kohë të gjatë, përkatësisht fuqizimi i lidhjes ndërmjet firmave ndërkombëtare të vendosura në ZZHTI dhe kompanive vendore prodhuese, si dhe fillimin e procesit të identifikimit dhe mbështetjes së teknologjive relevante për Teknologjitë Kryesore (KET) dhe fabrikat e zgjuara në vend.

**Masa 2.1: Fuqizimi i bazës institucionale për transferimin e teknologjive / ekstensionit / absorbimit për mbështetje të industrisë përpunuese (masa të ndryshme nga PRRE).**

**Arsyetimi:** Rritja e sofistikimit afarist dhe teknologjik të furnizuesve lokalë, krahas rritjes së konkurrencës, produktivitetit dhe vendeve të punës mirë të paguara, po ashtu do të ndihmoj edhe për lehtësimin e lidhjeve të pakthyeshme me IHD/ZZHTI edhe për stimulimin e eksportit. Transferimi i teknologjive është proces i shndërrimit e arritjeve ekselente shkencore dhe teknologjike (pronësi intelektuale) në mall ose shërbime të tregut, dhe prandaj e përfshin transferimin ndërmjet institucioneve akademike dhe industrisë të të gjitha aktiviteteve me fokus mbi transmetimin e njohurive ose teknologjive që mund t'u ndihmojnë kompanive ose institucioneve akademike që edhe më tutje t'i kryejnë aktivitetet e tyre. Ekstensioni Teknologjik/industrial është ndihmë për firmat për përmirësimin e konkurrencën, veçanërisht ndërmjet NVM prodhuese. Shërbimet e ekstensionit përfshijnë ndihmë nga jashtë për firmat për lehtësimin e përdorimit të teknologjive dhe stimulimin e inovacioneve në mënyrë që të rritet konkurrenca. Një koncept i lidhur ka të bëjë me absorbimin teknologjik, që do të thotë përfitim, zhvillim, asimilim dhe shfrytëzim të njohurive dhe aftësive teknologjike nga ana e ndërmarrjes. Shkallët e transferimit të teknologjive, ekstensionit dhe absorbimit në firmat maqedonase duhet të jenë prioritare, ndërsa ndërmarrjet prodhuese duhet të mbështeten përmes disa iniciativave për ndërtimin e institucioneve:

- Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT) do të vazhdoj ta mbështes ekstensionin dhe absorbimin teknologjik ndërmjet NVM-ve përmes zbatimit të iniciativës "Absorbim të TT" (ekstension teknologjik);
- Zyra Nacionale për Transferimin e Teknologjive (ZNTT) do të themelohet si institucion i veçantë ose si pjesë e FIZHT (duhet të përcaktohet). Ajo do të luaj rol kryesor në konversionin e rezultateve të hulumtimit në prodhime konkurrenca dhe procese dhe do t'i fokusoj hulumtimet drejt nevojave të industrisë. ZNTT do t'i ofroj këshilla industrisë në Republikën e Maqedonisë në lidhje me licencimin dhe importin e teknologjive nga fusha e teknologjisë dhe pronësisë intelektuale, si dhe do t'i integroj aktivitetet inovative të Republikës së Maqedonisë me programet e BE-së të cilat po ashtu shërbejnë si fokus për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e transferimit të teknologjive;
- Parku Shkencor-Teknologjik (PSHT): do të formohet përmes bashkimit të fakulteteve të ndryshëm në Shkup, (Fakulteti Teknologjik-Metalurgjik, Elektroteknik, të Teknologjive të Informacionit dhe Fakultetit të Makinerisë) me ndërmarrjet për punën e H&Z dhe transferimit të teknologjive. Në fazën e parë, ai do të fokusohet në 2 nën-sektorë (TI dhe bujqësi ose mjekësi). Në fazën e dytë, do të zgjerohet në 3 nën-sektorë të tjerë (ndoshta dizajnim i rrobave, turizëm, etj.). Studimi fizibiliteti, duke e përfshirë edhe vlerësimin e lokacionit, zgjedhjen e nën-sektorëve, pajisjen, kapitalin njerëzor dhe ngjashëm do të kryhet në vitin 2018, duke i përfshirë edhe planet e menaxhimit dhe planet e biznesit. Pritet që PNT të themelohet gjatë vitit 2019-2020;
- Qendra për Transferimin e Teknologjive (QTT): do të shqyrtohet mundësia e themelimit që QTT në fakultetet teknike dhe pajisjen e tyre me pajisje bashkëkohore në kushte përkatëse dhe me kuadër të kualifikuar, për mbështetjen e digjitalizimit kolaborativ të proceseve industriale, si dhe projekte tjera të përbashkëta të cilët e përfshijnë industrinë /NVM për transferimin e njohurive dhe teknologjisë. Ajo do të ketë tre komponentë kryesorë: ndërtim dhe/ose rinovim të hapësirave, furnizim të pajisjes dhe ndërtim të kapaciteteve.

### **Masa 2.2: Ngritja e nivelit të inovacioneve tek ndërmarrjet (Masa 3.3 nga PRRE)**

**Arsyetimi:** Gjerësisht është pranuar fakti se inovacionet kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe për qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të ndërmarrjeve. Hulumtimi në lidhje me çështjet teknologjike në firma (Potenciali teknologjik dhe nevojat e ndërmarrjeve maqedonase, 2015) në nën-sektorët me potencial më të madh teknologjik dhe inovativ (bujqësi, përpunim të ushqimit, energji e gjelbër dhe menaxhimi me mbetje, materiale ndërtimore me efikasitet energjetik, kimi, farmaci, metalurgji, makineri, industri automobilistike, TIK dhe ngjashëm) treguan se 38% prej tyre kanë pasur inovacione edhe sa u përket produkteve, si dhe shërbimeve, ndërsa 66% kanë pasur së paku një nga dy llojet e

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

inovacioneve. Nëntë për qind e kompanive kanë deklaruar se posedojnë patenta, shumica janë në pronësi të firmave të mëdha (17%), pastaj të firmave të mesme (11%), mikro firmave (9%) dhe firmave të vogla (8%). Kjo është një bazë e fuqishme për politikën novatore e cila duhet të avancohet. Përkatesisht, sa u përket NVM inovative, nevojitet mbështetje lidhur me procesin e komercializimit të hulumtimeve dhe qasjes deri te laboratorët dhe pajisja hulumtuese. Këto janë fusha të rëndësishme në të cilat fondi i inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik (FIZHT) dhe ZNTT e ardhshme do të siguroj ndihmë, siç është qasja deri te financat, sigurimi i ekspertizave, si dhe lidhja e kompanive me universitetet relevante dhe institucionet hulumtuese, ku hulumtimi zbuloi se në këtë aspekt bashkëpunimi është shumë i vogël midis ndërmarrjeve dhe universiteteve. Plani për rritje ekonomike do ta mbështes zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inovative në kompanitë, pavarësisht madhësisë, me mbulim deri në 70% të shpenzimeve direkte deri 20.000.000 denarë (325.200 euro) për një aplikues. Aktivitetet investuese përfshijnë: zhvillim dhe inkorporim të prodhimeve dhe shërbimeve të reja, përmirësim të prodhimeve dhe shërbimeve ekzistuese, koleksione të reja të modës, dizajn industrial ose ridizajnim të produkteve, pako të reja dhe plane marketingu (analizë e tregut, analizë e konkurrentëve, hulumtimi i prodhimeve, shitja etj.), përmirësimi i proceseve ekzistuese të prodhimit dhe inkorporimi i proceseve të reja prodhuese.

**Masa 2.3:** *Mbështetja e NVM me rritje të shpejtë ("Gazela") me zhvillim teknologjik (Masa 3.1 nga PRRE).*

**Arsyetimi:** Përmes PRRE, do të sigurohet mbështetje financiare edhe për "Gazelat" për zhvillim teknologjik të kompanive, duke mbuluar 30% prej shpenzimeve direkte të investimeve.

Kjo do të arrihet përmes thirrjeve publike për financimin e investimeve, për shembull, në aktet normative teknike evropiane për sigurinë e prodhimeve; përgatitje për certifikimin e cilësisë; analizë, përgatitje, fitimi dhe mbrojtja e të drejtave industriale dhe intelektuale të pronësisë dhe implementim të sistemeve të informacionit. Përveç kësaj, kjo masë do të mbështes iniciativat të ndryshme të gjelbra, duke përfshirë: përmirësimin e efikasitetit energjetik; konsultime për mbrojtje të mjedisit jetësor, përgatitje dhe vendosje të sistemeve për menaxhim me mbetje.

**Masa 2.4:** *Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet investitorëve të huaj dhe prodhuesve vendor (Masa 1.2 nga PRRE).*

**Arsyetimi:** Ekziston nevoja e zhvillimit sistematik të kapaciteteve lokale të industrisë përpunuese, në mënyrë që të ndërliohen me numrin e rritur të korporatave prodhuese Multinacionale (KMN), pavarësisht a janë në kuadër të ZZHTI ose jo. Disa kompani nga IHD kanë vendosur bashkëpunim me universitetet/fakultetet, ndërsa disa prej firmave zhvillojnë lidhje për furnizim me disa prodhues vendor. Megjithatë, zhvillimi i mëtutjeshëm i lidhjes me kompanitë IHD kufizohet me produktivitetin e ulët të kompanive, aftësitë e tyre, sofistikimin afarist dhe ngjashëm. Lidhjet kthyesë me kompanitë lokale edhe më tutje janë të kufizuara, ndërsa me këtë kufizohen edhe përfitimet nga punësimet, neto rritja e eksportit, shkëmbimi i njohurive, inovacioneve, transferimi i teknologjive dhe rrjedhjet e tjera të efekteve nga IHD. Pilot Programi për zhvillimin e furnizuesve është testuar me 5 kompani automobilistike dhe mund të zbatohet mbi një grup shumë më të madh të kompanive prodhuese. Përveç kësaj, Fakulteti i Makinerisë ka pilot projekt për lidhje (15 firma, 5 detajisht të mbështetura) me shembuj praktik të praktikave të mira për bashkëpunim. Qëllimi i kësaj mase është stimulimi i mëtutjeshëm i partneriteteve midis kompanive të huaja prodhuese të cilat punojnë në Maqedoni dhe NVM prodhuese lokale. Kjo masë, do t'ju mundësoj kompanive të kenë mbështetje financiare për bashkëpunim afarist me furnizuesit vendor, matur në bazë të përqindjes të furnizimit të inputeve prodhuese nga furnizuesit në ZZHTI. Ndërmarrjet e këtilla mund të kenë mbështetje financiare në lartësi prej 1% nga vlera e furnizimeve të përgjithshme nëse furnizojnë më së paku 15% nga inputet prodhuese nga furnizuesit e regjistruar në Republikën e Maqedonisë deri 18.450.000 denarë (300.000 euro) për një aplikues.

**Masa 2.5: Identifikimi dhe mbështetja e Teknologjive kryesore (KET) dhe Fabrikave të zgjuara në industrinë përpunuese (Industria 4.0 dhe Fabrika 4.0).**

**Arsyetimi:** Në shumë vende diskutohet për dy çështje esencialisht të rëndësishme dhe të ndërlidhura. Revolucioni i katërt industrial/fabrikat e zgjuara (drejtpërdrejt të lidhura me digjitalizimin dhe vendosjen e sajber sistemeve fizik) dhe Teknologjitë kryesore (KET). Tendencat në prodhim, Revolucioni i katërt industrial dhe rritja e KET, duke e përfshirë edhe potencialin e teknologjive të reja të cilat i zëvendësojnë të vjetrat, të cilat paraprakisht ishin diskutabile (shih më lartë Pjesën 3.2), janë ngjarje të cilat pritet t'i mbështesin gjerë e gjatë mundësitë e ardhshme prodhuese në industri, duke e kanalizuar valën e ardhshme të prodhimeve me vlerë të lartë dhe teknologji prodhuese, si dhe duke siguruar bazë për zhvillimin e industrive të reja dhe modeleve të biznesit, duke e përfshirë stimulimin e teknologjive të reja energjetike dhe ekologjike. BE identifikoi gjashtë KET të rëndësishme (përkatësisht mikro dhe nanoelektronikë, nanoteknologji, bio-teknologji industriale, materiale të avancuara, fotonikë dhe teknologji të avancuara prodhuese). Megjithatë, debati në lidhje me KET specifike të cilat kanë kuptim në kontekstin e Republikës së Maqedonisë dhe ekonomisë së saj akoma nuk ka filluar. Kjo masë do të përqipet t'i përcaktoj implikimet e KET dhe fabrikave të zgjuara dhe t'i vlerësoj prioritetet në kontekstin e ekonomisë maqedonase përmes formimit të Grupit teknik të punës. Grupi i punës për KET do të ofroj rekomandime për zhvillimin e target instrumenteve për ndihmë shtetërore, duke e përfshirë edhe shfrytëzimin maksimal të fondeve ekzistues të BE (për shembull, Horizont2020). Projekti donator do të punoj në zbatimin e rekomandimeve të grupit teknik të punës.

## Qëllimi strategjik 3 – Katalizimi i industrisë së gjelbër dhe prodhimit të gjelbër

Qëllimi i tretë strategjik, kanalizimi i industrisë së gjelbër dhe prodhimi i gjelbër, përbën dallim të madh në krahasim me strategjinë paraprake. Gjelbërimi i një ndërmarrjeje ose i një industrie nuk është aksion i njëhershëm, por një proces i vazhdueshëm i ndryshimeve graduale dhe radikale, të cilat çojnë drejt përmirësimit të performansave. Kushtet të cilat e promovojnë gjelbërimin e industrive nuk mund të arrihen me një instrument politik. Gjelbërimi i industrive nënkupton të sigurohet se të gjitha industritë, pavarësisht sektorit, madhësisë ose lokacionit vazhdimisht i rrisin performansat e tyre ekologjike. Kjo e përfshin përkushtimin e reduktimit të ndikimeve mbi mjedisin jetësor nga proceset dhe prodhimet me shfrytëzim më efikas të resurseve, evitimin gradual të substancave toksike, zëvendësimin e lëndëve djegëse fosile me burime të rinovueshme të energjisë, përmirësimin e shëndetit dhe sigurinë e vendit të punës, marrjen e përgjegjësisë së madhe të prodhuesit dhe reduktimin e rreziqeve të përgjithshme. Ekziston një sektor në rritje dhe i diversifikuar cili i përfshin të gjitha llojet e ndërmarrjeve dhe teknologjive, në mënyrë që të kontribuojnë në reduktimin e ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor ose në zgjidhjen e pasojave të formave të ndryshme të ndotjes. Kjo e përfshin rinovimin e materialeve, riciklimin, kontrollin e ndotjes së ajrit, menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave, si dhe ndërmarrje të cilat transportojnë mbetje. Kjo qasje i promovon modelet e qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit – modele të cilat nga aspekti i resurseve dhe energjetikës janë efikas, me karbon të ulët, me minimum mbetje, që nuk ndotin, të sigurt dhe të cilët prodhojnë produkte me të cilat menaxhohet me përgjegjësi gjatë ciklit të tyre jetësor. Kjo strategji konkretisht fokusohet mbi NVM në industrinë përpunuese dhe mbi tetë mënyra kryesore me të cilat industria përpunuese do të kanalizohet që t'i jap mbështetje industrisë së gjelbër / prodhimit të gjelbër duke përfshirë: inkorporim të rregulloreve të gjelbra, prokurime të gjelbra publike, ndihmë ndërmarrjeve ta inkorporojnë qëndrueshmërinë në biznesin e tyre, zhvillim të Zonave të gjelbra industriale, gjelbërim të zinxhirëve për furnizim përmes certifikimit, rritje të efikasitetit të resurseve / energjisë dhe reduktim të prodhimit të karbonit / prodhim më i pastër si dhe stimulim të përpunimit dhe 3D printimi / prodhimi.

### **Masa 3.1: Zbatimi i Reformës së gjelbër rregullatore.**

**Arsyetimi:** Reforma rregullatore e hap rrugën e industrive të gjelbra përpunuese që të inkorporojnë inovacione dhe të konkurrojnë në baza të ndershme. Nevojitet veprimi politikë, për shembull, që të mundësohet përmirësimi i efikasitetit gjatë shfrytëzimit të energjisë përmes përdorimit më të madh të teknologjive më të pastra. Përvoja ndërkombëtare vë në dukje se ndërhyrjet e tregut mund ta stimulojnë zhvillimin e industrisë së gjelbër. Përcaktimet ligjore mund të ndikojnë mbi efikasitetin energjetik (shih: Masën 3.6) dhe ta përshpejtojnë përdorimin e teknologjive dhe praktikave më të mira të aksesshme dhe më të pastra në industri, e që do të mundësoj t'i përmbushin standardet për emisione dhe emetime. Kjo do t'u mundësoj industrive, përfshirë edhe ZZHTI (shih: Masën 1.5 dhe zona të gjelbra, shih: në vijim Masën 3.5) të kalojnë në përpunim në një cikël të mbyllur përmes skemave për riciklim, rinovim dhe përdorim të sërishëm të materialeve. Mekanizmat rregullator dhe kontrollues filluan të shfrytëzohen në sektorin e industrisë për promovimin e parimeve, siç është "ndotësi paguan" dhe "përgjegjësi e zgjeruar e prodhuesve" për stimulimin e prodhuesve të mëdhenj dhe zinxhirët e tyre furnizues ta mbështesin përpunimin në cikël të mbyllur dhe në sistemet më efikas për kthim për ripërpunim dhe riciklim (shih: masat 3.7 dhe 3.8 në vijim). Kjo masë do ta përmirësoj mjedisin e gjelbër rregullator përmes inicimit të debateve për politika, ndërkaq do të rritet vetëdija tek shoqatat afariste dhe bizneset në lidhje me opsionet e ndryshme të politikës për industrinë përpunuese, siç është: parimi ndotësi paguan (tanimë zbatohet); përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit (tanimë zbatohet); dhe zbatimi i direktivave të BE (për shembull, efikasiteti energjetik). Reforma e gjelbër rregullatore do të fokusohet mbi energjinë, duke e përfshirë edhe Ligjin e ri për energjetikë (kornizë e përgjithshme) dhe Ligjin për efikasitet energjetik, si dhe bazën ligjore për formimin e fondit për efikasitet energjetik për t'i lehtësuar shpenzimet financiare për riparim/pajisje të reja. Me ligjet e reja do të nevojiten rreth 50 Rregullore të rishikuara të reja. Disa nga rregulloret do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi industrinë përpunuese, siç është Rregullorja për sektorin industrial, ndërkaq pritet se do t'u mundësojnë kompanive të zgjedhin se a do ta zbatojnë ISO 50001 ose do të bëjnë revizione energjetike në sektorin e industrisë. Reforma e gjelbër rregullatore, përveç kësaj, do ta përfshijë edhe përgatitjen e strategjisë afatgjatë për aktivitetet klimatike



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

dhe Ligjin për aktivitete klimatike, si dhe Ligjin për kontrollin e emisioneve nga industria, që do të ndikoj mbi sektorin e industrisë.

### **Masa 3.2: Prokurime të gjelbra publike për mallra dhe shërbime me ndikim të madh.**

**Arsyetimi:** Prokurimet publike kapin shifrën prej rreth 12% të BPV dhe mund të jenë element i rëndësishëm për tregti të qëndrueshme, nëse fokusohen në drejtim të stimulimit të zhvillimit të mjedisit jetësor. Me shfrytëzimin e fuqisë së tyre të blerjes për zgjedhjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve ekologjike, autoritetet shtetërore mund të japin kontribut të rëndësishëm për konsum dhe prodhim të qëndrueshëm. Prokurimet publike të qëndrueshme ose të gjelbra janë instrument vullnetar i cili mund të luaj rol kryesor në tranzicionin drejt Ekonomisë cirkulare, meqë mund ta rris kërkesën e produkteve në kontekstin e resurseve energjetike efikase, të qëndrueshme, të reciklueshme, të rinovueshme, si dhe të promovojnë modele të reja biznesi të mbështetura në ofertën e funksionaliteteve dhe shërbimeve, në vend të shitjes së produkteve. Prokurimet e gjelbra publike, nga ana tjetër, iu mundësojnë autoriteteve lokale dhe shtetërore të vendosin modele dhe standarde të cilat bizneset, industritë dhe ngjashëm duhet t'i ndjekin. Ligji i ri për prokurime publike do të rishikohet në mënyrë që të inkorporohen rregulla të cilat mundësojnë faktorë të qëndrueshëm/ekologji/të gjelbër për zhvillim, duke përfshirë edhe manual të nevojshëm për ndërtimin e kapaciteteve për lidhje të marrëveshjeve/kontratave. Me propozim Ligjin e ri për efikasitet energjetik, veç tjerash, do të inkorporohet obligimi i detyrueshëm në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me prokurimet publike, veçanërisht që kanë të bëjnë me efikasitetin energjetik.

### **Masa 3.3: Inkorporimi i qëndrueshmërisë si strategji themelore afariste për prodhuesit.**

**Arsyetimi:** Ekziston përparësi e konsiderueshme sa i përket stimulimit të prodhuesve që të ndërmarrin iniciativë për ecurinë e zgjidhjes së problemeve të cilat kreatorët e politikave dëshirojnë t'i zgjidhin, siç është ndihma për ndërmarrje të caktuara që ta inkorporojnë qëndrueshmërinë si strategji afariste, duke përfshirë vendosjen vullnetare të standardeve ekologjike. Bizneset mund të zhvillojnë përparësi konkurrenente përmes integritit të aspekteve ekologjike dhe sociale (për shembull, përgjegjësia korporative-shoqërore) në biznes modelet /aktivitetet e tyre, e që do të ketë rezultate afariste më të mira në mënyrë që të stimulohen inovacionet dhe të përmirësohen rezultatet ekonomike. Prodhimi i gjelbër mund të çoj në reduktimin e shpenzimeve për lëndët e para, në përfitime nga rritja e produktivitetit në reduktimin e shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen në punë, fare pak ose aspak mbetje ose ndotje, konsum i reduktuar i energjisë dhe imazh i përmirësuar korporativ. Kjo masë do të ndihmojë në integrimin e qëndrueshmërisë në strategjitë kryesore afariste të NVM përmes bashkëfinancimit. Shih, gjithashtu, Masën 2.3 Mbështetje për NVM me rritje të shpejtë ("Gazela") me zhvillim teknologjik, e cila e përfshin përmirësimin e efikasitetit energjetik, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përgatitjen dhe vendosjen e sistemeve për menaxhim me mbetje.

### **Masa 3.4: Mbështetje të iniciativave të gjelbra në industrinë përpunuese të udhëhequra nga industria (zinxhirë të gjelbërues të vlerave).**

**Arsyetimi:** Ekziston një spektër i gjerë i iniciativave vullnetare të udhëhequra nga industria të cilat mund të mbështeten nga Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Energjetikë dhe nga institucione të tjera për promovimin e efikasitetit dhe përmirësimet ekologjike. Këto iniciativa, të cilat mund të mbështeten përmes granteve/bashkëfinancimit, si dhe informacionet dhe *know-how* përfshijnë: inkorporim të ISO 14001 (Sisteme për menaxhim me mjedisin jetësor), ISO 9001 (Kualitet), ISO 18001 (Shëndet dhe siguri), ISO 50001 (Menaxhimi me energji) etj. Si pjesë e sistemit për menaxhimin me mjedisin jetësor, kompanitë multinacionale i aprovojnë standardet për furnizim përmes zinxhirit të gjelbër, me atë që kërkojnë nga furnizuesit e tyre të përdorin sistem të certifikuar për menaxhim me mjedisin jetësor. *EcoLabel*e ndihmon BE gjatë identifikimit të produkteve dhe shërbimeve të cilat e kanë reduktuar ndikimin mbi mjedisin jetësor gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor, duke iu mundësuar konsumatorëve të bëjnë

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

përzgjedhje të informuar dhe i shpërblen prodhuesit të cilët vendosin të dizajnojnë produkte të cilat janë të qëndrueshme dhe të përmirësueshme, ndërkaq me këtë duke promovuar inovacione dhe duke kursyer resurse. Skema e eko-menaxhmentit dhe revizionit (EMAS) është instrumenti oficial evropian për menaxhimin me mjedisin jetësor, që u ndihmon organizatave t'i përmirësojnë performansat e tyre ekologjike dhe t'i demonstrojnë përpjekjet e tyre për zbatimin e praktikave për reduktimin, përdorimin e sërishëm dhe riciklimin. "Gjurma ekologjike e produktit" dhe "Gjurma ekologjike e organizatave" (Product Environmental Footprint (PEF) dhe Organisation Environmental Footprint (OEF)) janë mekanizma të cilët i matin dhe i informojnë konsumatorët për ndikimin e produkteve dhe organizatave mbi mjedisin jetësor – qasjandaj vlerësimit të ciklit jetësorë është esenca e Ekonomisë cirkulare. Në këtë mënyrë, kjo masë do t'i mbështes prodhuesit, veçanërisht NVM të cilët dëshirojnë të eksportojnë në BE dhe në vende të tjera, përmes shërbimeve të bashkë-financuara konsulente dhe shpenzimeve për certifikim.

### **Masa 3.5: Zhvillimi i Zonave të gjelbra industriale (ZGJI) me fokus mbi industrinë përpunuese.**

**Arsyetimi:** Qeveria e kupton rëndësinë e industrisë ekologjike dhe realizoi analizë ndërkombëtare komparative të praktikave të mira (2012), që rezultoi me Ligjin për zona të gjelbra industriale (2013). ZGJI përpunuese, që shpie në produkte që posedojnë eko-etiketa të gjelbra, prodhim ekologjik, etj. Bëhet dallimi midis Zonave industriale të cilat kryesisht fokusohen në industrinë e lehtë, dhe zonave të gjelbra në të cilat zbatohen rregulla shumë më të rrepta në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit jetësor (çdo prodhues e ka për detyrë të siguroj Plan për mbrojtjen e mjedisit jetësor në përputhje me këtë Ligj) me fokus mbi prodhimtarinë e rinovueshme, prodhimin organik dhe ngjashëm, në mënyrë që të minimizohet ndotja e mjedisit jetësor dhe të aplikohet kursimi i energjisë dhe/ose më pak teknologji ndotëse. Zona industriale janë themeluar në Manastir (Zhabeni) dhe Veles (Mamutçevo, Karaslari). Në bashkëpunim me konsulentë të USAID, Ministria e Ekonomisë vizitoi 21 komuna në 8 rajone planore që ta vlerësoj shtrirjen e formimit të ZGJI. Thuaja se të gjitha planet të autoriteteve lokale për planifikim hapësinor e përfshijnë mundësinë e krijimit të zonave të gjelbra. Disa komuna patën sukses t'i plotësojnë kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor në mënyrë që të krijojnë ZGJ. Nuk është formuar asnjë zonë e gjelbër dhe kjo masë do të përpiket ta reformoj dhe ta orientoj Ligjin për zona të gjelbra industriale dhe ta kryej punën rreth realizimit të zonave të gjelbra, e që do të rezultojë me krijimin e së paku një zone të gjelbër si pilot-projekt.

### **Masa 3.6: Stimulimi i efikasitetit energjetik/të resurseve dhe efikasiteti i resurseve/me karbon të ulët/ teknikat më të mira të aksesshme në industrinë përpunuese.**

**Arsyetimi:** Industria përpunuese është përgjegjëse për rreth 35% të konsumit global të energjisë elektrike, për rreth 20% të emisioneve të CO<sub>2</sub>, mbi 25% të eksploatimit të resurseve primare dhe deri në 17% të dëmit mbi shëndetin që ka të bëjë me ndotjen e ajrit (UNEP Green Economy, 2011). Ashtu siç zgjerohet prodhimi industrial, ashtu rritet qasja mbi furnizimin me energji. Vendet në zhvillim kanë potencial t'i evitojnë teknologjitë joefikase me miratimin e Programit për prodhimtari më të pastër, veçanërisht ato që sigurojnë mbështetje për NVM, shumica prej të cilave punojnë për zinxhirët global të vlerave. Evitimi i teknologjive dhe industrive më pak efikase, më të shtrenjta dhe ndotëse, dhe fokusimi drejt teknologjive më të qëndrueshme dhe më të avancuara, mund tu ofroj vendeve në zhvillim të prodhojnë mallra me çmim më të ulët për shkak të përdorimit të reduktuar të energjisë. Kur do të merret parasysh ky evitim teknologjik, në afat të gjatë NVM do tu siguroj përparësi të gjelbër dhe të çmimeve në sektorin e eksportit (shih: Kornizën në vijim). Shih, gjithashtu Masën 2.3 mbështetje të NVM me rritje të shpejtë ("Gazela") me zhvillim teknologjik, e cila e mbështet përmirësimin e efikasitetit energjetik; mbrojtjen e mjedisit jetësor, përgatitjen dhe vendosjen e sistemeve për menaxhim me mbetje.

### Korniza 8: Rritja e efikasitetit të resurseve dhe efikasitetit energjetik

- Shfrytëzimi efikas i resurseve dhe prodhimi më i pastër: për këtë nevojitet qasje holistike të bazuar mbi sistemin për ndarjen e rritjes ekonomike nga degradimi i përsheptuar i mjedisit jetësor dhe shfrytëzimi i resurseve përmes sistemeve për menaxhim me mjedisin jetësor dhe energjinë; optimizimi i ciklit jetësor të produktit dhe optimizimi i proceseve; zhvillimi dhe aplikimi i teknologjive të pastra (për shembull, teknologji për energji të rinovueshme); shfrytëzimi i përmirësuar i resurseve, reduktimi i ndotjes, minimizimi i mbetjeve dhe strategji për zero mbetje; sisteme të rrethit të mbyllur dhe të simbiozës industriale;
- Efikasiteti energjetik në industri: kjo përfshin qasje sistematike dhe të fokusuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të performancave energjetike dhe produktivitetit dhe reduktimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike, përmes implementimit të standardeve të sistemeve për menaxhim me energji, optimizim të sistemeve energjetike (avull, motor, ajër i kompresuar etj), dizajn efikas energjetik dhe inovacione ekonomike graduale teknologjike;
- Karboni i ulët dhe/ose prodhim klimatik elastik: kjo e përfshin nevojën e qasjeve inovative për ndërmarrjet dhe zinxhirët e vlerave për zbutjen e ndryshimeve klimatike përmes përdorimit të rritur të energjisë së rinovueshme. Këto qasje e parandalojnë humbjen e karbonit nga zinxhirët e vlerave dhe i stimulojnë ndryshimet në proceset, në eliminimin e emisioneve të gazrave serrë jo energjetikë, krahas përmirësimit të aftësive të industrive të përshtaten në ndikimin e ndryshimeve klimatike;
- Energji e pastër për qëllime produktive: kjo e përfshin promovimin e zgjidhjeve të rinovueshme energjetike dhe teknologjike për përbushjen e nevojave energjetike të industrive lokale, veçanërisht në mjediset rurale dhe zgjidhje të qëndrueshme sa i përket çështjes së varfërisë energjetike.  
Burimi: UNIDO

Kjo masë do t'i mbështes mekanizmat e industrisë përpunuese për përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe të resurseve dhe për prodhim më të pastër përmes ndihmës teknike, qasjes deri te financat dhe ndërtimit të kapaciteteve. Disa nga aktivitetet tanimë janë përfshirë në Masën 3.1 më lartë, siç është Ligji i ri për energjetikë dhe efikasitet energjetik. Progresi rëndësishëm në formimin e Fondit për Efikasitet Energjetik i cili do të financoj dhe mbështes efikasitetin energjetik/të resurseve dhe prodhimin i cili është me nivel të ulët të karbonit/më i pastër. Pastaj, si pjesë e procesit të fitimit të lejeve për parandalimin e integruar dhe kontrollin mbi ndotjen, ndërmarrjet duhet të paraqesin plane për efikasitet energjetik, por ato, për momentin, nuk janë të përgatitur dhe as të rishikuar. Kapacitetet e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do të përforcohen përmes trajnimit të lëshuesve të lejeve për parandalimin e integruar dhe kontrollin mbi ndotjen në të ardhmen t'i rishikojnë planet. Kjo e përfshinë zhvillimin e metodologjisë për planet për efikasitet energjetik dhe për fuqizimin e kapaciteteve përmes trajnimit të industrisë përpunuese për përpilimin e planeve për efikasitet energjetik. Nga na tjetër, UNIDO/Qendra rajonale e mjedisit jetësor do të implementoj projektet për efikasitet energjetik në industri dhe prodhimtari në mënyrë që ta përcaktoj qëndrueshmërinë e tyre dhe leverdinë në kontekstin e Republikës së Maqedonisë, si dhe do të trajnoj dhe kualifikoj konsulent privatë dhe menaxherë/inxhinierë, teknikë në ndërmarrjet e industrisë për implementimin e sistemeve për menaxhimin me energji në përputhje me ISO 50001, sisteme industriale për avull dhe vlerësim dhe optimizim të sistemeve për ajër të kompresuar, me ç'rast do t'ju mundësoj t'i ofrojnë shërbimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejt firmave që të ndërtojnë ekspertizë të qëndrueshme të brendshme për menaxhimin me energji në prodhimin e përditshëm dhe aktivitetet afariste.

### Rrjeti 3.7: Mbështetje NVM në *riprodhim*.

**Arsyetimi:** Riprodhimi është një proces i vendosjes së produkteve të shfrytëzuara dhe të komponentëve të veçanta prodhuese në gjendje funksionale "si të ri", me kthimin e një pjese të konsiderueshme të resurseve të instaluar në produktin e shfrytëzuar në gjendjen e tij fillestare prodhuese, me shpenzime të vogla shtesë, me ç'rast zvogëlohet çmimi i prodhimit të fituar të ri. Riprodhimi është më i mirë se riciklimi i materialeve ose se prodhimi i produkteve të reja; me reduktimin e emisioneve të gazrave serrë nga prodhimtaria ose me shmangien e prodhimtazbutet konsumimi i resurseve natyrore, ndihmohet reduktimi i ngrohjes globale dhe rriten mundësitë e për manipulimit më të sigurt me materie toksike. Për

riprodhim nevojiten investime më të vogla kapitale sesa për aktivitetet prodhuese, meqë nuk prodhohen pjesë të reja, ndërsa pjesa më e madhe e punës tanimë është bërë nga prodhuesi burimor i pajisjes (nëse mund të demontohet dhe pastrohet dhe nëse pjesët e tij mund të riparohen ose zëvendësohen, në mënyrë që funksioni origjinal dhe niveli i punës të ruhen), kështu që ekziston treg i konsiderueshëm potencial. Riprodhimi ofron potencial për aktivitete të reja nacionale afariste në ekonomitë në tranzicion dhe mundësi të reja për eksport. Duke e pasur parasysh investimin minimal financiar dhe material gjatë prodhimit, shërbimet e riprodhimit sigurojnë çmime më të ulëta për konsumatorët, zakonisht 30-40% çmime më të ulëta në krahasim me produktet e reja. Riprodhimi është element i rëndësishëm në fushat siç janë pjesët e këmbimit për mjete motorike, kompresorët, pajisjet për komunikime elektronike dhe komunikimin e të dhënave, mobilie zyra, automatë për shitje të prodhimeve (vending makina), aparate fotokopjimi dhe kartrixhë për tonerë laserikë, pajisje bujqësore etj. Riprodhimi mund të jetë instrument i dobishëm bashkë me klasterët, ZZHTI etj. Përmes kësaj masëdo të bëhet një studim për ZZHTI dhe potencialin e tyre për mbështetjen e aktiviteteve të riprodhimit (pengesë kryesore është ajo se strategjitë për vazhdimin e përdorimit të produkteve të prodhuara varen nga bashkëpunimi me prodhuesit e pajisjes origjinale, megjithatë ekzistojnë stimulime që ata të montojnë pjesë të vjetra dhe të bëjnë zëvendësim në modelin e tyre afarist) që çon në rekomandime të politikave të cilat duhet të implementohen në të ardhmen siç është mbështetja për start-up kompanitë dhe bashkëfinancimi i pajisjes.

### **Masa 3.8: Mbështetje NVM në prodhimin aditiv/printim (shtypje) 3D.**

**Arsyetimi:** Prodhimi aditiv është një proces me të cilin objektet fizike bashkohen dhe zhvillohen, zakonisht shtresë pas shtrese, në bazë të dizajnit të prototipit digjital (po ashtu i njohur si printim 3D ose prodhim 3D). Kjo është një pjesë e “digjitalizimit të prodhimtarisë” dhe është një proces prodhues relativisht i ri, i cili mund të çojë në gjelbërimin e zinxhirëve ndërkombëtarë të furnizimit, gjithashtu duke mundësuar hapësirë për inovacione dhe pjesëmarrje në zhvillimin e tregut ndërkombëtar në rritje. Aftësia e dizajnit të prodhimit në një vend dhe të bartet në një vend tjetër si output premtor se do të balancohet së paku një pjesë e tregut global të punës dhe se do ta “shkyç” kreativitetin e novatorëve dhe sipërmarrësve në mbarë botën. Procesi i prodhimit 3D i shndërron lëndët e para siç është metali, qeramika, plastika etj. direkt në produkte të gatshme, duke i evituar shumënga hapat e ndërmjetëm. Me manipulim të drejtë, nevojiten më pak materiale kështu që mbetjet mund të minimizohen. Përveç kësaj, meqë printimi 3D mundëson që produktet të dizajnohen dhe të shtypen me materiale lokale (duke i përfshirë edhe materialet e ricikluara), ekonomitë në tranzicion mund ta reduktojnë varësinë e tyre nga importi i shtrenjtë i materialeve. Përveç kësaj, ato mund të krijojnë produkte të tyre më adekuate dhe të realizojnë fitim nga prodhimi. Me përmirësimin e teknologjisë 3D për prodhim, shpenzimet për printerë 3D përfshirë edhe materialet për të njëjtit reduktohen. Ky proces relativisht i ri prodhues ka potencial që në masë të konsiderueshme të ndikojë mbi modelet prodhuese tradicionale me reduktimin ose eliminimin e konvejerëve prodhues dhe zinxhirëve furnizues, meqë produktet “finale” prodhohen brenda një procesi të vetëm. Gjithashtu, deglobalizohet prodhimtaria dhe distribuimi i produkteve me zhvendosjen e procesit të prodhimit më afër klientit. Përparësitë e tjera përfshijnë: eliminimin e stoqeve, reduktimin e gjurmës së karbonit dhe shfrytëzimin e energjisë, reduktimin e mbetjeve nga paketimi etj. Edhe pse një gjë e këtillë potencialisht mund të rezultojë me zvogëlimin e vendeve të punës në prodhimtari, digjitalizimi i prodhimit pritet ta rrisë kërkesën e shërbimeve profesionale të dizajnerëve, inxhinierëve, teknikëve, programerëve dhe profesioneve të tjera. Ky riorientim i industrisë përpunuese drejt “sigurimit të shërbimeve profesionale” ka potencial që disa procese përpunuese t’i kthejë pas në ekonomitë e tranzicionit, duke kërkuar nga vendet pjesërisht t’i rifokusojnë industrinë e tyre përpunuese në drejtim të sigurimit të shërbimeve dhe ta përmirësojnë arsimimin e fuqisë së kualifikuar të punës. Kjo masë do t’i mbështesë NVM në printimin 3D/prodhimin, veçanërisht start-up ndërmarrjet, përmes granteve dhe bashkëfinancimit.

## Qëllimi strategjik 4 – Stimulimi i eksportit të prodhimit

Përgjegjësia e politikës për eksport është tek Ministria e Ekonomisë, ndërsa avancimi i eksportit është përgjegjësi e Agjencisë për Investime të Huaja dhe Promovimin e Eksportit (InvestMaqedonia). Megjithatë, viteve të fundit kishte mbështetje aktive relativisht të vogël për eksportin në përgjithësi, ndërsa fokusi nuk ishte mbi eksportin e prodhimeve. Megjithatë, eksporti maqedonas shënoi rritje dhe u bë më i sofistikuar, por me rreth 50% të BPV (2016) ai mbetet nën nivelin prej 70-80% të arritjes në ekonomitë e tjera në tranzicion në Evropë, kështu që ka hapësirë për përmirësimin e performancave. Fokusi i aktiviteteve të ardhshme për stimulimin e eksportit/internacionalizimit të industrisë përpunuese do të përfshijë nëntë politika si vijon: zhvillimi i aftësisë eksportuese (ME/strategji), fuqizimi i diplomacisë ekonomike jashtë vendit, përvetësimi i tregjeve të reja dhe rritja e shitjes, rritja e konkurrencës në tregjet e reja, rritja e numrit të NVM me orientim eksporti, mbështetje të internacionalizimit përmes standardeve, gjetjes së kontakteve për eksport dhe integrimi i burimeve të informacioneve eksportuese në mënyrë që t'u ndihmojnë eksportuesve aktual dhe të ardhshëm.

### **Masa 4.1: Fuqizimi institucional i politikës eksportuese me fokus mbi industrinë përpunuese.**

**Arsyetimi:** Ministria e Ekonomisë ka përgjegjësi për politikën eksportuese, megjithatë dokumenti i fundit i këtyllë strategjik u hartua në vitin 2010, ndërkaq me zgjerimin e rolit të Invest Maqedonia në promovimin e eksportit Ministria i fokusoi aktivitetet e veta mbi tregtinë. Meqë asnjë institucion nuk e mori përgjegjësinë për eksportin, politika e orientimit eksportues, për momentin, gjendet në vakum. Kërkesat e CEFTA, anëtarësimi në BE, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe ngjashëm janë jashtëzakonisht të vështira: ekzistojnë mundësi, si dhe kërcënime, të cilave vendi dhe kompanitë e tij duhet tu përgjigjen. Invest Maqedonia do të formoj një sektor/seksion më të fuqishëm për ballafaqimin me promovimin e eksportit. Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për politikën dhe do ta koordinoj implementimin e Strategjisë për eksport, me fokus mbi prodhimtarinë. Strategjia e re për eksport do të ndërlidhet me Strategjinë nacionale për specializim të zgjuar (shih, Masën 1.1 më lartë) dhe do t'i identifikoj nën-sektorët e synuar, prodhimet, vendet etj., në mënyrë që t'i mundësohet Invest Maqedonia (promovim të eksportit – shihni në vijim) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme (diplomacia ekonomike e MPJ – shihni në vijim) të jenë më të organizuar dhe më efikas. Ministria e Ekonomisë do të siguroj që Strategjia të aprovohet dhe do ti shpërndaj mjetet për implementimin e saj në bashkëpunim të ngushtë me Invest Maqedonia dhe MPJ. Kjo masë e përfshin vështirimin e sektorit ekzistues për eksport në Invest Maqedonia (buxhet, kuadër, përgjegjësi, informacione dhe shërbime kontakti, me lidhje eksplicite me diplomacinë ekonomike) etj.; bashkëfinancim të NVM për pjesëmarrje në panairë të synuara, ekspozita, B2B dhe evente të ngjashme; financim të aktiviteteve promovuese; mbështetje për "E bërë në Maqedoni"; ndërtim të kapaciteteve të NVM përpunuese lidhur me aspektet e eksportit, që kanë të bëjnë me masa tjera të ndryshme të theksuara në vijim.

### **Masa 4.2: Fuqizimi i IHD dhe eksportit përmes diplomacisë ekonomike.**

**Arsyetimi:** Ekziston nevoja për fuqizimin e kapacitetit ekonomik të rrjetit diplomatik të përfaqësive dhe konsullatave jashtë vendit, me fokus mbi diplomacinë ekonomike nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) përmes kuadrit të saj diplomatik, i cili ka përgjegjësi formale për avancimin e eksportit. Ka nevojë për angazhimin e promotorëve të ri ekonomik, në mënyrë ideale me kontrata për kohë të pacaktuar në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëri, duke e shfrytëzuar përvojën e Invest Maqedonia lidhur me përshkrimin e vendeve të punës, qëllimet e punës, kriteret e vlerësimit etj. Ekziston nevoja për rritjen e kapaciteteve të të punësuarve në diplomacinë ekonomike të MPJ (kuadër ekonomik diplomatik/ambasadorë (rreth 170) promotorë ekonomik rreth 20 – të cilët duhet të punësohen) dhe Sektori për diplomaci ekonomike (rreth 15), me qëllim që t'i zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, ndërkaq që t'u ndihmojnë nën-sektorëve të targetuar prodhues/prodakteve/vendeve (shihni Strategjinë eksportuese në Masën 4.1 më lartë) të

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

depërtojnë në tregjet e huaja përmes sigurimit të informacioneve për mjedisin afarist lokal, gjenerimin e mundësive të biznesit në tregjet e huaja, ndihmë për kompanitë në kontaktet afariste, pjesëmarrje në panaire ekonomik, promovimin e ekonomisë maqedonase, si dhe vend për IHD në fushën e industrisë përpunuese, kërkim të mundësive të biznesit përmes maqedonasve jashtë vendit (për shembull, diaspora); dhe bashkëpunim të ngushtë me Invest Maqedonia.

**Masa 4.3: Mbështetje të përvetësimit të tregjeve të reja dhe rritja e shitjes (Masa 2.2 nga PRRE).**

**Arsyetimi:** Kjo masë do t'ju ndihmojë kompanive të përkushtuara në përvetësimin e tregjeve të reja, të cilat arrijnë të kenë shitje më të madhe në tregjet e reja. Kompanitë e këtilla do të mund të fitojnë mbështetje financiare në lartësi prej 20% prej shpenzimeve të bëra për depërtimin në tregje të reja deri 1.845.000 denarë (30.000 euro) për një firmë. Aktivitetet që do të mbështeten përfshijnë: pjesëmarrje në panaire jashtë vendit; misione afariste; B2B në tregjet e huaja; shpenzime për certifikimin e produkteve sipas kërkesave të tregjeve të huaja; dhe shpenzime për ngritjen e kapaciteteve për marketing në tregjet e huaja (përgatitje të materialit promovues, katalog, broshura, dizajni i ueb etj.).

**Masa 4.4: Mbështetje të rritjes së konkurrencës në tregje të reja (Masa 2.1 nga PRRE).**

**Arsyetimi:** Edhe një masë është e aksesshme përmes PRRE për mbështetjen e rritjes së konkurrencës në tregje të reja, si për shembull në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke e pasur parasysh faktin se eksporti, në vendet fqinje të CEFTA, ka shifrën vetëm prej 12,5% të eksportit të përgjithshëm të Maqedonisë, ndërsa rreth 80% është fokusuar në drejtim të BE. Ndërmarrjet të cilat kanë sukses ta rrisin konkurrueshmërinë e tyre në tregjet e reja do të fitojnë mbështetje financiare për mbulimin e 10% të shpenzimeve investuese të shfrytëzuara për realizimin e kësaj rritje.

**Masa 4.5: Programi për mbështetjen e gatishmërisë për eksportin e prodhimit.**

**Arsyetimi:** Eksporti është një veprimtari e rrezikshme dhe e kushtueshme për bizneset e vegjël dhe mund t'i dekurajoj në angazhimin e tyre sa i përket aktivitetit eksportues. Ekziston një hendek i konsiderueshëm në këtë sistem, meqë ndërmarrjet prodhuese të cilat kanë potencial eksportues, megjithatë akoma nuk janë të gatshme për eksport, përveç PRRE dhe Programit zviceran për avancimin e importit, aktualisht kanë vetëm disa mënyra për të fituar mbështetje. Kjo masë e përfshin zgjerimin e bazës së ngushtë eksportuese të vendit, përmes identifikimit të 300 NVM prodhuese, të zgjedhura në mënyrë të veçantë me potencial eksporti (të targetuara sipas përvojës, nivelit të produktivitetit, inovacioneve teknologjike, aktiviteteve për hulumtim dhe zhvillim, intensitetit të aftësive dhe kapaciteteve TIK, me fokus mbi industrinë përpunuese. Do të sigurohet mbështetje për "Gatishmëri investuese" të NVM të synuara në formë të ndihmës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve, si dhe financim sa i përket gatishmërisë për eksport (për shembull, standarde, shëndeti dhe siguria, marketingu, planifikimi i biznesit, teknologjia, brendimi, paketimi, dimi i prodhimeve, certifikimi, lidhja e marrëveshjeve, doganat, logjistika, marketingu, informacione dhe analiza etj.

**Masa 4.6: Fuqizimi i eksportit të prodhimit përmes standardeve ndërkombëtare.**

**Arsyetimi:** Njëra nga pengesat kryesore për eksportin e NVM në Maqedoni është përmbushja e standardeve të përcaktuara për mallra dhe shërbime në shumicën e tregjeve ndërkombëtare. Shumica e produkteve janë prodhuar sipas standardeve të caktuara të cilët ndihmojnë të sigurohet se prodhimet janë: më të sigurt – zvogëlim të aksidenteve dhe shpëtim të jetëve; me cilësi më të mirë – përmirësimi i nivelit të shërbimeve për klientët; dhe më të lehta për përdorim – përmes sigurimit se prodhimet dhe shërbimet janë të aksesshme për të gjithë konsumatorët. Standardet janë të rëndësishme për të gjithë, ndërsa imperativ është ajo se të gjitha NVM në vend, veçanërisht ndërmarrjet prodhuese, e respektojnë këtë çështje të rëndësishme. Meqë standardet, në të shumtën e rasteve, janë vullnetare,



## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

konsumatorët mund të jenë të sigurt se organizatat të cilat vendosin t'i praktikojnë seriozisht i kuptojnë çështjet siç është siguria, aksesit dhe shërbimet për klientin. Ekziston nevojë për ngritjen e vetëdijes në lidhje me rëndësinë jashtëzakonisht të madhe për krijimin e "produkteve me cilësi të lartë dhe standarde të larta", në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat janë të njohura, konfidenciale dhe të vlerësuara si në tregun vendas ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare. Kjo masë do ta përfshijë ndihmën financiare dhe teknike për NVM në industrinë përpunuese, sa i përket Organizimit Ndërkombëtar të Standardeve (ISO), Sistemit të Analizës të Risqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP), standardet HALAL, Praktika e mirë prodhuese (GMP), Administrimi me inovacionet në industrinë automobilistike (TS16949, në proces të përfundimit) dhe ngjashëm (shih, gjithashtu, standarde ekologjike/të gjelbra, të prezantuara në Masën 3.4 më lartë).

### **Masa 4.7: Vendosija e kontaktit për eksport.**

**Arsyetimi:** Shumë NVM ankohen se shpenzimet për të siguruar të dhëna relevante marketingu, analiza dhe raporte janë shumë të larta dhe i tejkalojnë mundësitë e tyre buxhetore. Invest Maqedonia është e interesuar që eksportuesve potencial tua siguroj këto informacione, por aktualisht nuk ka mjete financiare për lidhje të marrëveshjeve me ofrues të rëndësishëm të të dhënave për eksport. Nevojitet mbështetje për qasje deri te këto informacione dhe të njëjtat të jenë të aksesshme për eksportuesit potencial, pavarësisht sektorit. Nevojiten regjistra me ofrues të të dhënave për eksport (për shembull, Euromonitor), që të sigurohet mbështetje për NVM në lidhje me të dhënat, analizat dhe diseminacionin. Nga ana tjetër, ekziston nevoja e vendosjes së kontaktit unik për eksport në Invest Maqedonia; mbështetje/promovim të ndërmarrjeve lokale në tregjet ndërkombëtare; bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë, Invest Maqedoninë, diplomacinë ekonomike, rrjetin e ndërmarrjeve në Evropë (EEN) dhe ngjashëm, me ç'rast do t'u ndihmohet ndërmarrjeve vendore të eksportojnë me informacione, analiza, etiketa dhe ngjashëm.

### **Masa 4.8: Integrimi i informacioneve për promovimin e eksportit.**

**Arsyetimi:** Ndërmarrjet, veçanërisht NVM të cilat planifikojnë të eksportojnë ose tanimë e kanë filluar procesin e eksportit, kërkojnë burim të mirë të informacioneve për tregjet e BE dhe Ballkanit Perëndimor, meqë ato bashkërisht përbëjnë 92,5% nga eksporti i përgjithshëm i Maqedonisë. Edhe pse një numër i madh i informacioneve që kanë të bëjnë me eksportin janë të aksesshme, ato shpeshherë janë të fragmentuara kështu që nevojitet kohë dhe angazhim që të arrihet deri te të njëjtat. Në Maqedoni ka nevojë për burim të integruar elektronik të këtyre informacioneve. Ministria e Ekonomisë do ta rishikoj dhe përmirësoj burimin e saj kryesor të informacioneve për NVM. Portali për konkurrencë ([www.konkurentnost.mk](http://www.konkurentnost.mk)) do të ridizajnohet, do të integrohet me e-shërbime dhe do të siguroj që burimet kryesore të informacioneve eksportuese të jenë lehtë të aksesshme, duke e përfshirë Invest Maqedoninë ([www.investinmacedonia.com](http://www.investinmacedonia.com)), Drejtorinë e Doganave ([www.customs.gov.mk](http://www.customs.gov.mk)) për procedura doganore, akciza, tarifa, për vlerën dhe origjinën, pronësinë intelektuale, ndalimin dhe kufizimin, borxhin tatimor dhe garanci, operatorin e caktuar ekonomik etj., Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit ([www.mbdp.com.mk](http://www.mbdp.com.mk)) për financimin e kredisë eksportuese, si mjete për qarkullim etj., Këshilli Tregtar Evropian ([www.trade.ec.europa.eu/tradehelp](http://www.trade.ec.europa.eu/tradehelp)) (procedura importi, kërkesa për produkte, detyrimet e importit, tatimet, rregullat e origjinës, statistika etj.), Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve ([www.een.mk/](http://www.een.mk/) [www.een.ec.europa.eu](http://www.een.ec.europa.eu)), CEFTA ([www.cefta.int](http://www.cefta.int)) dhe burime të tjera relevante, siç janë dhomat, shoqatat afariste, rrjetet rajonale për eksport etj. Kjo do të kombinohet me të dhëna statistikore në lidhje me tendencat e importit dhe eksportit, produktet etj. Integrimi i burimeve ekzistuese të informacioneve dhe të të dhënave për eksport do të jenë një hap përpara në lehtësimin e eksportit më të madh të ndërmarrjeve, veçanërisht të NVM.

### **Masa 4.9: Mbështetja e akceleratorit eksportues për NVM.**

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

**Arsyetimi:** Vendosja e akceleratorit eksportues për NVM financohet nga BE për përmirësimin e konkurrencës së NVM me fokus mbi stimulimin e eksportit të industrisë ushqimore dhe t'u ndihmoj NVM-ve të internacionalizohen përmes rritjes së mundësive dhe kapaciteteve eksportuese. Rreth një të tretën e eksportit e përbën bujqësia, mineralet dhe metalet, por pjesa më e madhe e eksportit të bujqësisë aktualisht janë produkte të papërpunuara ose gjysmë të përpunuara, siç janë mollët, pjeshkat dhe kumbullat. Të dhënat e statistikave të fundit tregojnë se Maqedonia është njëri nga eksportuesit më të mëdhenj të produkteve ushqimore të papërpunuara ose gjysmë të përpunuara, ndërkohë edhe njëri nga importuesit më të mëdhenj të produkteve të gatshme ushqimore (në rajonin e CEFTA), NVM të cilat marrin pjesë në Organizatën e Punëdhënësve në Maqedoni do të fitojnë ndihmë ekspertësh për përgatitjen e procedurave të eksportit, dokumentacionit dhe të aktiviteteve tjera të ngjashme të eksportit (analiza, tregje të reja, kontakte me rrjete distributive etj.). Akceleratori eksportues për NVM do të mundësoj analizë afariste të mundësive për eksport në tregjet e synuara eksportuese rajonale për produkte të përpunuara ushqimore, trajnime të NVM për eksport dhe mbështetje teknike, aftësi dhe njohuri të reja për eksport; ueb-platformë interaktive për eksport dhe për aplikim mobil; dhe projekte demonstruese për eksportin e produkteve të selektuara e të përpunuara ushqimore. Përmes mbështetjes praktike për eksportin e produkteve të caktuara, NVM do të përvetësojnë aftësi të reja, njohuri dhe informacione në lidhje me rritjen e konkurrencës. Pas periudhës 24-mujore të implementimit, do të mendohet për zgjerimin e punës, si për industrinë ushqimore ashtu edhe për nën-sektorët e tjerë prioritarë në industrinë përpunuese (shih: Masa 1.1 më lartë).

### Qëllimi strategjik 5 –Ndërtimi i industrisë përpunuese në të cilën mësohet

Në përgjithësi mjedis konkurrent prodhues i cili karakterizohet me jostabilitet, teknologji të reja, ndryshim të tendencave të tregut dhe shijeve të konsumatorëve, ndërtim të industrisë përpunuese në të cilën mësohet do të luaj rol të rëndësishëm sa i përket suksesit të konkurrencës së ndërmarrjeve, duke i mbështetur aftësitë e tyre që të zhvillohen të jenë të qëndrueshme, të shfrytëzojnë kompetenca kryesoredinamike, si dhe t'i shfrytëzojnë resurset dhe njohuritë. Ndërmarrjet, veçanërisht prodhuesit, e shfrytëzojnë mësimin si burim të diversitetit dhe ruajtjen e përparësisë së konkurrencës. Mësimi teknologjik e parandalon vjetërsimin e kompetencës së ndërmarrjes, si dhe të produkteve/shërbimeve të saj, kështu që ndikon pozitivisht mbi performancat e ndërmarrjes. Ekzistojnë tetë mënyra kryesore me të cilat industria përpunuese mund të zhvillohet dhe të ketë mbështetje në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet, me fjalë të tjera, akses deri te aftësitë, fondet dhe mbështetja përmes fondeve të BE-së, vendosjen e sektorëve të brendshëm teknologjik-hulumtues, mbështetje të NVM për avancimin e aftësive të personave të rinj, fuqizimi i bashkëpunimit midis universiteteve dhe prodhuesve, ngritja e vetëdijes për Ekonomi cirkulare, industri e gjelbër/prodhim i gjelbër dhe prodhimtari në cikël të mbyllur, vendosja e pilot *MakerSpace* dhe shfrytëzimi i ekspertizës së specializuar me cilësi të lartë për mbështetjen e NVM prodhuesevendore.

#### **Masa 5.1: Rritja e qasjes së prodhuesve deri te fondet e konkurrencës dhe inovacioneve në BE.**

**Arsyetimi:** Ekziston nevoja për përmirësimin e qasjes deri te njohuritë (know-how) për zhvillimin e NVM inovative në industrinë përpunuese. Ekzistojnë resurse të konsiderueshme të aksesshme përmes më shumë burimeve të financimit në BE (IPA II, Eureka, Evrostar, KOSME, HORIZONT2020, ERAZMUS për sipërmarrës të rinj, FP9 etj.), megjithatë, të njëjtat zakonisht nuk absorbohen në mënyrë efikase nga vendet candidate, duke e përfshirë edhe Maqedoninë, meqë procesi i aplikimit të fondeve për konkurrencë dhe inovacione të BE-së bëhet gjithnjë e më kompleks dhe më konkurrent. Kjo masë do të mundësoj qasje më efektive deri te fondet dhe mbështetje nga BE, me fokus mbi NVM nga industria përpunuese, universitetet, shoqëria civile dhe Qeveria. Theksi do të vihet mbi sigurimin e ndihmës teknike për trajnimmbi rrjetin e konsulentëve për aplikime kodekse në BE, mbi objektivat dhe mbështetjen e ndërmarrjeve në lidhje me aplikimet në BE, përgatitjen e modeleve për

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

praktikë të mirë / diseminacion, lidhjen e marrëveshjeve, monitorimin, evaluimin dhe raportimin. Pritet që kjo ta rris absorbimin e fondeve të BE, njëkohësisht duke e zhvilluar bazën lokale të aftësive për aplikacione në BE.

### **Masa 5.2: Vendosi dhe fuqizimi i sektorëve teknologjik dhe hulumtues (Masa 1.3 nga PRRE)**

**Arsyetimi:** Zhvillimi teknologjik, hulumtimi dhe zhvillimi, janë determinantat kryesore të ndërmarrjeve për fitimin e njohurive, asimilim, transformim dhe shfrytëzimin (përkatësisht, mësimi ose kapaciteti absorbues i ndërmarrjeve). Megjithatë, sipas studimeve të bëra për konkurrencën ndërkombëtare, niveli i ulët i shpenzimeve për hulumtim dhe zhvillim, inovacionet, gatishmëria teknologjike dhe sofistikimi afarist janë dobësitë e rëndësishme të ekonomisë maqedonase. Shumë NVM të industrisë përpunuese akoma nuk e kuptojnë potencialin e zhvillimit teknologjik dhe hulumtimit. Së këtejmi, përmes Planit për rritje ekonomike, do të sigurohet mbështetje financiare për formimin e sektorëve, qendrave ose të strukturave të tjera institucionale për projekte të qëndrueshme hulumtuese dhe zhvillimore, me angazhimin e kuadrit me kualifikime të larta. Mbështetja do të përfshijë hulumtime të aplikuara industriale për fitimin e njohurive dhe aftësive të reja për zhvillimin e produkteve të reja, proceseve prodhuese dhe shërbimeve ose përmirësim i konsiderueshëm i produkteve ekzistuese. Do të mbulohen 50% të shpenzimeve për hulumtime industriale deri 61.500.000 MKD (1.000.000 EUR) për një shfrytëzues, duke përfshirë 30% nga vlera e pajisjes së sapo furnizuar në sektorin e zhvillimit për instrumente dhe pajisje, ndërtesa dhe tokë, hulumtime, njohuri teknike, patenta dhe shërbime konsulente, projekte industriale dhe shpenzime të tjera operative (për shembull, materiale, prokurime dhe ngjashëm).

### **Masa 5.3: Mbështetje NVM-ve për përsosje profesionale dhe praktikë për personat e sapo punësuar të rinj (Masa 3.4 nga PRRE).**

**Arsyetimi:** Çështja, sa i përket avancimit të aftësive të personave të rinj është imanente, duke e pasur parasysh shkallën e tyre joproportionale të papunësisë. Kjo masë e PRRE do të ofroj mbështetje financiare për zhvillimin teknologjik të kompanive përmes mbulimit deri në 30% të shpenzimeve për trajnim dhe përsosje profesionale të personave të sapo punësuar të rinj. Sipas kushteve të PRRE, ndërmarrjet do të kenë mbështetje deri në 30% të shpenzimeve direkte, edhe atë deri 1.000.000 denarë (16.260 euro për një aplikant) mjetet do të shpërndahen përmes konkursit, varësisht nga ajo sesi do të kontribuoj aplikimi për zhvillimin e produkteve të reja ose të produkteve të përmirësuara në masë të konsiderueshme, shërbimeve dhe/ose proceseve të punës.

### **Masa 5.4: Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet universiteteve dhe ndërmarrjeve të industrisë përpunuese.**

**Arsyetimi:** Kjo masë është komplementare dhe ndërlidhet me masën 5.2 më lartë. Ajo përpiqet ta plotësoj vakumin në sistem ndërmjet mësimit akademik dhe vendit të mirëfilltë të punës. Studentët e diplomuar i posedojnë njohuritë më të reja akademike, megjithatë, shpeshherë u mungojnë njohuritë sa u përket kërkesave të industrisë dhe sa i përket praktikës së punës në një mjedis të këtyllë. Nga ana tjetër, NVM prodhuese shpeshherë nuk janë mirë të lidhura me arritjet më të reja teknologjike dhe të inxhinierisë, e që mund t'u ndihmoj të përshtaten, të krijojnë inovacione dhe ta ruajnë konkurrencën. Aftësitë dhe prodhimet e firmës mund të vjetrohen, ndërsa ardhmëria e saj është e pasigurt nëse ka mungesë të interaksionit me mjedisin e jashtëm. Disa aktivitete mund ta përmirësojnë gjendjen ekzistuese, duke e përfshirë edhe reformën e mjedisit ligjor, me ç'rast nevojitet të përcaktohet, si vijon: doktorata nga fusha e industrisë të sponsoruara nga fonde të reja (shih: Masën 3.1) dhe sektori privat; mundësimi i mungesës për përgatitjen e doktoratës për H&ZH, për punë në firma për 1-2 vjet, me të drejtë që të kthehet në ndonjërin nga fakultetet për inxhinieri (për çka nevojitet reformë e Ligjit për arsim të lartë); t'u mundësohet firmave të paguajnë që ndihmësit për hulumtim të punojnë në kompani dhe në fakultete (disa ditë në javë dhe të shfrytëzojnë laboratorë për hulumtim dhe zhvillim); t'u mundësohet menaxherëve

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

të kompanive të bëjnë praktikë (1 – 3 muaj) në kompani simotra në shtetet e zhvilluara, për teknologji, biznes/modele organizimi, etj. Me këtë, do të plotësohen masat siç janë ato të FIZHT për mbështetjen e shpenzimeve të trajnimit, kështu që NVM do të mund të dërgojnë njerëz në trajnime, dhe atë në Masën 5.3, për ndihmë personave të rinj për trajnim.

**Masa 5.5: Ngritja e vetëdijes dhe trajnimi për Ekonomi cirkulare, industrinë/prodhimin e gjelbër, prodhimin në cikël të mbyllur, efikasitetin energjetik dhe prodhimin e pastër.**

**Arsyetimi:** Gjelbërimi tanimë nuk është vetëm opsion, por nevojë urgjente në mënyrë që firmat prodhuese të jenë konkurrencte dhe të kenë përparësi ndaj ndërmarrjeve rivale të tyre, veçanërisht nëse dëshirojnë të eksportojnë (shih: Qëllimi strategjik 40). Është fakt se NVM-të prodhuese maqedonase akoma janë relativisht të painformuara për kërcënimet potenciale, si dhe për përfitimet që i ofrojnë konceptet e Ekonomisë cirkulare, industria e gjelbër/prodhimi i gjelbër etj. Nuk duhet të nënçmohet roli i sigurimit të informacioneve, i ngritjes së vetëdijes, arsimit, trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve, madje me rëndësi të madhe është që shteti të lidhet me shoqata afariste dhe me institucione të tjera, siç është UNIDO/REC, EEN etj., për zgjidhjen sistemore të hendekut në vitet në vijim, përmes Programit të strukturuar në Shkup dhe më gjerë. Fokus do të vihet mbi zhvillimin e Programit praktik për ngritjen e vetëdijes dhe trajnim, në mënyrë që t'iu mundësohet pjesëmarrësve të industrisë të mësojnë më shumë për Ekonominë cirkulare, për industrinë e gjelbër/prodhimin e gjelbër, prodhimin në cikël të mbyllur, efikasitetin energjetik, prodhimin e pastër në përgjithësi dhe me fokus të veçantë mbi llojet konkrete të proceseve të gjelbër, metodat dhe teknologjitë më relevante për industrinë dhe ekonominë maqedonase. Veç tjerash, nevojitet ngritja e vetëdijes e manxherëve të cilët punojnë me mjetet / linjat kreditore rreth nevojës së integritimit të Ekonomisë cirkulare si kriter për financimin e projekteve industriale.

**Masa 5.6: Vendosja e MakerSpace për stimulimin e mënyrës së të menduarit të prodhuesit.**

**Arsyetimi:** MakerSpace (i njohur edhe si FabLab, Techshop ose MackerSpace) është hapësira e përbashkët e punës në shkollë, bibliotekë ose në ndonjë objekt publik / privat, siç është Qendra e Shkencës dhe Teknologjisë për krijim, mësim, hulumtim dhe shkëmbim, të cilat shfrytëzohen përmes një numri të madh të instrumenteve të teknologjisë së ulët, të mesëm dhe të lartë. Këto mjedise janë të hapura për fëmijë, për të rritur dhe për sipërmarrës dhe kanë produkte të ndryshme nga prodhues të ndryshëm, siç janë printer 3D, laser prerës, makina për kontroll numerik kompjuterik (CNC), saldatore, makina rrobaqepësie, pjesë këmbimi Lego etj. Kjo e mundëson zhvillimin e mënyrës së të menduarit të prodhuesve për të krijuar diçka nga hiçi dhe hulumtim të interesave, duke ndihmuar në përgatitjen e atyre të cilëve u nevojiten aftësi kritike të shekullit 21 në fushën e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM). Ato sigurojnë mësim praktik, ndihmojnë në të menduarit kritik, si dhe në aftësitë, duke e përfshirë elektronikën, printimin 3D, modelimin 3D, përpunimin e drurit, kodimin, robotikën etj. MakerSpaces mund ta stimulojnë sipërmarrësinë, ndërkaq gjithnjë e më shumë shfrytëzohen si inkubatorë dhe akceleratorë për fillimin e biznesit. MakerSpace do të zhvillohet në partneritet me ndonjë institut të arsimit të lartë/park shkencor-teknologjik, në mënyrë që të testohet ideja dhe të konstatohet se a mund të zhvillohet rrjeti në mbarë vendin.

**Masa 5.7: Ekspertizë teknike për NVM vendore (mbështetje financiare për mikro-ndërmarrje - Masa - 3.2 nga PRRE).**

**Arsyetimi:** Kjo masë do t'iu ndihmojë ndërmarrjeve mikro të zhvillohen dhe të rriten. Kjo është pjesë e PRRE dhe ka për qëllim t'i mbështes ndërmarrjet mikro me mbështetje financiare për zhvillimin teknologjik të kompanive përmes mbulimit të 30% të shpenzimeve direkte në projekte investuese deri 5.000.000 denarë (81.300 euro) për një aplikant. Kjo do të arrihet përmes thirrjeve publike – për konkurs për propozime për mbështetjen e aktiviteteve investuese, siç janë: mbështetja teknike nga ekspertë të huaj për përpilimin e biznes-planeve afatmesëm dhe afatgjatë strategjike; trajnim për planifikim afatmesëm të biznesit (biznes plan trevjeçar); vendosje të lidhjeve afariste dhe bashkëpunimit afarist me investitorë të huaj

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

dhe kompani vendore; përmirësim të strukturave organizative për rritje; trajnime të specializuara për avancim; trajnime për detektimin e talenteve (liderë të ardhshëm); trajnime për planifikimin dhe kontrollin e shpenzimeve; prokurime; softuer për strukturë dhe performansa organizative ose procese operative për rritjen e proceseve të produktivitetit dhe/ose planifikimit. Përveç kësaj, do të mbështeten llojet e aktiviteteve dhe shpenzimeve si vijon: Rregulla teknike evropiane për sigurinë e produkteve; përgatitje të certifikatave për cilësi; analizë, përgatitje, fitim dhe mbrojtje të të drejtave industriale dhe intelektuale të pronësisë dhe implementimi i sistemeve informatike. Pastaj, kjo masë do të mbështesë iniciativa të ndryshme të gjelbra, si vijon: përmirësim të efikasitetit energjetik; konsulta për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përgatitje dhe vendosje të sistemeve për menaxhimin me mbetje.

### **Masa 5.8: Ekspertë ndërkombëtarë për kompanitë vendore me fokus mbi industrinë përpunuese.**

**Arsyetimi:** Shumica e NVM ballafaqohen me probleme të ndryshme gjatë kohës së zhvillimit të tyre, që mund të zgjidhet me ekspertizë interne ose angazhimin e konsulentëve të jashtëm afaristë. Megjithatë, për disa situata afariste nevojitet zgjidhje e përshtatur ose specifike, e cila ndoshta nuk është lehtësisht e aksesshme dhe as e lirë. Organizatat, siç janë: International Executive Service Corps (IESC) dhe Voluntary Service Overseas (VSO), Senior Expert Services (Gjermani), PUM (Holandë), ASEP (Austri), Swiss Contact (Zvicër) etj., mund t'i lidhin këto ndërmarrje me ekspertizën e cila u nevojitet në mënyrë që t'i tejkalojnë këto probleme dhe të shënojnë progres. Organizatat e lartpërmendura mund të sigurojnë zgjidhje në fushën e tregtisë, financave, TIK, partneritetit publik privat, teknologjisë, standardeve industriale, marketingut etj., me ç'rast NVM do t'u mundësohet ta përmirësojnë konkurrencën e tyre, për shembull, përmes shfrytëzimit të pajisjes dhe teknologjisë adekuate. Përveç kësaj, ndoshta duhet të hidhet një shikim përtej këtyre organizatave dhe të angazhohen shërbimet e specialistëve ekspertë më me përvojë nga vendet e BE-së. Çdo ekspert do të ketë detyrë specifike në lidhje me problemin e identifikuar (për shembull, ta përmirësoj cilësinë e produktit ose procesit) dhe do të ofroj solucion real përmes vizitave të aty për atyshme ose pa këtë. Kjo masë do t'u ofroj ndihmë 300 NVM nga industria përpunuese përmes sigurimit të ekspertizës nga ekspertë me përvojë nga ekonomitë e avancuara. Qëllimi kryesor është rritja e konkurrencës së tyre, përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe proceseve, krijimi dhe ruajtja e vendeve të punës, si dhe rritja e xhiros dhe profitit të biznesit. NVM vendore do t'i bashkë-financojnë shpenzimet e vizitës (për shembull: për akomodim, ushqim, transport lokal) si tregues i përkushtimit të tyre.

## Qëllimi ndër-sektorial – Implementimi dhe koordinimi

Pesë qëllimet strategjike që u diskutuan më lartë janë në fokusin e strategjisë. Megjithatë, në mënyrë që strategjia dhe plan veprimi të implementohen në mënyrë efektive, praktika e mirë kërkon të zbatohen gjashtë aktivitete ndër-sektoriale, përkatësisht të realizohet koordinim ndër-ministor, koordinim donatorësh, dialog publik privat, monitorim i rregullt dhe raportim, evaluim i kohë pakohshëm afatmesëm dhe final dhe koordinim të strategjisë, si dhe aplikime për financim.

### **Masa 6.1: Koordinimi ndër-ministor.**

**Arsyetimi:** Strategjia përfshin institucione të ndryshme shtetërore të cilat bashkëpunojnë me qëllim të implementimit të Planit të veprimit të përcaktuar në Aneksin B. Sektori për politikë industriale pranë Ministrisë së Ekonomisë do ta monitoroj procesin e përgjithshëm dhe do ta koordinoj implementimin e Strategjisë dhe të Plan veprimeve të saj. Ky proces i koordinimit do të përfshijë takime të rregullta (takime tremujore) të Grupit sektorial të punës për konkurrencë dhe inovacione, i cili do të mblidhet që të sigurohet koordinimi efektiv i

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

Strategjisë. Vonesat eventuale, grykat e ngushta, dhe çështjet e tjera në lidhje me implementimin do të diskutohen dhe zgjidhen në takimet e rregullta.

### **Masa 6.2: Koordinim donatorësh / INF**

**Arsyetimi:** Një numër i madh i masave të përfshira në Strategjinë dhe Planin e veprimit do të zbatohen me mjete shtetërore. Megjithatë, për një numër të konsiderueshëm të masave të përfshira me Plan veprimin e aprovuar nevojitet koordinim donatorësh / INF për plotësimin e mjeteve shtetërore. Në përputhje me parimet e financimit të donatorëve të sanksionuara në Deklaratën e Parisit për përmirësimin e efektivitetit të ndihmës së huaj dhe në Agjendën e Akra, Ministria e Ekonomisë do të konvokoj takime të rregullta (tremujore) të donatorëve/INF në mënyrë që të sigurohet koordinimi efektiv i tyre dhe mobilizimi i mjeteve për implementimin e prioriteteve strategjike të aprovuara nga Qeveria dhe të përfshira në Planin e veprimit.

### **Masa 6.3: Dialogu publik privat me palët e interesuara.**

**Arsyetimi:** Institucionet shtetërore dhe donatorët INF nuk janë të vetmit të cilët në mënyrë aktive e implementojnë Strategjinë dhe Planin e veprimit. Krahas tyre, shumë të tjerë, siç janë universitetet, organizatat joqeveritare, dhomat dhe trupat nga sektori privat janë përgjegjës për masa të caktuara. Prandaj, Ministria e Ekonomisë, veç tjerash, rregullisht do të takohet (në çdo tre muaj) me industrinë më të gjerë dhe palët e interesuara të industrisë përpunuese.

### **Masa 6.4: Monitorimi dhe raportimi.**

**Arsyetimi:** Strategjia dhe Plani i veprimit mund të implementohen vetëm nëse monitorohen rregullisht (dy herë/një herë në vit) ndërsa Ministria e Ekonomisë i paraqet rregullisht raportet deri te grupet paraprakisht të përcaktuara nga industria, donatorët/INF dhe palët e interesuara. Ministria e Ekonomisë do ta koordinoj procesin, i cili do të përfshijë dy aspekte të ndërlidhura por të ndryshëm për nga monitorimi (për më shumë detaje shihni Kapitullin 5):

- Monitorimi mbi Plan veprimit për industrinë e përpunimit;
- Monitorimi i politikës industriale më të gjerë gjithëpërfshirëse, duke i përfshirë institucionet e tjera dhe programet e tyre.

Rezultati konsiston me raportet e monitorimit dy herë / një herë në vit, të cilët do t'iu dërgohen partnerëve të ndryshëm të palëve të interesuara. Ato, veç tjerash, do të jenë të aksesshëm edhe në portalin [www.konkurentnost.mk](http://www.konkurentnost.mk).

### **Masa 6.5: Vlerësimi afatmesëm dhe evaluimi final**

**Arsyetimi:** Në mënyrë që të përcaktohet progresi dhe ndikimi i Strategjisë dhe Planit të veprimit, Ministria e Ekonomisë do të kërkoj dhe koordinoj tre vlerësime të pavarura (shih: Kapitullin 5):

- Në fund të vitit 2020: vlerësim të Plan veprimit të parë. Kjo do ta mundësoj vlerësimin e progresit dhe përshtatjes së Strategjisë dhe Planit të veprimit sa i përket progresit të arritur, problemeve të identifikuara dhe regjimeve të reja të financimit dhe iniciativat e politikave që do të rezultojnë nga periudha e re shtatëvjeçare programore e BE-së;
- Në fund të vitit 2023: vlerësim afatmesëm të Plan veprimit të ardhshëm;
- Në fund të vitit 2027: evaluimi final i Strategjisë dhe ndikimi i saj, duke i përdorur kriteret për evaluim të DAC-OECD, përkatësisht: relevanca, efikasiteti, efektiviteti, koherenca, ndikimi dhe qëndrueshmëria.

Të gjitha raportet për evaluim do të jenë të aksesshme në portalin [www.konkurentnost.mk](http://www.konkurentnost.mk).

### **Masa 6.6: Koordinimi i Strategjisë dhe aplikimet e financimit**

**Arsyetimi:** Ekziston nevoja për fuqizimin e kapacitetit të të punësuarve në Ministrinë e Ekonomisë, në mënyrë që të mundësohet fokus më i mirë mbi politikën, koordinimin dhe



## **Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese**

angazhimin në nivel ndërkombëtar (për shembull, BE/KE/KRB/OECD etj.), si dhe në nivel nacional (DPP/koordinimi ndër-ministror/koordinimi i donatorëve/MBE, etj.). Përveç kësaj, me rëndësi të jashtëzakonshme është zhvillimi i mëtutjeshëm i aftësive në lidhje me aplikimin për financa deri te INF/donatorët/KE, meqë mjetet shtetërore duhet të plotësohen me mjete të tjera.

## 5. Implementimi dhe koordinimi

Përvojat nga implementimi i strategjive dhe të plan veprimeve në Republikën e Maqedonisë, si edhe në shumë vende të tjera tregojnë se strategjia e mirë dhe plan veprimi i mirë janë pikë referente, por një gjë e këtillë nuk mjafton çdoherë. Çështja më e rëndësishme ka të bëjë me atë nëse është siguruar implementim efektiv, gjë që nuk është garanci. Në mesin e elementëve të tjerë, implementimi efektiv kërkon kornizë të përcaktuar kohore (plan veprim), buxhet shtetëror përkatës dhe stabil, angazhim i përkushtuar për mobilizimin e fondeve të donatorëve/ fondeve të INF, përgjegjësi të qarta institucionale dhe kapacitete të fuqishme, koordinim efektiv me organet e tjera publike, dialog të rregullt publik-privat, si dhe sisteme efektive për monitorim, raportim dhe evaluim.

Ky kapitull i përfshin këto dimensione të rëndësishme të cilat e mbështesin implementimin efektiv të Strategjisë dhe Planit të veprimit.

### 5.1 Politika/ Strategjia industriale dhe Strategjia e industrisë përpunuese/Plani i veprimit

Kjo Strategji u fokusua mbi politikën industriale, strategjinë industriale, strategjinë e industrisë përpunuese dhe plan veprimin e saj; të gjitha këto janë të ndërlidhura, megjithatë të ndryshme:

- Politika: ka të bëjë me një sërë udhëzimesh të cilat u ndihmojnë njerëzve të marrin vendime përkatëse ose të veprojnë në situatë të caktuar, në këtë rast ka të bëjë me industrinë në përgjithësi dhe konkretisht me industrinë përpunuese;
- Strategjia: është plan gjithëpërfshirës i aktiviteteve të formuluara ose dizajnuara që të arrihet vizioni i një politike të caktuar. Ajo është kornizë interpretuese e cila e drejton realizimin e vizionit;
- Strategjia industriale: me fokus mbi industrinë përpunuese: ekzistojnë më shumë intervenime të mundshme të ndryshme në lidhje me temat që kanë të bëjnë me industrinë, të cilat ngërthejnë çështje të ndryshme, siç është: tregtia, tatimet, konkurrenca etj. Qasja që përdoret në këtë strategji industriale është fokusimi mbi industrinë përpunuese, meqë ajo perceptohet si promotor i rritjes ekonomike. Qasja nuk ka të bëjë me atë që të “zgjidhen fituesit”, por masat e politikës të fokusohen mbi çështjet të cilat ndikojnë pozitivisht në produktivitetin, inovacionet, kapitalin njerëzor dhe qëndrueshmërinë e industrisë përpunuese;
- Plani i veprimit: është mënyrë që të sigurohet se vizioni dhe qëllimet strategjike që i përmban strategjia janë konkrete. Ai e përshkruan mënyrën se si do të shpërndahen resurset njerëzore, financiare dhe fizike, në mënyrë që të maksimizohen shanset për arritjen e vizionit. Ai përbëhet nga disa ndryshime që duhet të bëhen në industrinë përpunuese.

### 5.2 Roli i Ministrisë së Ekonomisë

Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për politikën industriale, IHD, eksportin, NVM, tregtinë etj. Si ministri kryesorë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me industrinë dhe industrinë përpunuese, ajo është përgjegjëse për krijimin dhe sigurimin e miratimit të strategjisë, si dhe për koordinimin e implementimit të saj (shih në vijim – koordinimi ndërministror, koordinimi i donatorëve dhe koordinimi i palëve të interesuara). Përveç kësaj, Ministria e Ekonomisë do ta marrë rolin udhëheqës në mobilizimin e fondeve shtetërore dhe jo-shtetërore (donatorë dhe INF) në lidhje me çështjet e kësaj strategjie, si dhe me monitorimin, raportimin dhe evaluimin (shih: më poshtë).

### 5.3 Roli i Qeverisë / Ministrive

Strategjia industriale / Strategjia e industrisë përpunuese për nga natyra është e gjerë. Plani i veprimit (shih: Aneksin B) në mënyrë të qartë e vë në dukje se një numër i madh i organeve shtetërore kanë përgjegjësi për masa të ndryshme të identifikuar në kuadër të strategjisë. Secili prej këtyre institucioneve të Qeverisë (ministri, agjenci, institucione, dhoma, organizata joqeveritare) kanë obligim të marrin përgjegjësi për masat për të cilat janë përgjegjëse, duke përfshirë edhe mobilizimin e resurseve të nevojshme për implementimin e fushave konkrete që janë detyrë e tyre. Ato, po ashtu, kanë përgjegjësi për implementimin e masave të Planit të veprimit në afatin e përcaktuar. Pastaj, ato duhet të sigurojnë informacione për monitorimin e masave për të cilat ato janë përgjegjëse, edhe atë në nivel gjysmë-vjetor. Këto informacione do të shfrytëzohen për raportim dhe për koordinim efikas të implementimit.

### 5.4 Roli i palëve të interesuara

Aspekti gjithëpërfshirës i industrisë/industrisë përpunuese detyrimisht nënkupton se jo vetëm organizatat qeveritare por edhe ato joqeveritare, sistemet nacionale për inovacione, bizneset, shoqatat afariste dhe ngjashëm kanë përgjegjësi të pjeshme për implementimin efikas të Strategjisë industriale / Strategjisë të industrisë përpunuese. Veç tjerash, ato kanë përgjegjësi për zbatimin e masave në kuadër të Planit të veprimit në afatet e përcaktuara. Ato do të sigurojnë informacione monitorimi për masat për të cilat ato janë përgjegjëse në nivel gjysmë – vjetor, në mënyrë që të mundësojnë raportim dhe koordinim të implementimit.

### 5.5 Koordinimi ndërministror

Strategjia përfshin institucione të ndryshme shtetërore të cilat bashkëpunojnë për implementimin e Planit të veprimit të përcaktuar në Aneksin B. Sektori i industrisë politike pranë Ministrisë së Ekonomisë do ta mbikëqyrë procesin e përgjithshëm dhe do ta koordinojë implementimin e Strategjisë dhe Plan veprimeve të saj. Koordinimi ndërministror është akoma më i rëndësishëm se zakonisht, duke e pasur parasysh rëndësinë e masave nga Plani për rritje ekonomike për zbatimin efikas të kësaj Strategjie. Ky proces i koordinimit do të përfshijë takime të rregullta (gjysmë-vjetore) të Grupit sektorial të punës për konkurrencë dhe inovacione, i cili do ta zbatojë Strategjinë dhe Planin e veprimit.

| 1.3 | <i>Fokusi i politikës së <b>Investimeve të huaja direkte (IHD)</b> në industrinë përpunuese (dhe orientimi i ndihmës shtetërore)</i>        | Faktorët kryesorë të IHD (Ministrat pa resorë, Invest Maqedonia, DZZTI, ambasadat) do t'i koordinojnë aktivitetet e tyre me fokus eksplcit mbi industrinë përpunuese dhe nën-sektorët prioritarë (shih: 1.1 – specializim i zgjuar), me theks mbi vlerën e shtuar/H&ZH/IHD të gjelbra. Sistemi i ndihmës shtetërore për IHD do të jetë në kompetencë të një industrie, në mënyrë që të rritet transparenca dhe efikasiteti.           | Ministra për IHD<br>Invest Maqedonia<br>DZZHTI<br>Ambasadat                             | 2018-2020   | <ul style="list-style-type: none"> <li>IHD si % nga BPV</li> <li>40% IHD në industrinë përpunuese</li> <li>25% nga prurjet e prodhimit IHD të gjelbra /H&amp;ZH</li> <li>Themelimi i seksionit për sistemin e ndihmës shtetërore për IHD</li> </ul>   |
| 1.4 | <i>Stimulimi i <b>investimeve</b> (masat e PRRE 1.4, 1.5 dhe 1.6)</i>   | Plan i ri për rritje ekonomike do të stimuloj investime përmes tri aktiviteve: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për projektet investuese me interes të konsiderueshëm ekonomik: çlirimi nga tatimi mbi fitim të pagave; tatimi për fitim; 10% grant dhe grant për një të</li> </ul>  | Investitorë vendas  | 2018-2020<br>deri në 61.500.000 den. (1.000.000 euro) për një aplikant për të gjitha tri aktivitetet (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li>IHD si % nga BPV</li> <li>% IHD në industrinë përpunuese</li> <li># kërkesa për 3 aktivitete</li> <li>% kërkesa të suksesshme për 3 aktivitete</li> </ul>  |

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë   | Afati/Buxheti                           | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|---|---|---|---|---|
|     |   | <p>punësuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për rritjen e investimeve kapitale dhe të ardhurave: 10% nga investimi në makina të reja, pajisje ose hapësira/tokë;</li> <li>Mbështetje për blerjen e aseteve nga kompanitë të cilat ballafaqohen me vështirësi: kthim prej 10% të vlerës së investuar në makina dhe obligime që kanë të bëjnë me procedurën e falimentimit dhe likuidimit.</li> </ul>  |   |   | <ul style="list-style-type: none"> <li># ndërmarrje të mbështetura të cilat ballafaqohen me vështirësi</li> </ul>   |
| 1.5 | <b>Zhvillimi i Zonave zhvillimore teknologjike industriale (ZZHTI) me fokus mbi industrinë përpunuese</b> | <p>Janë aktive 8 ZZHTI, ndërsa edhe 6 janë në plan, duke mos e llogaritur Shkupin 3. 8. Ky aktivitet fokusohet në shfrytëzimin e ZZHTI Shkup 1 &amp; 2, Shtip, Tetovë, Prilep, Strugë, Kërçovë dhe Strumicë, përgatitja e Shkupit 3, dhe më pas implementimi i ZZHTI-ve të tjera.</p> <p>Për shkak të koordinimit me qasjen për IHD (shih: 1.3 dhe 1.4), fokusi do të vihet mbi sigurimin e qiramarrësve në nën-sektorët e identifikuar në industrinë përpunuese (shih: 1.1), përfshirë edhe H&amp;ZH, TI dhe investime kapitale intensive.</p>   | DZZHTI<br>Invest Maqedonia<br>Ministra për IHD<br>KMN të huaj | 2018-2020                               | <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkup 1 &amp; 2 tërësisht të shfrytëzuara</li> <li>Shtipi dhe Tetova tërësisht të shfrytëzuara</li> <li># qiramarrës në ZZHTI</li> <li>Prilep, Strugë, Kërçovë dhe Strumicë tërësisht të shfrytëzuara</li> <li>Shkup 3 i gatshëm për investitorë</li> <li>% e firmave me teknologji të lartë</li> <li>% e firmave për H&amp;ZH</li> <li>% të punësuar në teknologjinë e lartë</li> </ul> |
| 1.6 | <b>Zhvillim i mëtutjeshëm i klasterëve industrial me fokus mbi inovacionet dhe konkurrencën.</b>          | <p>Ministria e Ekonomisë (ME) do të zhvilloj program të integruar për lloje të ndryshme të klasterëve (të pazhvilluar, të zhvilluar, në tranzicion dhe ngjashëm), në mënyrë që të fokusohet mbi nevojat e tyre specifike zhvillimore. Projekti i donatorëve "Pilot programi i integruar klaster për klasterë të pazhvilluar" do t'i mbështesë klasterët industrial/prodhues, për zhvillimin e klasterëve për inovacione me lidhjen e ndërtimit të kapaciteteve, ngritjen e vetëdijes, shërbimeve konsulente dhe granteve për financim, me qëllim të fuqizimit të inovacioneve dhe konkurrencës. Gjithashtu, do të mbështeten ndërmarrjet të cilat punojnë në sektorët e përfshirë në strategjinë për specializim të zgjuar, në mënyrë</p> | ME<br>Menaxherë të klasterëve<br>NVM                          | 2019-2022<br><br>2 mil. euro (donatorë) | <ul style="list-style-type: none"> <li>5 klasterë përpunues të mbështetur</li> <li># aktivitete të realizuara inovative/kolaborative</li> <li># marrëveshje të nënshkruara me institucionet për H&amp;ZH</li> <li>Rritja e qarkullimit</li> <li>Rritja e profitabilitetit</li> <li>Rritja e eksportit</li> <li>Rritja e H&amp;ZH</li> <li>Rritja e punësimit</li> </ul>   |

### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi   | Përgjegjësitë              | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|---|--|----------------------------|--|--|
|     |   | që të zhvillojnë dhe zbatojnë biznes modele të reja për përmirësimin e integritit të NVM në zinxhirët global të vlerave.   |                            |  |  |
| 1.7 | <i>Mbështetje për krijimin e <b>zinxhirëve të vlerave</b> me fokus mbi industrinë përpunuese dhe lidhjen e firmave me zinxhirët global të vlerave</i>                   | Ky aktivitet do t'i identifikoj dhe do ta mbështes fuqizimin e 5 zinxhirëve të vlerave në lidhje të ngushtë me ato ekzistues ZZHTI, meqë kjo ofron mundësi më të madhe për lidhjen e firmave vendore me ato nacionale, rajonale (Ballkani Perëndimor dhe BE) dhe zinxhirët më të gjerë global të vlerave. Kjo do të arrihet përmes projektit donator, me qëllim që të bëhet përzgjedhja e zinxhirëve të vlerave, analiza e të njëjtave dhe ndihma teknike dhe mjetet financiare për implementimin e rekomandimeve. | ME<br>DZZHTI<br>NVM        | 2019-2022<br><br>3 mil. euro<br>(donatorë)   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• 5 zinxhirë të mbështetur të vlerave</li> <li>• # firma të involvuara nga ZZHTI dhe TIDZ</li> <li>• 5 zinxhirë të vlerave të analizuara me rekomandime</li> <li>• # projekte të mbështetura për zinxhirët e vlerave, në mënyrë që të plotësohet hendeku i zinxhirëve të vlerave</li> <li>• # NVM të mbështetura</li> </ul> |
| 1.8 | <i>Krijimi i kushteve dhe përgatitja e <b>bazave ligjore për zhvillimin e kapitalit me risk</b> për ndërmarrjet e industrisë përpunuese (PRRE, Shtylla 3, Masa 3.5)</i> | Ky aktivitet ka të bëjë me zhvillimin e bazave ligjore dhe financiare për themelimin e Fondit për investime ekviti dhe mezanin, për mbështetjen e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen dhe realizimin e projekteve për zhvillim teknologjik. Ai do të ketë tri detyra kryesore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e akteve nënligjore për themelimin e Fondit;</li> <li>• Mbështetja e projekteve për zhvillim teknologjik.</li> </ul>   | MF<br>FIZHT<br>Ndërmarrjet | 2018-2020<br><br>50.000.000 den.<br>(deri 30 mil. den/<br>487.800 euro për një aplikant (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Akte të miratuara nënligjore</li> <li>• Vëllimi i fondit</li> <li>• Vëllimi i kapitalit</li> <li>• Vëllimi i mjeteve mezanin</li> <li>• # firma të mbështetura</li> <li>• Rritja e punësimit, qarkullimit, eksportit, profitit.</li> </ul>  |

## Qëllimi strategjik 2: Rritja e produktivitetit, inovacioneve dhe transferimi i teknologjive

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë  | Afati/Buxheti   | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|---|---|--|---|--|
| 2.1 | <i>Fuqizimi i bazës institucionale për transferimin e teknologjive / ekstenzion, absorbim për mbështetjen e industrisë përpunuese (masa të ndryshme nga PRRE)</i> | <p>Shkalla e transferimit të teknologjive, përshtatja, shpërndarja dhe absorbimi duhet të rriten sa i përket NVM. Do të zbatohen katër iniciativa si ndihmë për transferimin, ekstenzionin dhe absorbimin e teknologjive:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>FIZHT do të ofroj mbështetje për ekstenzionin dhe absorbiminteknologjik përmes instrumentit për mbështetjen e ekstenzionin teknologjik;</li> <li>Do të themelohet ZNTT dhe do të kryej transferim të teknologjive;</li> <li>Do të formohet Parku Shkencor-Teknologjik (PSHT) për transferimin e teknologjive për lidhjen e fakulteteve në Shkup;</li> <li>Do të shqyrtohet mundësia për aplikacionin IPA, për ndihmë të fakulteteve teknike në lehtësimin e bashkëpunimit me ndërmarrjet lidhur me digjitalizimin e proceseve industriale përmes Qendrave për TT.</li> </ul> | <p>FIZHT</p> <p>MASH/ZNTT/FIZHT</p> <p>Fakultetet / ME</p> | <p>2018-2020</p> <p>1.5 mil. euro (shteti)</p> <p>500.000 euro (shteti)</p> <p>180.000 euro (fizibiliteti, shteti)</p> <p>20.000 euro (shteti) dhe 2 mil. euro (donatori)</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>Vëllimi i mjeteve për TT/E/A</li> <li># NVM të mbështetura me TT/E/A</li> <li>ZNTT i themeluar dhe funksional</li> <li>Studimi fizibiliteti për PSHT</li> <li>PSHT funksional</li> <li>Rritja e rankut të absorbimit teknologjik (105 në 2016)</li> </ul> |
| 2.2 | <b>Ngritja e nivelit të inovacioneve tek ndërmarrjet (Masa 3.3 nga PRRE)</b>  | <p>Disa nën-sektorë prodhues/përpunues manifestojnë potencial teknologjik dhe inovacione, megjithatë është e nevojshme mbështetja sa i përket procesit të komercializimit të hulumtimit dhe qasjes deri në laboratorë dhe pajisje hulumtuese. Do të sigurohet ndihma për NVM për zhvillim dhe zbatim të zgjidhjeve inovative, si zhvillim dhe instalim të produkteve dhe ose shërbimeve të reja, përmirësim të produkteve ose shërbimeve ekzistuese, koleksione të reja të modës, dizajn industrial ose ridizajnim të produkteve, paketa të reja dhe plane marketingu (analiza e tregut, analiza e konkurrentëve, hulumtimi i produkteve, shitja etj.), përmirësimi i proceseve ekzistuese ose inkuorporimi i proceseve të reja prodhuese.</p>  | <p>FIZHT</p> <p>Ndërmarrjet</p>                            | <p>2019-2020</p> <p>deri 20 mil. den. (325.000 euro) për një aplikant (shteti)</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li># aplikime për financim</li> <li># aplikime të suksesshme</li> <li>Vëllimi i investimeve</li> <li>Vëllimi i mjeteve shtetërore</li> <li># i inovacioneve</li> <li># patenta</li> </ul>  |
| 2.3 | <b>Mbështetje e NVM me rritje të shpejtë ("Gazela") me zhvillim teknologjik (Masa 3.1 nga PRRE)</b>   | <p>Do të ofrohet mbështetje financiare për "Gazela" për zhvillim teknologjik të kompanive përmes thirrjeve publike, duke mbuluar 30% të investimeve në, për shembull të: akteve normative teknike evropiane për sigurinë e produkteve; certifikimin e cilësisë; të drejtave industriale dhe intelektuale të</p>   | <p>FIZHT</p> <p>NVM</p>                                    | <p>2018-2020</p> <p>Deri 10 mil. den. (162.000 euro) për një aplikant (shteti)</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li># aplikime për financim</li> <li># aplikime të suksesshme</li> <li>Vëllimi i investimeve teknologjike</li> <li>Vëllimi i mjeteve shtetërore</li> </ul>  |



### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti   | Arsyetimi/fokusi   | Përgjegjësitë   | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|--|--|---|--|--|
|     |  | pronësisë; sistemeve informatike; efikasitetit energjetik; konsultimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe themelimin e sistemit për menaxhim me mbetje.   |   |  | <ul style="list-style-type: none"> <li># rritje më e madhe se 20% në vit</li> </ul>  |
| 2.4 | <i>Fuqizimi i lidhjeve midis investitorëve të huaj dhe prodhuesve vendorë (Masa 1.2 e PRRE)</i>  | <p>Lidhja e dobët midis KMN dhe NVM vendore vazhdon të jetë e dobët dhe pamjaftueshëm e zhvilluar. Ky aktivitet përfshin dy detyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Avancimi i pilot iniciativës të BB në industrinë automobilistike dhe orientimi i saj drejt fuqizimit të lidhjeve midis IHD në ZZHTI dhe NVM vendore;</li> <li>Implementimi i masës nga PRRE për mundësimin e qiramarrësve nga ZZHTI dhe të tjerëve të pranojnë mbështetje financiare për lidhje afariste me furnizuesit vendorë (deri 1% nga furnizimet nëse furnizojnë 15% të inputit prodhues të firmave vendore).</li> </ul>                           | <p>DZZHTI<br/>KMN<br/>NVM</p> <p>DZZHTI<br/>KMN<br/>NVM</p> | <p>2018-2020</p> <p>2 mil. euro (shteti)<br/>2 mil. euro (donatorë)</p> <p>Deri 18.5 mil. den. (300.000 euro) për firmë (shteti)</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li># firma të lidhura prodhuese lokale</li> <li>Vëllimi i marrëveshjeve shtetërore me furnizuesit vendor</li> <li>Vëllimi i bashkëfinancimit</li> <li># kërkesa për financim</li> <li># kërkesa të suksesshme</li> <li>Vëllimi i furnizimeve</li> <li>Vëllimi i mjeteve shtetërore</li> </ul>    |
| 2.5 | <i>Identifikimi i mbështetjes së Teknologjive kryesore (KET) dhe Fabrikave të zgjuara në industrinë përpunuese (industria 4.0 dhe Fabrika 4.0)</i> | <p>KET dhe fabrikat e zgjuara i përforcojnë mundësitë e ardhshme prodhuese në shumë industri, duke e katalizuar valën e radhës të prodhimeve me vlerë dhe teknologji të lartë për prodhim, përfshirë edhe zhvillimin e industrive të reja dhe biznes modelet. Ky aktivitet përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimin të Grupit teknik të punës që të ofroj rekomandime për zhvillimin e target instrumenteve për ndihmë shtetërore dhe maksimizim të qasjes deri te fondet e BE-së.</li> <li>Përgatitja e projektit donator, i cili do të punoj në zbatimin e rekomandimeve të Grupit teknik të punës.</li> </ul> | <p>ME<br/>MASH<br/>universitetet<br/>Sektori privat</p>     | <p>2019-2020</p> <p>500.000 euro (donatorë)</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i GP teknik</li> <li>Rekomandime të GP për KET &amp; fabrika të zgjuara</li> <li>2 aplikacione për financim deri te BE</li> <li>10 projekte për KET/ fabrika të zgjuara të paraqitura për financim deri te BE</li> <li>5 projekte të zbatuara për KET/fabrika të zgjuara</li> </ul> |

### Qëllimi strategjik 3 - Katalizimi i industrisë së gjelbër dhe prodhimit të gjelbër

| #   | Aktiviteti   | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë  | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|--|---|--|--|---|
| 3.1 | <b>Zbatimi i Reformës së gjelbër rregullatore</b>                                    | <p>Ky aktivitet do të përfshijë reformën e gjelbër rregullatore me fokus mbi industrinë përpunuese, përfshirë: ligje dhe rregullore të reja, pjesërisht të lidhura me direktivat e BE (p.sh. WEEE, RoHS, REACH, etj.) për promovimin e prodhimit të gjelbër: programi për ngritjen e vetëdijes tek shoqatat afariste dhe NVM;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji i ri për energjetikë;</li> <li>• Ligji i ri për efikasitet energjetik;</li> <li>• Baza ligjore për Fondin për Efikasitet Energjetik;</li> <li>• Rregullore për industrinë (revizioni energjetik /ISO 50001);</li> <li>• Përgatitja e strategjisë afatgjate për aktivitetet klimatike;</li> <li>• Përgatitja e ligjit për aktivitetet klimatike;</li> <li>• Ligji i ri për kontrollin e emisioneve të industrisë.</li> </ul>  | <p>ME/MMJPH/Agjenci Shoq. afariste<br/>ME<br/>ME<br/>ME<br/>Të përcaktohet Agjencia për energjetikë<br/><br/>MMJPH<br/>MMJPH<br/>MMJPH</p> | <p>2019-2020<br/>50.000 euro (donatorë)<br/>2018<br/>2018-19<br/>2019-20<br/>2018-19<br/>2018-20<br/>2018-20<br/>2019-20<br/>2019-20</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # ngjarje të NVM</li> <li>• # pjesëmarrës të NVM</li> <li>• Miratimi i ligjit</li> <li>• Miratimi i ligjit</li> <li>• Krijimi i bazës për formim</li> <li>• Miratimi i Rregullores</li> <li>• Drafti i hartuar</li> <li>• Drafti i hartuar</li> <li>• Miratimi i ligjit</li> </ul> |
| 3.2 | <b>Prokurime publike të gjelbra (PPGJ) për mallra dhe shërbime me ndikim të madh</b> | <p>PPGJ mund ta rrisin kërkesën për produkte të resurseve efikase, të qëndrueshme, të riciklueshme, prodhime të përmirësueshme dhe të promovojnë modele të reja biznesi, duke u mundësuar autoriteteve lokale dhe shtetërore të përcaktojnë modele dhe standarde të cilët duhet t'i ndjekin bizneset, industritë dhe ngjashëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji i ri për prokurime publike do të revidohet, në mënyrë që të inkorporohen rregulla të cilat mundësojnë faktorë të qëndrueshëm/ekologjik të gjelbër për zhvillim, përfshirë edhe manualë të nevojshëm dhe ngritje të kapaciteteve për lidhjen e marrëveshjeve.</li> <li>• Ligji i ri për efikasitet energjetik do të revidohet, në mënyrë që të inkorporohen kërkesat për prokurime në lidhje me efikasitetin energjetik të institucioneve të sektorit publik.</li> </ul> | <p>MF/Byro për PP<br/><br/><br/>ME</p>   | <p>2019-2020<br/>30.000 euro (donatorë)<br/><br/>2018</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• BPV në ligjin e ri për prokurime publike</li> <li>• % nga BPV në gjithsej PP</li> <li>• Miratimi i ligjit</li> </ul>   |

### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë               | Afati/Buxheti                      | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|---|---|-----------------------------|------------------------------------|---|
| 3.3 | <i>Përfshirja e qëndrueshmërisë si strategji kryesore afariste për prodhuesit</i>   | Prodhimi i gjelbër mund t'i reduktoj shpenzimet e lëndëve të para, shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen gjatë punës, mbetjet ose ndotjen, duke fituar efikasitet në prodhim dhe imazh më të mirë korporativ. Bizneseve do t'u ofrohet ndihmë për zhvillimin e përparësive komparative përmes integritit të pikëpamjeve ekologjike në biznes modelet/aktivitetet e tyre, duke gjeneruar performansa më të mira afariste, duke stimuluar inovacione dhe rezultate më të mira financiare përmes granteve / bashkëfinancimit.                        | ME<br>NVM                   | 2019-2020<br>10.000 euro (shteti)  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # NVM të bashkë-financuara</li> <li>• # biznes plane të gjelbra</li> </ul>   |
| 3.4 | <i>Mbështetje të iniciativave të gjelbra në industrinë përpunuese të udhëhequra nga industria (zinxhirë të gjelbëruar të vlerave)</i> | Iniciativat e udhëhequra nga industria, të mbështetura nga Qeveria përmes granteve/bashkëfinancimit mund të ndihmojnë në gjelbërimin e zinxhirëve të vlerave përmes mbështetjes së formave të ndryshme të certifikimit, si ISO 14001 (mjedisi jetësor), ISO 9001 (kualiteti), ISO 18001 (shëndeti dhe siguria), ISO 50001 (menaxhimi me energjinë), EcoLabel, Skema për eko-menaxhment dhe revizion (EMAS), Gjurma ekologjike e produktit (PEF), Gjurma ekologjike e organizatave (OEF) etj. për prodhuesit, dhe veçanërisht për firmat e orientuara drejt eksportit. | ME<br>NVM                   | 2019-2020<br>100.000 euro (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # NVM të bashkë-financuara</li> <li>• # standarde të implementuara të gjelbra</li> </ul>   |
| 3.5 | <i>Zhvillimi i Zonave të Gjelbra Industriale (ZGJI) me fokus mbi industrinë përpunuese</i>  | Zonat e gjelbra, si pjesë të Zonave të Gjelbra Industriale (ZGJI) janë krijuar që ta stimulojnë zhvillimin e industrisë/prodhimit të gjelbër, megjithatë, aktualisht nuk ekziston asnjë. Ky aktivitet i përfshin detyrat si vijojnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Reforma e Ligjit për zona të gjelbra industriale;</li> <li>• Finalizimi i punës rreth studimit fizibiliti për Zonën e parë të gjelbër;</li> <li>• Sigurimi i mjeteve shtetërore për Zonën e parë të gjelbër.</li> </ul>   | ME<br>Komuna<br>Investitorë | 2018-2020<br>11 mil. euro (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligj i reviduar dhe i miratuar</li> <li>• Fizibiliti studimi i përfunduar, Zona e parë e gjelbër funksionale</li> <li>• Tërheqja e 10 ndërmarrjeve të gjelbra</li> </ul> |

**Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese**

| #   | Aktiviteti   | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë  | Afati/Buxheti   | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|--|---|--|---|---|
| 3.6 | <i>Stimulimi i efikasitetit të resurseve/energjetik dhe efikasitetit të ulët të karbonit/ i resurseve/ teknikat më të mira të aksesshme në industrinë përpunuese</i> | <p>Qëllimi është të evitohen teknologjitë joefikase me miratimin e programeve për prodhim të pastër. Do të sigurohet ndihmë për industrinë përpunuese në mënyrë që të rritet prodhimi më i pastër i efikasitetit të resurseve dhe karbonit të ulët / përmes ndihmës teknike, financave dhe ngritjes së kapaciteteve, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnim të personave të cilët lëshojnë leje për Parandalim të e integruar dhe kontrollin e ndotjes në mënyrë që në të ardhmen t'i revidojnë planet, duke filluar nga industria përpunuese;</li> <li>Trajnim dhe kualifikim të konsulentëve dhe industrisë së sisteme për menaxhim me energji në përputhje me ISO 50001;</li> <li>Implementimi i projekteve për efikasitet energjetik në industrinë përpunuese;</li> <li>Themelimi i Fondit për Efikasitet Energjetik</li> </ul> | <p>MMJPH</p> <p>UNIDO/universitetet</p> <p>UNIDO/REC/BMMZH</p> <p>Të konfirmohet</p> | <p>2019-2020</p> <p>2018-2020</p> <p>2018-2020<br/>4 mil. euro.<br/>(donatorë)<br/>2020</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>#Plane të reviduara për efikasitet energjetik</li> <li>40 konsulentë të certifikuar</li> <li># aplikantë</li> <li>30-50 projekte të financuara</li> <li>Fondi i themeluar</li> </ul>   |
| 3.7 | <i>Mbështetje e NVM në riprodhim</i>   | Riprodhimi bëhet i rëndësishëm në fushat siç janë: pjesë këmbimi për mjete motorike, kompresorë, pajisje për komunikim, mobilie zyre, automatë për shitjen e produkteve (makina veding), fotokopir. Kartrixhë për tonerë, pajisje bujqësore etj. Mund të jetë i dobishëm mekanizmi bashkë me klasterët, ZHTI etj. Do të realizohet një studim për ZZHTI dhe potencialin e tyre për riprodhim, e që do të çoj deri te rekomandimet për politikën, siç është mbështetja për kompanitë start-up, grantet / bashkëfinancimi i pajisjes etj. Në fazën e dytë do të implementohet projekti për mbështetje.  | ME<br>DZZHTI<br>KMN<br>NVM   | Nga 2020 e tutje<br>2 mil. euro.<br>(donatorë)  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Raport me rekomandime</li> <li>Koncept projektues</li> <li>Financa të siguruara</li> <li>Tender për projekt në 2021</li> <li>Implementimi nga 2021</li> <li>Vëllimi i produkteve sërisht të përdorura dhe komponentë në industrinë përpunuese</li> </ul> |
| 3.8 | <i>Mbështetje e NVM në prodhimtarinë aditive / 3D printim</i>  | Prodhimtaria aditive potencialisht mund t'i zvogëlojë ose eliminojë konvejerët prodhues dhe zinxhirët furnizues, sepse produktet "finale" prodhohen brenda një procesi të vetëm, duke e zhvendosur procesin e prodhimit më afër klientit. Kjo masë do t'i mbështesë NVM në printimin/prodhimin 3D, veçanërisht ndërmarrjet start-up, përmes granteve dhe bashkëfinancimit.  | ME<br>NVM  | Nga 2020 e tutje<br>2 mil. euro.<br>(donatorë)  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Koncept projektues</li> <li>Financa të siguruara</li> <li>Tender për projekt në 2021</li> <li>Implementimi nga 2021</li> <li># 3D printerë</li> <li># qarkullim dhe punësim</li> </ul>   |

### Qëllimi strategjik 4: Stimulimi i eksportit të prodhimtarisë

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi   | Përgjegjësitë                           | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|---|--|---|--|---|
| 4.1 | <i>Fuqizimi institucional i politikës eksportuese me fokus mbi industrinë përpunuese</i>        | Në mënyrë që të zgjerohet dhe thellohet eksporti, përfshirë edhe në industrinë përpunuese, Ministria e Ekonomisë do të përgatis strategji për eksport në bashkëpunim të ngushtë me Invest Maqedonia (promovimi) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme (diplomacia ekonomike, duke i theksuar nën-sektorët target, produktet dhe vendet, por edhe do të themeloj Seksion për eksport për koordinimin e aktiviteteve eksportuese me Invest Maqedonia dhe me diplomacinë ekonomike.<br>Invest Maqedonia do të bëjë revizion dhe reforma në Sektorin për promovimin e eksportit në mënyrë që të gjeneroj më shumë resurse dhe kapacitete për mbështetjen e aktiviteteve për promovimin e eksportit. | ME<br>Invest Maqedonia<br>MPJ           | 2019-2020<br>100.000 euro<br>(shteti)  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Miratohet strategjia e eksportit</li> <li>Sektor i fuqizuar për promovimin e eksportit</li> <li>Takime tremujore të ME, Invest Maqedonia dhe MPJ</li> <li>Rritja e eksportit të prodhimtarisë si % e BPV</li> </ul>  |
| 4.2 | <i>Fuqizimi i IHD dhe eksportit përmes diplomacisë ekonomike</i>                                | Ekziston nevoja e fuqizimit të kapacitetit të promotorëve ekonomikë/ të diplomacisë ekonomike për sigurimin e ndihmës për NVM prodhuese të depërtojnë në tregjet e huaja në bazë të nën-sektorëve target, vendeve dhe produkteve (shih më lartë: strategjia eksportuese), bazuar mbi aktivitetet e mëposhtme të fokusuar në aktivitetet eksportuese/IHD: <ul style="list-style-type: none"> <li>Angazhimi 20 Promotorë ekonomikë;</li> <li>Trajnim i Promotorëve ekonomikë;</li> <li>Trajnim i Seksionit për diplomaci ekonomike;</li> <li>Trajnim i kuadrit për diplomaci ekonomike.</li> </ul> Kjo do të çoj në qasje të koordinuar për eksportin, bashkë me ME dhe Invest Maqedonia.      | MPJ<br>Invest Maqedonia<br>ME           | 2019-2020<br>100.000 euro për ndërtimin e kapaciteteve (shteti)              | <ul style="list-style-type: none"> <li>Angazhimi i 20 promotorëve ekonomik</li> <li>Trajnimi i Promotorëve ekonomikë</li> <li>Trajnimii kuadrit për diplomaci ekonomike</li> <li># takime eksporti B2B</li> <li># takime për IHD</li> <li>Rritja e eksportit të prodhimtarisë si % nga BPV</li> </ul> |
| 4.3 | <i>Mbështetje për përvetësimin e tregjeve të reja dhe rritjen e shitjes (Masa 2.2 nga PRRE)</i> | Kjo do t'u ndihmoj kompanive të përvetësojnë tregje të reja ose tarrisin shitjen në tregjet e reja me mbështetje financiare deri në 20% nga shpenzimet e bëra. Aktivitete të cilat do të mbështeten janë: pjesëmarrja në panairë jashtë vendit; misione afariste; B2B në tregjet e huaja; shpenzime për certifikimin e produkteve sipas kërkesave të tregjeve të huaja; dhe shpenzime për ngritjen e kapaciteteve për marketingnë tregjet e huaja (përgatitja e materialit   | Invest Maqedonia<br>FIZHT<br>Ndërmarrje | 2018-2020<br>deri 1.8 mil. den.<br>(30.000 euro) për një ndërmarrje (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li># kërkesa për financim</li> <li># kërkesa të suksesshme</li> <li>Rritja e eksportit në tregjetë reja</li> <li>Vëllimi i mjeteve shtetërore</li> </ul>  |

### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti   | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë                            | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|--|---|--|--|--|
|     |  | promovues, katalogë, broshura, ueb dizajn etj).   |  |  |  |
| 4.4 | <i>Mbështetja për rritjen e konkurrencës në tregjet e reja (Masa 2.1 nga PRRE)</i> | Kjo do t'u ndihmoj ndërmarrjeve që ta rrisin konkurrencën në tregjet e reja (10% mbështetje).   | Invest Maqedonia<br>FIZHT<br>Ndërmarrjet | 2018-2020<br>10% shpenzime investuese<br>Deri 61.5 mil. den. (1 mil. euro) për një ndërmarrje (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # kërkesa për financim</li> <li>• # kërkesa të suksesshme</li> <li>• Vëllimi i eksporti</li> <li>• Vëllimi i mjeteve shtetërore</li> </ul>  |
| 4.5 | <i>Programi për mbështetjen e gatishmërisë për eksportin e prodhimit</i>           | Kjo masë do të përfshijë përzgjedhjen e 300 NVM prodhuesve të zgjedhura në mënyrë të veçantë me potencial eksportues. Do të sigurohet mbështetja për "Gatishmërinë investuese" (përfshirë edhe mekanizmat ueb), ndihma teknike dhe ngritja e kapaciteteve, si dhe financimi sa i përket gatishmërisë për eksport (për shembull, standardet, shëndeti dhe siguria, marketingu, biznes planifikimi, teknologjia, brendimi, paketimi, testimi i produkteve, certifikimi, lidhja e marrëveshjeve, doganat, logjistika, marketingu, informacionet dhe analiza etj.). | ME<br>NVM                                | Nga 2020 e tutje<br>5 mil. euro (donatorë)   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti projektues</li> <li>• Mjete të siguruar</li> <li>• Tender për projekt në 2021</li> <li>• Implementimi nga 2021</li> <li>• # firma të mbështetura</li> <li>• Rritja e eksportit të prodhimit si % nga BPV</li> </ul>        |
| 4.6 | <i>Fuqizimi i eksportit të prodhimit përmes standardeve ndërkombëtare</i>          | Ekziston nevoja për ngritjen e vetëdijes lidhur me rëndësinë e jashtëzakonshme për krijimin e "produkteve me kualitet dhe standarde të larta", në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat janë të njohura, të besueshme dhe të vlerësuara edhe në tregjet vendase edhe në ato ndërkombëtare. Kjo masë do të përfshijë ndihmë financiare dhe teknike për NVM e synuara në industrinë e përpunuese, sa i përket ISO, HACCP, HALAL, Praktika e mirë prodhuese (GMP) etj.  | ME<br>NVM                                | 2019-2020<br>50.000 euro (shteti)  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # mbështetja e standardeve ISO</li> <li>• # Mbështetja e standardeve HACCP</li> <li>• # Mbështetja e standardeve HALAL</li> <li>• # Mbështetja e standardeve GMP</li> <li>• Rritja e eksportit të prodhimit si % nga BPV</li> </ul> |
| 4.7 | <i>Vendosja e kontaktit për eksport</i>  | Gjithashtu, ekziston nevoja për vendosjen e kontaktit të vetëm për eksport, për sigurimin e të dhënave dhe analizave të përgjithshme (për shembull, EuroMonitor), si dhe udhëzime, mbështetje për NVM për qasje në tregjet ndërkombëtare, përfshirë edhe bashkëpunimin e Rrjeteve të ndërmarrjeve të Evropës (EEN), bashkëpunimin rajonal (për shembull, Qendrat rajonale për zhvillim), Dhomen Ekonomike   | Invest Maqedonia                         | 2019-2020  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontakti për eksport</li> <li>• Qasje deri në EuroMonitor</li> <li>• #Kordinimi i ngjarjeve me EEN,MPJ, QRZH etj.</li> <li>• # NVM të këshilluara/të mbështetura</li> <li>• # raporte/analiza për</li> </ul>                        |

### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti   | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë   | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|--|---|---|--|---|
|     |  | dhe personat për kontakt për diplomaci ekonomike.   |   |  | eksportin e ndërmarrjeve  |
| 4.8 | <i>Integrimi i informacioneve për promovimin e eksportit</i> | Portali i konkurrencës ( <a href="http://www.konkurentnost.mk">www.konkurentnost.mk</a> ) do të avancohet, në mënyrë që të siguroj informacione relevante për NVM. Portali do të përmbaj statistika/analiza për import dhe eksport. Ai, mes tjerash, do t'i integroj burimet kryesore të informacioneve për eksportin, duke e përfshirë Invest Maqedonia ( <a href="http://www.investinmacedonia.com">www.investinmacedonia.com</a> ), Drejtorinë e Doganave ( <a href="http://www.customs.gov.mk">www.customs.gov.mk</a> ) për procedurat doganore, Bankën Maqedonase për Mbështetje dhe Zhvillim ( <a href="http://www.mbdp.com.mk">www.mbdp.com.mk</a> ), Këshillin Evropian Tregtar ( <a href="http://www.trade.ec.europa.e">www.trade.ec.europa.e</a> ), Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve ( <a href="http://www.een.mk">www.een.mk</a> / <a href="http://www.een.ec.europa.eu">www.een.ec.europa.eu</a> ), CEFTA ( <a href="http://www.cefta.int">www.cefta.int</a> ) dhe burime të tjera relevante, siç janë dhomat, shoqatat afariste, rrjetet rajonale për eksport etj. | ME<br>Invest Maqedonia  | 2018-2020  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Portal i avancuar</li> <li>• Udhëzime shtesë për eksport</li> <li>• Statistika shtesë për eksport</li> <li>• # pasqyra mujore</li> <li>• # azhurnime mujore</li> </ul> |
| 4.9 | <i>Mbështetja e akceleratorit eksportues për NVM</i>         | Akceleratori eksportues do ta përfshijë NVM në stimulimin e eksportit të industrisë ushqimore lidhur me procedurat eksportuese, dokumentacionin dhe aktivitetet e tjera të ngjashme eksportuese (analiza, tregje të reja, kontakte me rrejte distributive etj.).<br>Pas periudhës 24-mujore të implementimit, do të shqyrtohet ndikimi në mënyrë që të bëhet vlerësimi i fokusit mbi industrinë ushqimore dhe/ose zgjerimin eventual të mbështetjes së nën-sektorëve të tjerë prioritarë të prodhimit (shih: Masa 1.1 më lartë).  | Organizata e punëdhënësve (OPM)<br><br>Instituti për Zhvillim Dinamik SFERA-NOVA<br><br>NVM | 2018-2020<br><br>143.000 euro (122.000 donatorë dhe 21.000 kontribute) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosja e akceleratorit eksportues</li> <li>• # NVM nga industria ushqimore</li> <li>• # masa për mbështetje</li> <li>• Rritja e eksportit të ushqimit</li> </ul>     |



## Qëllimi strategjik 5: Ngritja e sektorit prodhues në të cilin mësohet

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë   | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|---|---|---|--|---|
| 5.1 | <i>Ngritja e aksesit të prodhuesve në fondet për konkurrencë dhe inovacione të BE</i>                                     | Ky aktivitet fokusohet mbi përmirësimin e qasjes në rrjedhat e pamjaftueshme të shfrytëzuara financiare të BE (IPA 2, Eureka, Eurostars, KOSME, Horizont 2020, Erasmus për sipërmarrësit e rinj, EEN, FP9 etj.) nga ana e NVM, universiteteve, shoqërisë civile dhe ngjashëm, përmes trajnimit për konsulent dhe sigurimit të informacioneve, udhëzimeve dhe mbështetjes për firmat që të aplikojnë pranë BE, përgatitjes së modeleve për praktika të mira, lidhjes së marrëveshjeve, monitorimi, evaluimi dhe raportimi.   | ME<br>MASH<br>EEN<br>NVM                                    | Nga 2020 e tutje<br>1.5 mil. euro<br>(donatorë)                          | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti projektues</li> <li>• Mjete të siguruara</li> <li>• Tender për projektin në 2021</li> <li>• Implementimi nga 2021</li> <li>• 300 aplikacione nga NVM</li> <li>• 50 aplikacione të suksesshme</li> <li>• Shfrytëzimi i fondeve të BE nga firmat prodhuese</li> </ul> |
| 5.2 | <i>Ngritja dhe fuqizimi i sektorëve teknologjikë dhe hulumtues (Masa 1.3 nga PRRE)</i>                                    | Investitorët do të kenë mbështetje financiare për ngritjen e sektorëve teknologjik/hulumtues. Kjo ndihmë do ta përfshijë hulumtimin e aplikuar industrial, për fitimin e njohurive dhe aftësive për zhvillimin e produkteve të reja, proceseve prodhuese ose shërbimeve apo për përmirësimin e konsiderueshëm të produkteve ekzistuese, proceseve prodhuese ose shërbimeve në veprimtarinë prodhuese për pajisje të re, instrumente dhe pajisje, ndërtesa dhe tokë, hulumtim, patenta dheshërbime konsulente, projekte industriale dhe shpenzime operative (për shembull, materiale). | FIZHT<br>Invest Maqedonia<br>Universitetet<br>Dhomat<br>NVM | 2019-2020<br><br>61.5 mil. den. (1 mil. euro) për një përdorues (shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # kërkesa për financim</li> <li>• # kërkesa të suksesshme</li> <li>• Vëllimi i mjeteve të investuara private/shtetërore mjete private/shtetërore për H&amp;ZH</li> <li>• # sektorë funksional teknologjikë dhe hulumtuese</li> </ul>   |
| 5.3 | <i>Mbështetje të NVM për përsosje profesionale dhe praktikë të personave të rinj të sapo punësuar (Masa 3.4 nga PRRE)</i> | Kjo masë e PRRE do të ofroj mbështetje financiare për zhvillimin teknologjik të kompanive përmes mbulimit deri në 30% të shpenzimeve për trajnim dhe përsosje profesionale të personave të ri të sapo punësuar. Sipas kushteve të PRRE ndërmarrjet do të kenë mbështetje deri 30% të shpenzimeve direkte, edhe atë deri në 1.000.000 denarë (16.260 euro) për një aplikant.   | FIZHT<br>NVM  | 2018-20<br>Deri 1 mil. den. (16.260 euro) për një aplikant (shteti)      | <ul style="list-style-type: none"> <li>• # aplikacione</li> <li>• # projekte të mbështetura për zhvillim teknologjik</li> <li>• # të rinj të trajnuar të punësuar</li> <li>• # pjesëmarrës në program</li> <li>• # produkte të reja ose të përmirësuara, shërbime dhe /ose procese pune</li> </ul>                    |
| 5.4 | <i>Fuqizimi i lidhjeve midis universiteteve dhe ndërmarrjeve nga industria përpunuese</i>                                 | NVM prodhuese doemos duhet të lidhen me teknologjitë më të reja dhe arrijtjet inxhinierike. Studentët e diplomuar i posedojnë njohuritë më të reja akademike, por shpeshherë u mungon njohja e kërkesave të industrisë. Disa aktivitete do të   |   |  |   |

## Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë   | Afati/Buxheti   | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|---|---|---|---|--|
|     |   | <p>mund ta përmirësonin gjendjen aktuale:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mundësimi i mungesës për H&amp;ZH, për punë në firma, me të drejtë të kthehen në fakultetin e inxhinierisë;</li> <li>Doktorate nga fusha e industrisë të sponsorizuara nga sektori privat;</li> <li>Asistentët për hulumtim të punojnë në kompani dhe në fakultete (të shfrytëzojnë laboratorë për H&amp;ZH);</li> <li>Menaxherë të kompanive të punojnë (1-3 muaj) në kompani të ngjashme në vende të tjera, të fitojnë njohuri për teknologji, biznes/modele organizative, etj.</li> </ul> | <p>MASH</p> <p>Universitete</p> <p>ZNTT</p> <p>NVM</p>                  | <p>2019</p> <p>2019-2020<br/>100.000 euro<br/>(donator)</p>             | <ul style="list-style-type: none"> <li>Reforma të Ligjit për arsim të lartë</li> <li># Doktorate për industri</li> <li># Mungesë doktorate për H&amp;Zh</li> <li># Asistent për hulumtime</li> <li># Menaxherë të kompanive</li> <li># NVM të involvuara</li> <li>Përmirësim i indeksit të ndërmarrjeve të përpunimit</li> <li># Bashkëpunim midis përpunuesve dhe universiteteve</li> </ul> |
| 5.5 | <b>Informacione, ngritja e vetëdijes dhe trajnimi</b> për ekonominë cirkulare, industrinë/përpunuese të gjelbër, industrinë përpunuese të ciklit të mbyllur, efikasitetit energjetik, prodhimin e pastër etj. | Ndihmë për NVM të industrisë përpunuese që t'i kuptojnë përfitimet potenciale dhe kërcënimet nga Industria/përpunuese e gjelbër përmes informacioneve, ngritjes së vetëdijes, trajnimi dhe ngritjes së kapaciteteve për lloje të caktuara të proceseve të gjelbra, metodave dhe teknologjive.   | <p>UNIDO/REC ME/ Agjencia e Energjetikës MMJPH FITHT/ZNTT Dhoma NVM</p> | 2018-2020<br>50.000 euro<br>(donatorë)                                  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Programi për trajnim</li> <li># ngjarje për ngritjen e vetëdijes</li> <li># prodhues të trajnuar</li> <li># iniciativa stimuluese për politika</li> <li>Perceptim i ndryshuar i firmave</li> </ul>  |
| 5.6 | Vendosja e <b>MakerSpace</b> për stimulimin e mënyrës së të menduarit të prodhuesit   | Krijimi i MakerSpace me pajisje si 3D printerë, presës laserik, makina përkontroll numerik kompjuterik (CNC), saldatuese etj., që t'i stimulojnë prodhuesit të mendojnë ndryshe, me theks mbi shkencën, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën. Kjo do të mundësojë mësim praktik, mendim kritik, si dhe aftësinë për elektronikë, 3D printim, 3D modelim, përpunim të drurit, kodim, robotikë etj.   | FIZHT   | Nga 2020 e tutje<br>300.000 euro<br>(donatorë)                          | <ul style="list-style-type: none"> <li>Aplikacioni për financim</li> <li>Krijimi i MakerSpace</li> <li># pjesëmarrës/vizitues</li> </ul>   |
| 5.7 | <b>Ekspertizë teknike për NVM vendase</b> (mbështetje financiare për mikro-ndërmarrjet - Masa 3.2 nga PRRE)   | Ky aktivitet mbështet zhvillimin financiar dhe teknologjik për një numër të madh aktivitetesh: konsultime/trajnime për planifikim afaristë; bashkëpunim afarist me investitorë të huaj; përmirësim të strukturave organizative; trajnime të specializuara për menaxhim (liderë të ardhshëm); planifikim dhe kontroll të shpenzimeve; furnizim; softuer për  | <p>FIZHT</p> <p>Micro firms</p>   | 2019-2020<br>up to 5 MM MKD<br>81.300 euro për një aplikant<br>(shteti) | <ul style="list-style-type: none"> <li># applications for funding</li> <li># successful applications</li> <li>Vëllimi i investimeve teknologjike nga mikro firmat</li> <li>Vëllimi i mjeteve shtetërore</li> </ul>   |

### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti   | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë  | Afati/Buxheti   | Indikatorët kryesorë të suksesit  |
|-----|--|---|--|---|---|
|     |  | produktivitet dhe/ose planifikim të proceseve. Përveç kësaj, do të mbështeten edhe: Aktet normative teknike evropiane për sigurinë e produkteve; përgatitje për certifikatat e cilësisë; analiza, përgatitja, fitimi dhe mbrojtja e të drejtave industriale dhe intelektuale të pronësisë dhe implementimi i sistemeve të informacionit. Pastaj, kjo masë do të mbështesë iniciativa të ndryshme të gjelbra, përfshirë: përmirësimin e efikasitetit energjetik; konsultimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përgatitjen e vendosjes së sistemit për menaxhim me mbetjet. |  |   |   |
| 5.8 | <b>Ekspertizë ndërkombëtare për kompanitë vendase me fokus mbi industrinë përpunuese</b> | Do të ftohen ekspertë me përvojë nga vendet e BE që t'u ndihmojnë kompanive përpunuese me zgjidhje të përshtatshme për problemet të cilat nuk mund t'i zgjidhin biznes konsulentët vendas. Do t'u ndihmohet 300 NVM nga industria përpunuese, përmes thirrjeve të hapura, në fushën e përmirësimit të kualitetit të prodhimeve, rritjes së efikasitetit të proceseve të tyre, krijimit dhe ruajtjes së vendeve të punës, rritjes së qarkullimit dhe profitit të bizneseve etj. NVM prodhues vendas do t'i bashkë-financojnë shpenzimet e vizitës.                             | KZKQÇE<br>Kabineti i<br>Kryeministrit<br>NVM<br>Konsulentë | 2019-2020<br>50.000 euro (shteti)<br>950.000 euro<br>(donatorë) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• 300 NVM të mbështetura</li> <li>• # ditë të realizuara pune nga ekspertë ndërkombëtarë</li> <li>• Qarkullim i rritur</li> <li>• Profitabilitet i rritur</li> <li>• Punësim i rritur</li> </ul> |

## Qëllimi ndër-sektorial 6: Implementimi dhe koordinimi

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi   | Përgjegjësitë  | Afati/Buxheti     | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|---|--|--|-------------------|--|
| 6.1 | <b>Koordinimi ndërministror</b>                     | Sektori për politikë industriale i Ministrisë së Ekonomisë do ta mbikëqyr procesin e përgjithshëm dhe do ta koordinoj zbatimin e Strategjisë dhe Plan veprimin e tij. Ky proces i koordinimit do të përfshijë takime të rregullta gjysmë-vjetoretë Grupit sektorial të punës për Konkurrencë dhe Inovacione. Sa u përket vonesave, grykave të ngushta dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me implementimin do të diskutohen dhe zgjidhet në takimet koordinative.  | ME<br>KNQÇE<br>Ministri relevante<br>Organe relevante shtetërore   | 2018-20<br>0 euro | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimum 4 takime në vit</li> <li>• Raport gjysmë-vjetor për progresin</li> <li>• Procesverbal gjysmë-vjetor me konkluzione dhe rekomandime</li> <li>• Raporti vjetor për progresin</li> </ul>   |
| 6.2 | <b>INF/koordinim donator</b>                        | Në përputhje me parimet e financimit donator (Deklarata e Parisit për përmirësimin e efektivitetit të ndihmës së huaj dhe Agjendës nga Akra), Ministria e Ekonomisë do të thërret takime të rregullta të donatorëve/INF në mënyrë që të sigurohet koordinim efektiv donator dhe mobilizim i mjeteve për zbatimin e prioritetëve të miratuara, të definuara në Planin e veprimit përmes Grupit Punues Sektorial për konkurrencë dhe inovacione.   | KNQÇE<br>Grupi punues sektorial për konkurrencë dhe inovacione<br>ME donatorë<br>INF                     | 2018-20<br>0 uro  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimum 2 takime në vit</li> <li>• Raport gjysmë-vjetor për progresin</li> <li>• Procesverbal gjysmë-vjetor</li> <li>• # aplikime për projekte donatore</li> <li>• # projekte të financuara donatore</li> <li>• Vëllimi i mjeteve donatore</li> </ul> |
| 6.3 | <b>Dialogu publik privat me palët e interesuara</b> | Shumë OJQ të tjera janë përgjegjëse për masa të caktuara në Planin e veprimit dhe prandaj Ministria e Ekonomisë do të mblidhet në takime gjysmë-vjetore me industrinë më të gjerë dhe palët e interesuara nga industria përpunuese. Nëse është e mundshme, DPP do të implementohet përmes Platformës së sapo-krijuar për DPP.  | ME<br>Shoqëri dhoma<br>Sektori akademik<br>OJQ/think tanks   | 2018-20<br>0 euro | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimum 2 takime në vit</li> <li>• Raport gjysmë-vjetor për progresin</li> <li>• Procesverbal gjysmë-vjetor</li> </ul>  |
| 6.4 | <b>Monitorimi dhe raportimi</b>                     | Strategjia dhe Plani i Veprimit mund të zbatohen vetëm nëse rregullisht ndiqen (në nivel tremujor, gjysmë-vjetor / vjetor) dhe raportet të dërgohen me rregull.<br>Ministria e Ekonomisë do të koordinoj dy procedura të ndryshme monitorimi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimi i Planit të veprimit për industrinë përpunuese;</li> <li>• Monitorimi i politikës gjithëpërfshirëse industriale, përfshirë edhe institucionet e tjera dhe programet e tyre. Rezultatet do të përfshihen në raportet e monitorimit, të cilët do t'u dërgohen organeve shtetërore dhe palëve të</li> </ul> | ME<br>KNQÇE<br>Ministri relevante<br>Organe shtetërore relevante<br>Shoqata<br>Dhoma<br>Sektori akademik | 2018-20<br>0 euro | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raport gjysmë-vjetor për progresin</li> <li>• Raport vjetor për progresin</li> </ul>  |

### Strategjia Industriale me fokus mbi industrinë përpunuese

| #   | Aktiviteti  | Arsyetimi/fokusi  | Përgjegjësitë                  | Afati/Buxheti  | Indikatorët kryesorë të suksesit   |
|-----|---|---|--------------------------------|--|--|
|     |   | interesuara (gjithashtu, edhe portalit <a href="http://www.konkurentnost.mk">www.konkurentnost.mk</a> ).  |                                |  |  |
| 6.5 | <b>Vlerësimi afatmesëm i evaluimit final</b>  | <p>Në mënyrë që të përcaktohet ndikimi i Strategjisë dhe Planit të veprimit, Ministria e Ekonomisë do të ofroj tre vlerësime të pavarura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në fund të 2020: mundësimi i vlerësimit të progresit dhe përshtatja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, duke marrë parasysh periudhën e re programore 7-vjeçare të BE dhe iniciativat e reja për politikën dhe regjimet e financimit;</li> <li>Në fund të vitit 2023: vlerësim afatmesëm i Planit të veprimit;</li> <li>Në fund të 2027: evaluimi final i ndikimit të Strategjisë (kriteret e DAC-OECD): relevanca, efikasiteti, efektiviteti, koherenca, ndikimi dhe qëndrueshmëria.</li> </ul> <p>Të gjitha raportet për evaluim do të jenë të aksesshëm në: <a href="http://www.konkurentnost.mk">www.konkurentnost.mk</a>.</p> | ME<br>Të gjithë implementuesit | 2020/1<br>2023/4<br>2027/8<br>75.000 euro (donatorë) | <ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti për evaluim (2021)</li> <li>Strategjia/Plan veprimi i reviduar</li> <li>Raporti për evaluim (2024)</li> <li>Strategjia/Plan veprimi i reviduar</li> <li>Raporti për evaluim (2028)</li> </ul> |
| 6.6 | <b>Koordinimi i Strategjisë dhe ngritja e kapaciteteve të aplikimeve për financim</b> | Ngritja e kapacitetit të kuadrit në Ministrinë e Ekonomisë, në mënyrë që të mundësohet politika, koordinimi dhe angazhimi në nivel ndërkombëtar (p.sh. BE/KE/KRB etj.), në nivel nacional (DPP/koordinim ndërministror/koordinim donator/DBE etj.) dhe aftësitë për aplikim për financa deri te INF/donatorët/KE, me qëllim të plotësimit të mjeteve shtetërore.  | ME                             | 2018-20<br>20.000 euro (donatorë)                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>Financa për ngritjen e kapaciteteve</li> <li># në sesione për ngritjen e kapaciteteve</li> </ul>  |